



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice

**RAPORTI VJETOR I PUNËS
DHE I PERFORMANCES SË
AKADEMISË SË DREJTËSISË
PËR VITIN 2025**

Prishtinë, 2025

Tabela e përmbajtjes

FJALA HYRËSE	6
1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	8
2. KORNIZA LIGJORE	9
2.1 Përmirësimi i bazës ligjore në periudhën raportuese	10
2.2 Vështirësitë ligjore që ka hasur institucioni në përmbushjen e misionit të vet	11
3. PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT	12
3.1 Misioni Vizioni	13
3.2 Misioni	13
3.3 Vizioni	13
3.4 Kompetencat e AD-së sipas ligjit	13
4. FUSHËVEPRIMI I AKADEMISË SE DREJTËSISË	14
4.1 Organizimi, veprimtaria dhe personeli	15
4.2 Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë	18
4.3 Këshilli Programor i Akademisë së Drejtësisë	20
4.4 Ekzekutivi - Drejtori Ekzekutiv i Akademisë së Drejtësisë	21
4.5 Menaxhmenti i mesëm.....	23
4.5.1 Mandati i Departamenteve.....	24
4.6 Burimet njerëzore	25
4.6.1 Numri i të punësuarve në Akademi të Drejtësisë	26
4.6.2 Nevojat për punëtorë të rinj	27
4.6.3 Paraqitja në formë tabelare e numrit dhe llojit të trajnimeve të stafit	27
4.7 Asetet në posedim të Akademisë së Drejtësisë.....	28
4.7.2 Përmirësimi i infrastrukturës së teknologjive TI dhe investimet kapitale	30
5. AKTIVITETET E AKADEMISË SË DREJTËSISË PËR VITIN 2025	32
5.1 Krahasimi i punës së AD-së për tri vitet e fundit	32
5.2 Plani i punës dhe performancës për vitin 2025	35
5.2.1 Përgatitja profesionale e gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapo emëruar	35
5.2.2 Avancimi i vazhdueshëm i njohurive profesionale dhe interdisiplinare të gjyqtarëve, prokurorëve, stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial si dhe profesionistëve të tjerë ligjor	36
5.2.3 Zhvillimi i programeve trajnuese, ngritja e cilësisë së trajnimeve hulumtimeve dhe veprimtarisë botuese	37
5.3 Aktivitetet e Akademisë së Drejtësisë në përmirësimin e veprimtarisë së saj të përcaktuar me ligj	39

6.	PËRMBUSHJA E PLANIT TË PUNËS DHE TË PERFORMANCËS SI DHE PROGRAMEVE TRAJNUESE, REKOMANDIMET DHE SFIDAT	41
6.1	ARRITJET NË ZBATIMIN E PLANIT TË PUNËS DHE TË PERFORMANCËS SI DHE PROGRAMEVE TË TRAJNIMEVE GJATË VITIT 2025	42
6.2	PËRGATITJA PROFESIONALE E GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE TË SAPO EMËRUAR SI DHE NGRITJA E SHKATHTËSIVE TRAJNUESE	43
6.2.1	Aktivitetet e realizuara në Programet për Trajnim Fillestar gjatë vitit 2025	44
6.2.1.1	Zbatimi i Programit të Trajnimit Fillestar për gjeneratën XI të gjyqtarëve (2024–2025)	46
6.2.1.2	Zbatimi i Programit të Trajnimit Fillestar për gjeneratën XII të gjyqtarëve (2024–2025)	46
6.2.1.3	Zbatimi i Programit të Trajnimit Fillestar për gjeneratën XIII të gjyqtarëve (2025–2026)	47
6.2.1.5	Zbatimi i Programit të Trajnimit Fillestar për gjeneratën XI të prokurorëve (2025–2026)	49
6.3	AVANCIMI I VAZHDUESHËM I NJOHURIVE PROFESIONALE DHE NTERDISIPLINARE TË GJYQTARËVE, PROKURORËVE, STAFIT ADMINISTRATIV GJYQËSOR DHE PROKURORIAL SI DHE PROFESIONISTEVE TË TJERË LIGJOR - (PTV)	51
6.3.1	Aktivitetet trajnuese të realizuara gjatë vitit 2025 në kuadër të Programit për Trajnim të Vazhdueshme, arritjet dhe sfidat.....	52
6.3.2	Aktivitetet trajnuese të vazhdueshme të realizuara sipas fushave	55
6.3.2.6	Aktivitetet trajnuese nga fusha administrative.....	59
6.3.2.20	Trajnimet (fillestare dhe të vazhdueshme) për të punësuarit në administratën e sistemit gjyqësor	65
6.3.2.22	Aktivitetet trajnuese për profesionet e lira	67
6.3.3	Bashkëpunimi me donatorët dhe kapacitetet trajnuese në zbatimin e Programit për Trajnim të Vazhdueshme gjatë vitit 2025.....	67
6.3.4	Trajnuesit e angazhuar për zbatim të Programit për Trajnim të Vazhdueshme gjatë vitit 2025	69
6.4	ZHVILLIMI I PROGRAMEVE TRAJNUESE PËRMES ANALIZAVE HULUMTIMEVE DHE VEPRIMTARISË BOTUESE	71
6.5	AVANCIMI I MËTEJMË I METODOLOGJISË TRAJNUESE	78
6.6	BASHKËPUNIMI DHE KOORDINIMI ME PARTNERËT VENDOR, PARTNERËT NDËRKOMBËTARË, DONATORËT DHE INSTITUCIONET RELEVANTE TRAJNUESE NDËRKOMBËTARE.	79
7.	PLANIFIKIMI DHE EKZEKUTIMI I BUXHETIT DHE RAPORTI FINANCIAR.....	96
7.1	Menaxhimi i buxhetit dhe funksionimi financiar	97
7.2	Ekzekutimi i buxhetit	99
7.3	Analiza e shpenzimeve sipas kategorive dhe krahasimeve	100
	Mbështetja financiare nga donatorët	102
	Auditimi nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm.....	103

1.	SFIDAT E VITIT PARAPRAK DHE REKOMANDIMET PËR VITIN 2025	104
1.	Sfidat dhe rreziqet në fushën e financave dhe përmirësimit të infrastrukturës.....	104
2.	Shtojcat.....	106
2.	Aneksi I – Trajnimet e realizuar në të gjitha programet e AD-së	106
4.	Aneksi III-Aktivitetet e realizuara në PTV	106
5.	Aneksi IV-Trajnimet për bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor të gjykatave dhe prokurorive 106	
6.	Aneksi V-Trajnimet për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial	106
7.	Aneksi VI–Trajnimet për profesionet e lira.....	106
8.	Aneksi VII–Trajnimet per Trajnues	106
9.	Aneksi VIII–Trajnimet e detyrueshme sipas performances	106
10.	Aneksi IX-Platforma e mësimit ne distancë/ HELP	106
11.	Aneksi X- Aktivitetet e realizuara në PHP.....	106
12.	Aneksi XI-Aktivitetet me donatorë.....	106
	Shtojca 1. Tabela me indikatorët dhe performancën e AD-së për vitin 2025	107
	Aneksi I – Trajnimet e realizuar në të gjitha programet e AD-së	113
	Aneksi II-Trajnimet e realizuara në PTF gjatë vitit 2025	114
	Trajnimet e zbatuara për gjeneratën e XI të gjyqtarëve	114
	Aneksi III-Aktivitetet e realizuara në PTV	119
	Aneksi IV-Trajnimet për bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor të gjykatave dhe prokurorive	122
	Aneksi V-Trajnimet për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial	123
	Aneksi VI–Trajnimet për profesionet e lira	127
	Aneksi VII–Trajnimet per Trajnues.....	127
	Aneksi VIII–Trajnimet e detyrueshme sipas performances	127
	Aneksi IX-Platforma e mësimit ne distancë/ HELP	128
	Aneksi X- Aktivitetet e realizuara në PHP	128
	Aneksi XI-Aktivitetet me donatorë.....	128

Akronimet

ABEK - Asociacioni i Bibliotekave Elektronike të Kosovës

AD – Akademia e Drejtësisë

AQP – Agjencia Qendrore e Prokurimit

ANJF - Agjencioni për Ndihmë Juridike Falas

DHPGJS-Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme

EIFL - Electronic Information for Libraries

EJTN – European Judicial Training Network (Rrjeti Evropian i Trajnimit Gjyqësor)

ENM – L'École Nationale de la Magistrature

GIZ - Deutsche Gesellschaft fuer Internationale Zusammenarbeit

GJEDNJ – Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut

KDM – Kodi i Drejtësisë për të Mitur

KEDNJ – Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

KGJK – Këshilli Gjyqësor i Kosovës

KPK – Këshilli Prokurorial i Kosovës

KPPK – Kodi i Procedurës Penale i Kosovës

OSBE – Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

OPP - Oda e Përmbauesve Privat

PHP – Programi për Hulumtime dhe Publikime

PTF – Programi i Trajnimit Fillestar

PTV – Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm

SIMFK – Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës

TI – Teknologjia Informative

USAID - The United States Agency for International Development

UNDP-Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim

UNHCR-Zyra e Misionit në Kosovë

ZKA – Zyra e Kombëtare e Auditimit

FJALA HYRËSE

Viti 2025 për Akademinë e Drejtësisë shënoi një periudhë të rëndësishme të konsolidimit institucional dhe të zhvillimit të mëtejshëm të kapaciteteve profesionale në funksion të forcimit të sistemit të drejtësisë në Republikën e Kosovës. Në përputhje me mandatin ligjor dhe objektivat e Planit të Punës dhe të Performancës për vitin 2025, Akademia e Drejtësisë ka vazhduar të zbatojë programet e saj trajnuese dhe zhvillimore me synim ngritjen e cilësisë, profesionalizmit dhe efikasitetit të gjyqësorit dhe prokurorisë.

Gjatë periudhës raportuese, Akademia e Drejtësisë ka realizuar një numër të konsiderueshëm aktivitetesh trajnuese në kuadër të programeve të trajnimit fillestar dhe të trajnimit të vazhdueshëm. Këto programe kanë qenë të orientuara drejt përgatitjes profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapo emëruar, si dhe drejt avancimit të vazhdueshëm të njohurive dhe shkathtësive profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë, të stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial, si dhe të profesionistëve të tjerë ligjor.

Në kuadër të programit të trajnimit fillestar, gjatë vitit 2025 kanë vijuar trajnimet katër gjenerata të gjyqtarëve të sapo emëruar dhe një gjeneratë të prokurorëve të sapo emëruar, duke kontribuar në përgatitjen profesionale të një numri të konsiderueshëm të bartësve të funksioneve gjyqësore dhe prokuroriale. Paralelisht me këtë proces, Akademia e Drejtësisë ka organizuar një gamë të gjerë aktivitetesh trajnuese në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme, të cilat kanë trajtuar çështje aktuale të legjislacionit, zhvillimet në praktikën gjyqësore dhe standardet ndërkombëtare të drejtësisë.

Gjatë këtij viti është punuar gjithashtu në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve trajnuese, në avancimin e metodologjisë së trajnimit dhe në forcimin e kapaciteteve të trajnuesve të Akademisë së Drejtësisë. Në këtë drejtim, është vazhduar zbatimi i standardeve bashkëkohore të trajnimit dhe fuqizimi i mekanizmave për vlerësimin e performancës së trajnuesve dhe të programeve trajnuese.

Një vëmendje e veçantë gjatë këtij viti i është kushtuar edhe zhvillimit institucional dhe përmirësimit të bazës ligjore të Akademisë së Drejtësisë, me qëllim të forcimit të qëndrueshmërisë dhe funksionalitetit të saj. Në këtë kontekst, janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm në inicimin e hartimit dhe zhvillimit të akteve nënligjore, si dhe për avancimin e strukturës organizative dhe kapaciteteve profesionale.

Një dimension i rëndësishëm i veprimitarisë së Akademisë së Drejtësisë gjatë vitit 2025 ka qenë edhe bashkëpunimi me institucionet vendore dhe partnerët ndërkombëtarë, i cili ka kontribuar në shkëmbimin e përvojave profesionale, në harmonizimin e programeve trajnuese me standardet evropiane dhe në avancimin e mëtejshëm të kapaciteteve profesionale të sistemit të drejtësisë.

Raporti vjetor i punës dhe i performancës për vitin 2025 paraqet në mënyrë të detajuar aktivitetet, rezultatet dhe zhvillimet institucionale të Akademisë së Drejtësisë gjatë kësaj periudhe, duke ofruar një pasqyrë të qartë të progresit të arritur, sfidave të hasura dhe prioritetëve për zhvillimin e mëtejshëm të institucionit.

Akademia e Drejtësisë mbetet e përkushtuar që përmes programeve të saj trajnuese dhe aktiviteteve zhvillimore të kontribuojë në fuqizimin e kapaciteteve profesionale të sistemit të drejtësisë dhe në avancimin e sundimit të ligjit në Republikën e Kosovës.

Në fund, shpreh mirënjohjen time të thellë për të gjithë bashkëpunëtorët tanë institucionalë, partnerët ndërkombëtarë dhe donatorët për mbështetjen e vazhdueshme, si dhe për stafin e Akademisë së Drejtësisë për përkushtimin dhe profesionalizmin e treguar gjatë këtij viti.

Fejzullah Rexhepi,
Kryesues i Këshillit Drejtues

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Gjatë vitit 2025, Akademia e Drejtësisë ka vazhduar të ushtrojë mandatin e saj ligjor në funksion të zhvillimit profesional të sistemit të drejtësisë, duke konsoliduar rolin e saj si institucion kyç në ngritjen e kapaciteteve të gjyqtarëve, prokurorëve dhe përfituesve të tjerë sipas ligjit. Ky angazhim është reflektuar në hartimin dhe zbatimin e programeve trajnuese të bazuara në nevojat reale të praktikës gjyqësore dhe prokuroriale, si dhe në prioritetet strategjike në nivel nacional dhe ndërkombëtar.

Në këtë drejtim, Akademia e Drejtësisë ka siguruar një nivel të lartë koordinimi institucional me Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës, si dhe me kryetarët e gjykatave dhe kryeprokurorët e prokurorive, duke mundësuar një orientim të qartë të aktiviteteve trajnuese drejt sfidave konkrete të praktikës. Kjo qasje ka kontribuar në rritjen e relevancës dhe efektivitetit të programeve trajnuese, duke i lidhur ato drejtpërdrejt me zhvillimet në sistemin e drejtësisë.

Programi i Trajnimit Fillestar është realizuar në mënyrë intensive dhe të strukturuar për katër gjenerata të gjyqtarëve dhe një gjeneratë të prokurorëve të sapoemëruar, duke përfshirë module të avancuara që mbulojnë aspektet materiale dhe procedurale të funksionit, simulime të gjykimeve dhe komponentë të rëndësishëm nga e drejta e Bashkimit Evropian dhe të drejtat e njeriut. Ky program ka siguruar një kombinim të balancuar ndërmjet trajnimit teorik dhe praktik, duke kontribuar në përgatitjen profesionale të qëndrueshme të bartësve të rinj të funksioneve gjyqësore dhe prokuroriale dhe në rritjen e cilësisë së ushtrimit të funksionit në praktikë.

Në të njëjtën kohë, Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm ka adresuar një gamë të gjerë çështjesh komplekse dhe sfiduese, përfshirë dhunën në familje, të drejtat e njeriut, krimet e luftës, krimin e organizuar dhe korrupsionin, si dhe zhvillimet në fushën administrative dhe ndërdisiplinare. Përmes këtyre aktiviteteve është siguruar përfshirja e një spektri të gjerë përfituesish, duke përfshirë jo vetëm gjyqtarët dhe prokurorët, por edhe profesionistë të tjerë ligjor dhe institucional, duke reflektuar një qasje gjithëpërfshirëse në zhvillimin profesional të sistemit të drejtësisë.

Një komponent i rëndësishëm i veprimtarisë së Akademisë së Drejtësisë gjatë këtij viti ka qenë edhe zhvillimi i burimeve juridike dhe veprimtaria botuese, e cila është orientuar drejt mbështetjes së praktikës gjyqësore dhe prokuroriale. Përmes publikimeve dhe përmbledhjeve të praktikës gjyqësore në bashkëpunim me Gjykatën Supreme dhe partnerët ndërkombëtarë, Akademia ka kontribuar në unifikimin e praktikës gjyqësore, në rritjen e sigurisë juridike dhe në lehtësimin e zbatimit të legjislacionit në praktikë.

Në aspektin e cilësisë së trajnimeve, Akademia ka vazhduar të forcojë kapacitetet profesionale të trajnuesve dhe të avancojë metodologjinë trajnuese, duke e orientuar procesin e trajnimit drejt një modeli më interaktiv, praktik dhe të bazuar në zgjidhjen e problemeve konkrete. Angazhimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve nga instancat më të larta, si dhe i ekspertëve vendorë dhe ndërkombëtarë, ka siguruar një ndërthurje të rëndësishme të përvojës praktike dhe perspektivës krahasuese, duke ndikuar drejtpërdrejt në cilësinë e trajnimeve dhe në performancën e përfituesve.

Gjatë vitit 2025, Akademia e Drejtësisë ka zhvilluar gjithashtu bashkëpunimin me partnerët vendor dhe ndërkombëtarë, duke marrë pjesë në konferenca dhe forume rajonale dhe ndërkombëtare, si dhe duke mundësuar pjesëmarrjen e përfituesve në programe trajnimi jashtë vendit. Mbështetja e donatorëve ka vazhduar të luajë një rol të rëndësishëm në realizimin e aktiviteteve trajnuese, duke

kontribuar me ekspertizë dhe mbështetje financiare në fusha prioritare, veçanërisht në të drejtën penale dhe të drejtat e njeriut.

Në aspektin institucional, gjatë këtij viti është shënuar progres i rëndësishëm në zhvillimin dhe konsolidimin e kapaciteteve të brendshme të Akademisë së Drejtësisë. Një arritje e veçantë ka qenë avancimi i reformës normative, përmes inicimit të hartimit të një numri të konsiderueshëm aktesh nënligjore që rrjedhin nga legjislacioni për zyrtarët publikë, duke mundësuar rregullimin e statusit të nëpunësve civilë me status të veçantë dhe forcimin e bazës ligjore të funksionimit institucional.

Në tërësi, gjatë vitit 2025, Akademia e Drejtësisë ka arritur të realizojë një volum të konsiderueshëm aktiviteteve trajnuese dhe zhvillimore, duke kontribuar në ngritjen e kapaciteteve profesionale, në përmirësimin e cilësisë së vendimmarrjes dhe në forcimin e rolit të saj në sistemin e drejtësisë.

Këto arritje reflektojnë një progres të qëndrueshëm institucional dhe krijojnë një bazë solide për zhvillimin e mëtejshëm të Akademisë së Drejtësisë në funksion të përmbushjes së objektivave strategjike dhe të procesit të integritetit evropian.

2. KORNIZA LIGJORE

Akademia e Drejtësisë ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin baze në fuqi të Republikës së Kosovës, i cili përcakton mandatin, kompetencat dhe organizimin institucional të saj në funksion të zhvillimit profesional të sistemit gjyqësor dhe prokurorial.

Baza ligjore e veprimtarisë së Akademisë mbështetet në Ligjin Nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë, si dhe në Ligjin Nr. 08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave të llogaridhënies së agjencive të pavarura, përkatësisht përkatësisht dispozitat kapitullin IV që rregullojnë ndryshimet në organizimin dhe funksionimin e Akademisë.

Përveç këtyre ligjeve themelore, veprimtaria e Akademisë zhvillohet edhe në përputhje me legjislacionin përkatës që rregullon sistemin gjyqësor dhe prokurorial në Republikën e Kosovës, si dhe me kornizën ligjore që ndërlidhet me administratën publike dhe statusin e nëpunësve civilë.

Në përputhje me këtë bazë ligjore, Akademia e Drejtësisë ka mandat të zhvillojë dhe zbatojë programet e trajnimit fillestar për gjyqtarët dhe prokurorët e sapoemëruar, të organizojë trajnime të vazhdueshme për gjyqtarët, prokurorët, stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial, si dhe për profesionistë të tjerë ligjor. Po ashtu, ajo ushtron veprimtari në fushën e hulumtimeve dhe publikimeve juridike, si dhe zhvillon bashkëpunim institucional në nivel vendor dhe ndërkombëtar në funksion të ngritjes së kapaciteteve profesionale të sistemit të drejtësisë.

Në zbatim të kësaj kornize ligjore, funksionimi dhe organizimi i Akademisë rregullohet përmes një sërë aktesh nënligjore dhe rregulloresh të brendshme, të cilat operacionalizojnë dispozitat ligjore dhe përcaktojnë në mënyrë të detajuar strukturën organizative, procedurat e punës dhe zhvillimin e aktiviteteve institucionale.

Aktet kryesore nënligjore që rregullojnë funksionimin e Akademisë së Drejtësisë janë:

- Rregullore Nr. 02/2017 për Punën e Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë;
- Rregullore Nr. 02/2023 për Plotësim dhe Ndryshmin e Rregullores Nr. 02/2017 për Punën e Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë;
- Rregullore Nr. 04/2017 për Punën e Këshillit Programor të Akademisë së Drejtësisë;
- Rregullore Nr. 03/2023 për Plotësim dhe Ndryshmin e Rregullores Nr. 04/2017 për Punën e Këshillit Programor të Akademisë së Drejtësisë;
- Rregullore Nr. 05/2017 për Tarifat e Trajnimeve për Avokat Shtetëror, Avokatë dhe Profesionet e Tjera të Lira;
- Rregullore Nr. 02/2019 për Trajnuesit dhe Mentorët e Akademisë së Drejtësisë;
- Rregullore Nr. 01/2023 për Plotësim dhe Ndryshmin e Rregullores Nr.02/2019 për Trajnuesit dhe Mentorët e Akademisë së Drejtësisë.
- Rregullore Nr. 02/2024 për plotësim ndryshimin e rregullores nr. 01/2023 për Trajnuesit dhe Mentorët e Akademisë së Drejtësisë
- Rregullorja Nr. 04/2023 për Pranimin dhe Emërimin e Drejtorit Ekzekutiv të Akademisë së Drejtësisë;
- Rregullore Nr.05/2023 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Akademinë e Drejtësisë
- Rregullore Nr. 01/2025 për plotësim ndryshimin e rregullores nr. 05/2023 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Akademinë e Drejtësisë.

Në aspektin analitik, kjo bazë ligjore përbën themelin për funksionimin institucional të Akademisë dhe për zbatimin e mandatit të saj në zhvillimin profesional të bartësve të funksioneve gjyqësore dhe prokuroriale.

2.1 Përmirësimi i bazës ligjore në periudhën raportuese

Gjatë periudhës raportuese janë ndërmarrë aktivitete të rëndësishme për përmirësimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të bazës ligjore dhe rregullative të Akademisë së Drejtësisë.

Në këtë kuadër, është realizuar plotësim-ndryshimi i Rregullores Nr. 05/2023 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, me qëllim të përshtatjes së strukturës organizative me nevojat funksionale dhe zhvillimet institucionale.

Gjithashtu, bazuar në Vendimin e Këshillit Drejtues Nr. 01/684/2025, janë themeluar dy komisione për hartimin e akteve nënligjore që rregullojnë statusin e veçantë të nëpunësve civilë të Akademisë së Drejtësisë, në pajtim me nenin 6, paragrafi 3 i Ligjit nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 08/L0197 për Zyrtarët Publik që synojnë rregullimin më të detajuar të marrëdhënieve të punës, menaxhimit të burimeve njerëzore, disiplinës dhe vlerësimit të performancës si dhe funksionimit të përgjithshëm institucional.

Në këtë kuadër janë në proces hartimi një numër i konsiderueshëm projekt-rregulloresh si ne vijim:

- Projekt-rregullorja për procedurën e pranimit;
- Projekt-rregullorja për vlerësimin e rezultateve në punë;
- Projekt-rregullorja për pezullimin nga marrëdhënia e punës;
- Projekt-rregullorja për përfundimin e marrëdhënies së punës;
- Projekt-rregullorja për themelimin e marrëdhënies së punës me kontratë për periudhë të caktuar;
- Projekt-rregullorja për orarin, pushimet dhe vijueshmërinë në punë;

- Projekt-rregullorja për disiplinën dhe ankesat;
- Projekt-rregullorja për transferimin;
- Projekt-rregullorja për vlerësimin e pamjaftueshmërisë profesionale në shërbimin civil;
- Projekt-rregullorja për planifikimin e personelit;
- Projekt-rregullorja për dosjen individuale dhe sistemin informativ të menaxhimit të burimeve njerëzore;
- Projekt-rregullorja për trajnimin;
- Projekt-rregullorja për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në AD;
- Projekt-rregullorja për klasifikimin e vendeve të punës;
- Projekt-rregullorja për pranimin, vlerësimin dhe disiplinën e Drejtorit Ekzekutiv;
- Projekt-rregullorja për shtesat dhe kompensimet tjera të nëpunësve të AD-së, këshilltarëve dhe ekspertëve;
- Kodi i etikës për nëpunësit e AD-së;
- Projekt-rregullorja për udhëtimet zyrtare dhe shpenzimet e përfaqësimit;
- Projekt-rregullorja për përdorimin e automjeteve zyrtare;
- Projekt-rregullorja për përdorimin e telefonisë fikse dhe mobile.

Në kete aspekt, është inicuar avancimi i bazes rregullative te Akademisë se Drejtësisë dhe janë krijuar parakushte për rritjen e efikasitetit dhe profesionalizmit në funksionimin institucional. Andaj, këto zhvillime përfaqësojnë një reformë të rëndësishme të brendshme, e cila synon krijimin e një kornize të qartë dhe funksionale për menaxhimin institucional dhe për zhvillimin afatgjatë të Akademisë se Drejtësisë.

2.2 Vështirësitë ligjore që ka hasur institucioni në përmbushjen e misionit të vet

Në raportet vjetore të viteve të kaluara janë identifikuar në mënyrë të vazhdueshme disa sfida ligjore që ndërlidhen me zbatimin e plotë të mandatit të Akademisë së Drejtësisë.

Këto sfida kanë të bëjnë kryesisht me nevojën për përmirësimin dhe plotësimin e mëtejshëm të kornizës ligjore që rregullon funksionimin e institucionit, veçanërisht në aspektin e mundësisë për nxjerrjen e akteve të tjera nënligjore të domosdoshme për rregullimin më të detajuar të disa funksioneve të Akademisë se Drejtësisë.

Në praktikë janë identifikuar disa çështje që kërkojnë rregullim më të detajuar ligjor, veçanërisht në fushën e zhvillimit të programeve të trajnimit të vazhdueshëm, aktivitetëve hulumtuese dhe botuese, organizimit të brendshëm të Akademisë së Drejtësisë, si dhe në rregullimin e disa proceseve institucionale që lidhen me funksionimin dhe zhvillimin e saj.

Në këtë drejtim, gjatë viteve të fundit janë ndërmarrë iniciativa për rishikimin e Ligjit për Akademinë e Drejtësisë madje në kete kontekst është përgatitur edhe një koncept-dokument për ligjin e ri, i cili ishte miratuar nga Qeveria në vitin 2023 dhe ka adresuar zgjidhjen e disa çështjeve ligjore që ndërlidhen me funksionimin dhe zhvillimin institucional të Akademisë.

Po ashtu, gjatë procesit të rishikimit të kornizës ligjore duhte të mirren në konsideratë dhe të transpozohen në legjislacione të ardhshme edhe rekomandimet e dhëna nga Komisioni i Venecias të Këshillit të Evropës, të cilat kanë adresuar disa çështje që lidhen me organizimin institucional, kompetencat dhe funksionimin e Akademisë së Drejtësisë në raport me institucionet e tjera të sistemit të drejtësisë.

Gjatë vitit 2025, Projektligji për Akademinë e Drejtësisë, i cili është pjesë e paketës së ligjeve të drejtësisë, vazhdon të jetë në procedurë. Vijimi i hapave të mëtejshme në këtë proces nuk është në kompetencë të Akademisë së Drejtësisë, por të institucioneve përgjegjëse për hartimin dhe procedimin e legjislacionit, përkatësisht Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve të tjera relevante.

Pritet që miratimi dhe hyrja në fuqi e ligjit të ri për Akademinë e Drejtësisë të adresojë një pjesë të pengesave të identifikuar në zbatimin e ligjit aktual, duke mundësuar rregullimin më të detajuar të funksioneve ligjore të Akademisë përmes akteve nënligjore dhe duke kontribuar në forcimin e rolit të saj në zhvillimin profesional të sistemit të drejtësisë.

Pavarësisht këtyre sfidave ligjore, Akademia e Drejtësisë ka vazhduar të realizojë mandatin e saj institucional përmes organizimit dhe zhvillimit të programeve trajnuese për gjyqtarët, prokurorët dhe profesionistët e tjerë ligjorë, duke kontribuar në forcimin e kapaciteteve profesionale të sistemit të drejtësisë në Republikën e Kosovës.

3. PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT

Akademia e Drejtësisë është institucion publik dhe i pavarur, i themeluar me ligj, veprimtaria e të cilit është në funksion të zhvillimit dhe avancimit të kapaciteteve profesionale të sistemit gjyqësor dhe prokurorial në Republikën e Kosovës .

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për Akademinë e Drejtësisë, institucioni është përgjegjës për organizimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimit fillestar për gjyqtarët dhe prokurorët e sapo emëruar, si dhe për organizimin e trajnimeve të vazhdueshme për gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë, stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial si dhe profesionistët e tjerë ligjor.

Përmes programeve të saj trajnuese dhe aktiviteteve profesionale, Akademia e Drejtësisë kontribuon në ngritjen e cilësisë dhe profesionalizmit të sistemit të drejtësisë, duke mbështetur zhvillimin e njohurive juridike, aftësive profesionale dhe standardeve etike të bartësve të funksioneve gjyqësore dhe prokuroriale.

Përveç aktiviteteve trajnuese, Akademia Drejtësisë zhvillon analiza dhe hulumtime juridike, si dhe realizon veprimtari botuese, duke kontribuar në mbështetjen e zhvillimit profesional të sistemit gjyqësor dhe prokurorial dhe në avancimin e praktikës gjyqësore dhe prokuroriale.

Në realizimin e mandatit të saj institucional, Akademia e Drejtësisë bashkëpunon ngushtë me institucionet kryesore të sistemit të drejtësisë në Republikën e Kosovës, përfshirë Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Këshillin Prokurorial të Kosovës, gjykatat dhe prokuroritë, Ministrinë Drejtësisë, si dhe me partnerët dhe organizatat ndërkombëtare që mbështesin zhvillimin e kapaciteteve profesionale të sistemit të drejtësisë.

Në vijim të këtij kapitulli paraqiten misioni dhe vizioni i Akademisë së Drejtësisë, të cilat përcaktojnë orientimin strategjik të institucionit në përmbushjen e mandatit të saj.

Në kete kontekst roli i Akademisë ka evoluar nga një institucion trajnues në një mekanizëm strategjik që ndërlidh zhvillimin profesional me cilësinë e drejtësisë, zhvillimin dhe zbatimin e proceseve reformuese në vend.

3.1 Misioni Vizioni

3.2 Misioni

Misioni i Akademisë së Drejtësisë është të ofrojë trajnim cilësor gjyqësor për gjyqtarë, prokurorë dhe stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial, si dhe për profesionistë të tjerë në sistemin e drejtësisë, përmes programeve të trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm, aktiviteteve hulumtuese dhe veprimtarisë botuese, në përputhje me kornizën ligjore dhe standardet më të mira ndërkombëtare.

Përmes këtij misioni, Akademia synon të kontribuojë në rritjen e profesionalizmit, integritetit dhe efikasitetit të sistemit të drejtësisë në Republikën e Kosovës. në përputhje me standardet ligjore dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare.

3.3 Vizioni

Vizioni i Akademisë së Drejtësisë është të shërbejë si *institucion modern dhe profesional i të mësuarit, i përshtatur ndaj zhvillimeve dinamike të sistemit të drejtësisë, duke kontribuar në ndërtimin e një gjyqësori të paanshëm, të pavarur dhe efikas që gëzon besimin e publikut.*

Në këtë drejtim, Akademia synon të avancojë vazhdimisht programet dhe metodologjinë e saj trajnuese, si dhe të forcojë bashkëpunimin me institucionet vendore dhe ndërkombëtare, me qëllim të harmonizimit të praktikave trajnuese me standardet evropiane në fushën e drejtësisë.

3.4 Kompetencat e AD-së sipas ligjit

Bazuar në kompetencat e përcaktuara me legjislacionin në fuqi, Akademia e Drejtësisë ushtron funksionet si në vijim:

- a. Harton programet e trajnimit dhe organizon trajnimet për gjyqtarë dhe prokurorë të shtetit në pajtim me legjislacionin në fuqi;
- b. Zhvillon procesin e vlerësimit të nevojave për trajnime përmes mekanizmave të përcaktuara nga Akademia, dhe në bazë të kërkesave të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (më tej: KGJK), Këshillit Prokurorial të Kosovës (më tej: KPK)
- c. Organizon trajnime për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial, pas koordinimit paraprak të nevojave për trajnime me KGJK-në dhe KPK-në, në pajtim me legjislacionin në fuqi;
- d. Mund të organizojë trajnime të vazhdueshme profesionale për avokat shtetëror, avokat, noter, përmbarues privat, ndërmjetësues, administratorë falimentues, si dhe profesione tjera në bazë të vlerësimeve të Akademisë, sipas kërkesave të institucioneve kompetente.
- e. Zhvillon dhe realizon programet e trajnimeve në bashkëpunim me KGJK-në dhe KPK-në, Odat e profesioneve të lira apo institucionet përkatëse;
- f. Mban të dhëna për trajnime dhe programe që realizohen në Akademi në pajtim me legjislacionin në fuqi;
- g. Mban të dhëna për trajnime dhe programe që realizohen në Akademi në pajtim me legjislacionin në fuqi;
- h. Vendosë dhe mbanë bashkëpunim me institucionet vendore dhe institucionet e huaja të ngjashme lidhur me punët të cilat i kryen, duke përfshirë praktikatat profesionale dhe programet e shkëmbimit;
- i. Kryen analiza, hulumtime dhe bashkëpunon me institucionet shkencore;

- j. Kryen veprimtari botuese në përmbushje të mandatit për nevojat e sistemit gjyqësor dhe prokurorial dhe profesioneve të lira;
- k. Kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me ligj dhe me akte tjera të Akademisë.

4. FUSHËVEPRIMI I AKADEMISË SE DREJTËSISË

Fushëveprimi i Akademisë së Drejtësisë është përcaktuar me Ligjin për Akademinë e Drejtësisë dhe aktet-nenligjore në fuqi, të cilat rregullojnë organizimin, funksionimin dhe kompetencat e institucionit .

Në përmbushje të mandatit të saj ligjor, Akademia e Drejtësisë zhvillon dhe realizon aktivitete që kanë për qëllim ngritjen e kapaciteteve profesionale të sistemit gjyqësor dhe prokurorial në Republikën e Kosovës, duke kontribuar drejtpërdrejt në rritjen e cilësisë, efikasitetit dhe profesionalizmit të drejtësisë.

Veprimtaria e Akademisë është e orientuar në aftësimin profesional të gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapo emëruar, si dhe në zhvillimin e vazhdueshëm profesional të gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë. Po ashtu, në kuadër të këtij fushëveprimi, Akademia realizon trajnime edhe për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial, si dhe, sipas nevojave dhe mundësive, edhe për profesionet e lira që lidhen me sistemin e drejtësisë.

Këto aktivitete realizohen përmes zhvillimit dhe zbatimit të programeve trajnuese, përgatitjes së materialeve profesionale dhe zhvillimit të burimeve juridike, në përputhje me nevojat e identifikuara përmes proceseve të vlerësimit të nevojave trajnuese, si dhe në koordinim të ngushtë me institucionet relevante të sistemit të drejtësisë. Andaj, fushëveprimi i Akademisë reflekton një qasje të integruar që ndërlihdh zhvillimin profesional me prioritetet e sistemit të drejtësisë dhe me proceset reformuese në vend, duke e pozicionuar Akademinë si një mekanizëm kyç në mbështetje të sundimit të ligjit.

Në këtë kontekst, gjatë vitit 2025, Akademia e Drejtësisë ka realizuar një gamë të gjerë aktiviteteve trajnuese dhe profesionale, të strukturuar në programe dhe fusha të ndryshme të veprimit institucional.

Në vijim bazuar në Ligjin Nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë, si dhe në Ligjin Nr. 08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që lidhen me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të agjencive të pavarura, Akademia e Drejtësisë është një institucion publik i pavarur, me mandat dhe kompetenca të qarta ligjore në fushën e zhvillimit profesional dhe ngritjes së kapaciteteve të sistemit të drejtësisë.

Në pajtim me nenin 6 të Ligjit Nr. 05/L-095, funksionet kryesore të Akademisë së Drejtësisë përfshijnë:

- Zhvillimi dhe zbatimi i programeve të trajnimit
 - ❖ Hartimi i programeve të trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm për gjyqtarë dhe prokurorë të shtetit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
 - ❖ Organizimi i trajnimeve për këto kategori në përmbushje të mandatit të saj ligjor.

- Identifikimi dhe vlerësimi i nevojave për trajnim
 - ❖ Zhvillimi i procesit të vlerësimit të nevojave për trajnime përmes mekanizmave të përcaktuar nga Akademia.
 - ❖ Harmonizimi i planifikimit të trajnimeve me kërkesat e KGJK-së dhe KPK-së.
- Trajnimi i stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial
 - ❖ Organizimi i trajnimeve për stafin administrativ të gjykatave dhe prokurorive, pas koordinimit paraprak me KGJK-në dhe KPK-në, në pajtim me legjislacionin në fuqi.
- Trajnimi i profesioneve të lira që lidhen me sistemin e drejtësisë
 - ❖ Mundësinë e organizimit të trajnimeve të vazhdueshme profesionale për avokatinë shtetërore, avokatë, noterë, përmbarues privatë, ndërmjetësues, administratorë të falimentimit dhe profesione të tjera të ngjashme, sipas vlerësimit të Akademisë dhe kërkesave të institucioneve kompetente.
- Zbatimi i programeve trajnuese në bashkëpunim institucional
 - ❖ Zbatimi i programeve trajnuese në bashkëpunim me KGJK-në, KPK-në, Odat profesionale dhe institucionet përkatëse.
- Administrimi i sistemit të të dhënave dhe dokumentacionit të trajnimeve
 - ❖ Vendosjen dhe mirëmbajtjen e sistemit të të dhënave për programet dhe aktivitetet trajnuese në pajtim me legjislacionin në fuqi.
- Bashkëpunimi ndërinstitucional në nivel vendor dhe ndërkombëtar
 - ❖ Krijimin, vendosjen dhe mirëmbajtjen e bashkëpunimit me institucione vendore dhe të huaja të ngjashme me veprimtarinë e Akademisë, duke përfshirë praktikat profesionale, programet e shkëmbimit dhe aktivitetet e tjera të interesit të përbashkët.
- Zhvillimi i analizave dhe hulumtimeve profesionale
 - ❖ Zhvillimi i analizave, hulumtimeve dhe bashkëpunimin me institucionet shkencore për përkrahjen e sistemit të drejtësisë dhe zhvillimin profesional.
- Veprimtaria botuese
 - ❖ Realizimi i botimeve profesionale për nevojat e sistemit gjyqësor dhe prokurorial, përfshirë materiale, udhëzues dhe dokumente tjera të nevojshme ligjore.

Pra, vija llogaridhënëse e Akademisë së Drejtësisë, në përputhje me Ligjin Nr. 08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që lidhen me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të agjencive të pavarura, mandaton Këshillin Drejtues si subjektin e vetëm të raportimit dhe llogaridhënies. Kjo garanton funksionimin e Akademisë në përputhje me parimet e pavarësisë, transparencës dhe përgjegjshmërisë institucionale.

4.1 Organizimi, veprimtaria dhe personeli

Akademia e Drejtësisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, është institucioni përgjegjës për zhvillimin profesional të gjyqtarëve, prokurorëve, stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial, si dhe profesionistëve të tjerë ligjor në Republikën e Kosovës. Përmes ushtrimit të këtij mandati, Akademia kontribuon në mënyrë të drejtpërdrejtë në forcimin e sundimit të ligjit, rritjen e cilësisë së vendimmarrjes dhe avancimin e efikasitetit të sistemit të drejtësisë.

Veprimtaria e Akademisë së Drejtësisë gjatë vitit 2025 është zhvilluar në përputhje me kornizën ligjore në fuqi, e cila përcakton organizimin, funksionimin dhe përgjegjësitë e saj institucionale.

Në këtë periudhë, vëmendje e veçantë i është kushtuar avancimit të bazës ligjore dhe rregullative, veçanërisht në kontekst të reformave në administratën publike dhe rregullimit të statusit të veçantë të të punësuarve në Akademi. Në këtë drejtim, janë ndërmarrë aktivitete për hartimin dhe zhvillimin e akteve nënligjore, me qëllim të përcaktimit më të qartë të marrëdhënieve të punës, organizimit të brendshëm dhe funksionimit institucional.

Këto zhvillime përfaqësojnë një hap të rëndësishëm drejt konsolidimit të mëtejshëm institucional dhe krijimit të një strukture më funksionale dhe të qëndrueshme, e cila mundëson ushtrimin më efikas të mandatit të Akademisë.

Struktura organizative e Akademisë së Drejtësisë është ndërtuar në funksion të përmbushjes së mandatit të saj dhe realizimit të aktiviteteve në mënyrë efikase dhe të koordinuar.

Pra, Akademia e Drejtësisë ushtron kompetencat dhe funksionet e saj përmes organeve kryesore të përcaktuara me Ligjin për Akademinë e Drejtësisë, përkatësisht:

- Këshillit Drejtues;
- Këshillit Programor; dhe
- Drejtorit Ekzekutiv.

Këto organe përbëjnë bazën e qeverisjes institucionale të Akademisë, duke siguruar orientim strategjik, mbikëqyrje të funksionimit të institucionit dhe zbatimin e aktiviteteve në përputhje me mandatin ligjor. Organizimi i brendshëm i Akademisë së Drejtësisë është i rregulluar me Rregulloren Nr. 05/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës, si dhe ndryshimet përkatëse, e cila përcakton strukturën organizative, shpërndarjen e përgjegjësisë dhe funksionimin e njësive organizative brenda institucionit.

Në përputhje me këtë rregullore, struktura organizative e Akademisë është ndërtuar në funksion të realizimit efikas të mandatit të saj dhe përbëhet nga dy departamente kryesore dhe njësitë përkatëse organizative si ne vijim:


- Departamenti i Programeve Trajnuese, i cili përfshin katër (4) divizione funksionale që mbulojnë:
 - trajnimin fillestar të gjyqtarëve dhe prokurorëve;
 - trajnimin e vazhdueshëm;
 - trajnimet për stafin administrativ dhe profesionet e lira;
 - analizat, hulumtimet dhe veprimtarinë botuese;
- Departamenti për Shërbime Ligjore dhe të Përgjithshme, i cili përfshin tri (3) divizione që mbështesin funksionimin institucional, përkatësisht:
 - shërbimet ligjore dhe bashkëpunimin ndër-institucional;
 - teknologjinë e informacionit;
 - mbështetjen administrative dhe logjistike.

Përveç këtyre departamenteve, në strukturën organizative të Akademisë funksionojnë edhe njësi dhe pozita të veçanta organizative që kanë rol kyç në menaxhimin financiar dhe administrativ të institucionit, si:

- Divizioni për Buxhet dhe Financa;

- Zyrtari i Lartë për Burime Njerëzore;
- Zyrtari i Certifikimit;
- Zyrtari i Prokurimit.

Struktura organizative e Akademisë së Drejtësisë gjatë vitit 2025 paraqitet në mënyrë të detajuar në Grafikonin nr. 1, i cili ilustron organizimin institucional dhe ndërlidhjen funksionale ndërmjet organeve drejtuese dhe njësive organizative.



Grafikoni 1: Struktura e brendshme organizative e AD-së

Në aspektin analitik, struktura organizative e Akademisë së Drejtësisë reflekton një model funksional që ndërlidh drejtpërdrejt programet trajnuese me shërbimet mbështetëse, duke krijuar një balancë ndërmjet dimensionit profesional dhe atij administrativ të institucionit.

Kjo ndarje në departamente dhe divizione ka mundësuar:

- specializimin e funksioneve sipas fushave përkatëse;
- koordinimin më efikas të aktiviteteve trajnuese dhe mbështetëse;
- rritjen e kapaciteteve për planifikim dhe zbatim të programeve;

Megjithatë, në kontekst të zhvillimit të mëtejshëm institucional dhe zgjerimit të aktiviteteve, struktura ekzistuese kërkon fuqizim të vazhdueshëm në aspektin e burimeve njerëzore dhe kapaciteteve profesionale, veçanërisht në fushat që ndërlidhen me digjitalizimin dhe hulumtimin.

Si rezultat i këtij organizimi, Akademia e Drejtësisë ka arritur të sigurojë funksionim të qëndrueshëm institucional dhe të realizojë në mënyrë efektive programet dhe aktivitetet e planifikuara gjatë vitit 2025, duke mbështetur zhvillimin profesional të sistemit gjyqësor dhe prokurorial në vend.

4.2 Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë e Akademisë, duke mbikëqyrur zhvillimin dhe implementimin e politikave dhe strategjive të saj. Ai është përgjegjës për mbikëqyrjen e punës së Akademisë së Drejtësisë dhe siguron që ajo të funksionojë në përputhje me ligjin dhe rregulloret përkatëse.

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë është organi më i lartë drejtues ka rol kyç në udhëheqjen, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e institucionit, i cili përcakton e drejtimin strategjik dhe siguron funksionimin e qëndrueshëm dhe efektiv të Akademisë së Drejtësisë.

Në ushtrimin e mandatit të tij, Këshilli Drejtues mbikëqyr zhvillimin dhe zbatimin e politikave, strategjive të Akademisë së Drejtësisë, si dhe siguron që aktivitetet e saj të zhvillohen në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet nënligjore përkatëse.

Përbërja e Këshillit Drejtues është shumëdimensionale dhe reflekton përfaqësim të gjerë institucional nga organet kryesore të sistemit gjyqësor dhe prokurorial në Republikën e Kosovës.

Këshilli Drejtues përbëhet nga nëntë (9) anëtarë për një mandat prej katër (4) vitesh, nga të cilët dy (2) janë anëtarë ex officio:

- Kryetari i Gjykatës Supreme;
- Kryeprokurori i Shtetit.

Ndërsa shtatë (7) anëtarët e tjerë emërohen nga institucionet përkatëse, si në vijim:

- tre (3) anëtarë të emëruar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), përkatësisht:
 - një (1) gjyqtar nga Gjykata Themelore;
 - një (1) gjyqtar nga Gjykata e Apelit;
 - një (1) përfaqësues nga Sekretariati i KGJK-së;
- tre (3) anëtarë të emëruar nga Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), përkatësisht:
 - një (1) prokuror nga Prokuroria Themelore;
 - një (1) prokuror nga Prokuroria e Apelit;
 - një (1) përfaqësues nga Sekretariati i KPK-së;
 - një (1) anëtar i emëruar nga Ministria e Drejtësisë.

Vlen të theksohet se në nëntor të vitit 2025 ka përfunduar mandati i përfaqësuesit të Ministrisë së Drejtësisë në Këshillin Drejtues. Për rrjedhojë, gjatë periudhës raportuese, Këshilli Drejtues ka funksionuar me tetë (8) anëtarë, duke qenë në pritje të emërimit të përfaqësuesit të ri nga Ministria e Drejtësisë.

Gjatë vitit 2025, organet drejtuese të Akademisë, përfshirë Këshillin Drejtues dhe Këshillin Programor, kanë ushtruar në mënyrë aktive kompetencat e tyre, duke siguruar orientim strategjik, miratim të dokumenteve kyçe dhe mbikëqyrje të zbatimit të aktiviteteve.

Vendimarrja e këtyre organeve ka qenë e fokusuar në zhvillimin e programeve trajnuese, avancimin e proceseve të brendshme institucionale dhe përmirësimin e funksionimit të përgjithshëm të Akademisë.

Në përputhje me legjislacionin në fuqi, Këshilli Drejtues ushtron kompetencat kryesore si në vijim:

- Miraton aktet nënligjore të përcaktuara me ligj;
- Miraton projektbuxhetin e Akademisë;
- Miraton strategjinë zhvillimore, planin e punës dhe programin e trajnimeve;
- Miraton listën e trajnerëve dhe mentorëve;
- Mbikëqyr punën e Akademisë;
- Përcakton prioritetet e trajnimeve në bashkëpunim me KGJK-në dhe KPK-në;
- Zgjedh dhe shkarkon Drejtorin Ekzekutiv;
- Emëron dhe shkarkon anëtarët e Këshillit Programor;
- Kryen detyra të tjera të përcaktuara me ligj dhe aktet nënligjore.

Gjatë vitit 2025, Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë ka mbajtur gjithsej shtatë (7) takime, në të cilat janë shqyrtuar dhe miratuar një numër i konsiderueshëm vendimesh me rëndësi për funksionimin dhe zhvillimin e Akademisë. Gjatë vitit 2025, veprimtaria e Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë është zhvilluar në përputhje me prioritetet strategjike të sistemit të drejtësisë dhe kërkesat që rrjedhin nga procesi i integritetit evropian.

Programet trajnuese dhe aktivitetet e tjera janë orientuar drejt përafrimit me praktikën me mira, duke reflektuar rekomandimet e institucioneve ndërkombëtare dhe nevojën për forcimin e kapaciteteve profesionale në funksion të një sistemi drejtësie të besueshëm dhe efikas.

Në periudhën raportuese, Këshilli Drejtues është fokusuar në shqyrtimin dhe miratimin e çështjeve kryesore, ndër të cilat:

- raportin vjetor të punës dhe të performancës për vitin 2024;
- listën e trajnuesve të përkohshëm;
- listat e mentorëve;
- projekt-buxhetin e Akademisë së Drejtësisë;
- kërkesat e KGJK-së dhe KPK-së për fillimin e trajnimit fillestar për gjyqtarët dhe prokurorët në procesin e rekrutimit;
- programin trajnues dhe planin e performancës për vitin 2026;
- si dhe çështje të tjera të rëndësishme që kanë lindur gjatë vitit 2025.

Ndër vendimet kryesore të marra nga Këshilli Drejtues gjatë kësaj periudhe përfshihen:

- fillimi i trajnimit teorik pa ndërprerje prej gjashtë (6) muajsh për 15 gjyqtarët e sapoemëruar të gjeneratës XI, të dekretuar më 16 janar 2024;
- shqyrtimi i raportit vjetor të punës dhe të performancës për vitin 2024;
- formimi i komisionit për shqyrtimin e ankesave mbi rezultatet e testit në DTF për gjyqtarët dhe prokurorët e shtetit;
- miratimi i kërkesës buxhetore për periudhën 2026–2028;
- miratimi i grupit të trajnuesve për hartimin e Programit Trajnues 2026;
- miratimi i Programit Fillestar për gjeneratat XIII dhe XIV të gjyqtarëve dhe fillimi i zbatimit të programit për këto gjenerata;

- miratimi i kërkesës së gjyqtarëve të Gjykatës Supreme për publikimin e përmbledhjes së praktikës gjyqësore;
- miratimi i Planit të Punës dhe Performancës për vitin 2026;
- miratimi i Programit Trajnues për vitin 2026;
- miratimi i protokolleve me KGJK lidhur me trajnimet e detyrueshme të gjyqtarëve;
- plotësimi i përbërjes së Këshillit Programor me dy (2) anëtarë;
- rizgjatja e mandatit të dytë për katër (4) anëtarë të Këshillit Programor të emëruar në vitin 2021;
- plotësimi i Këshillit Drejtues me një (1) anëtare nga Keshilli Prokurorial nga radhet e prokurorive themelore;
- themelimi i komisioneve për hartimin e pakos akteve nenligjore;
- miratimi i Rregullores nr. 05/2025 për plotësim/ndryshim të Rregullores nr. 05/2023 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në AD;
- miratimi i kërkesës së KGJK për organizimin e trajnimeve për stafin administrativ të KGJK-së;
- formimi i paneleve për vlerësimin e provimit përfundimtar dhe për trajtimin e ankesave në programin fillestar;
- vlerësimi i performancës së trajnuesve të përkohshëm të Akademisë së Drejtësisë për vitin 2025.

4.3 Këshilli Programor i Akademisë së Drejtësisë

Këshilli Programor është organ profesional i Akademisë së Drejtësisë, i cili ka rol të rëndësishëm në zhvillimin, përmirësimin dhe sigurimin e cilësisë së programeve trajnuese të institucionit .

Në ushtrimin e mandatit të tij, Këshilli Programor kontribuon në hartimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimit, duke siguruar që ato të jenë në përputhje me nevojat reale të sistemit gjyqësor dhe prokurorial, si dhe me standardet bashkëkohore në fushën e drejtësisë.

Ky organ bashkëpunon ngushtë me organet drejtuese të Akademisë, si dhe me institucionet kryesore të sistemit të drejtësisë, përfshirë Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK) dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës (KPK), me qëllim identifikimin e prioriteteve për trajnim dhe zhvillimin e programeve përkatëse.

Në përputhje me legjislacionin në fuqi, Këshilli Programor përbëhet nga shtatë (7) anëtarë, të cilët emërohen nga Këshilli Drejtues nga radhët e gjyqtarëve, prokurorëve të shtetit dhe ekspertëve të tjerë të fushës së drejtësisë.

Mandati i anëtarëve të Këshillit Programor, me përjashtim të Drejtorit Ekzekutiv, është katër (4) vite, me të drejtë rizgjedhjeje edhe për një mandat. Kryesuesi i Këshillit Programor është ex officio Drejtori Ekzekutiv i Akademisë së Drejtësisë.

Gjatë vitit 2025, Këshilli Drejtues ka vendosur për rizgjedhjen e katër (4) anëtarëve të Këshillit Programor të emëruar në vitin 2021, edhe për një mandat tjetër. Po ashtu, gjatë kësaj periudhe është kompletuar përbërja e plotë e Këshillit Programor në përputhje me dispozitat ligjore, përmes emërimit të dy (2) anëtarëve të rinj, si pasojë e dorëheqjes së dy anëtarëve paraprakë.

Në ushtrimin e funksioneve të tij, Këshilli Programor kontribuon në:

- hartimin e propozim-programit të trajnimeve në bashkëpunim me KGJK-në dhe KPK-në;
- përcjelljen e realizimit të programeve dhe vlerësimin e rezultateve të tyre;
- dhënien e orientimeve për avancimin e metodave dhe teknikave trajnuese;
- dhënien e mendimeve për listën e trajnuesve dhe mentorëve;
- ofrimin e rekomandimeve për përmirësimin e cilësisë së trajnimeve;
- kryerjen e detyrave të tjera të përcaktuara me ligj dhe aktet nënligjore.

Gjatë vitit 2025, Këshilli Programor ka zhvilluar aktivitetet të vazhdueshëm në funksion të përmbushjes së mandatit të tij, duke kontribuar në hartimin dhe zhvillimin e programeve trajnuese të Akademisë. Në këtë kuadër, Këshilli Programor ka mbajtur tre (3) takime, në të cilat është angazhuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në:

- përcaktimin e kurrikulës trajnuese për gjyqtarët dhe prokurorët e sapoemëruar (gjeneratat XIV dhe XII);
- zhvillimin e programit të trajnimeve të vazhdueshme për vitin 2026;
- shqyrtimin dhe përmirësimin e përmbajtjes së programeve trajnuese;
- vlersimin e performances se trajnerëve te angazhuar ne zbatim te programeve trajnuese gjate vitit 2024

Me qëllim të mbulimit të fushave specifike të trajnimit, për të cilat nuk ka pasur profile të mjaftueshme brenda përbërjes së Këshillit Programor, me vendim të Këshillit Drejtues janë angazhuar trajnues nga radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve, veçanërisht për hartimin e programeve trajnuese në fusha të specializuara.

Në koordinim me grupet e trajnuesve, Këshilli Programor ka ushtruar funksionin e tij duke shqyrtuar dhe përgatitur programet në përputhje me nevojat konkrete të përfituesve, si dhe duke dhënë rekomandime për Këshillin Drejtues për zhvillimin dhe përmirësimin e mëtejshëm të programeve trajnuese.

4.4 Ekzekutivi - Drejtori Ekzekutiv i Akademisë së Drejtësisë

Bazuar në Ligjin për Akademinë e Drejtësisë dhe në Rregulloren Nr. 04/2023 për Pranimin dhe Emërimin e Drejtorit Ekzekutiv të Akademisë së Drejtësisë, Drejtori Ekzekutiv bën pjesë në kategorinë e Zyrtarëve të Lartë Drejtues dhe është përgjegjës për menaxhimin dhe administrimin e përgjithshëm të Akademisë së Drejtësisë.

Në përputhje me kompetencat ligjore, gjatë vitit 2025 Drejtori Ekzekutiv është fokusuar në realizimin e aktiviteteve kryesore si në vijim:

- a. Përfaqësimin e Akademisë para institucioneve vendore dhe ndërkombëtare;
- b. Menaxhimin dhe administrimin e përgjithshëm të Akademisë, duke siguruar ligjshmërinë e punës së saj;
- c. Zbatimin e vendimeve të Këshillit Drejtues;
- d. Propozimin e projektbuxhetit vjetor të Akademisë;
- e. Propozimin e Planit të Punës dhe Performancës për vitin 2025;
- f. Propozimin e Programit të Trajnimeve të Vazhdueshme për vitin 2025 dhe programeve të trajnimit fillestar për gjyqtarët e sapoemëruar të gjeneratave XI dhe XII;
- g. Propozimin e listës së trajnuesve të përkohshëm të Akademisë për miratim nga Këshilli Drejtues;

- h. Menaxhimin e mjeteve financiare dhe pronës së Akademisë;
- i. Përgatitjen e raporteve të rregullta vjetore dhe raporteve të tjera sipas kërkesave të Këshillit Drejtues.

Aktivitetet e Drejtorit Ekzekutiv gjatë vitit raportues kanë qenë të orientuara në funksionimin sa më efikas të Akademisë së Drejtësisë përmes përfaqësimit institucional, menaxhimit dhe administrimit të përgjithshëm, si dhe sigurimit të ligjshmërisë së punës së institucionit.

Një pjesë e konsiderueshme e angazhimit të tij është përqendruar në zhvillimin dhe avancimin e programeve trajnuese për përfituesit e Akademisë, në përputhje me mandatin ligjor të institucionit. Gjithashtu, ai ka qenë i angazhuar në aktivitete të ndryshme rajonale dhe ndërkombëtare, duke përfaqësuar Akademinë në konferenca, punëtori dhe forume profesionale.

Në cilësinë e kryesuesit ex officio të Këshillit Programor, Drejtori Ekzekutiv ka kontribuar në koordinimin e punës së këtij organi dhe në zhvillimin e programeve trajnuese të Akademisë. Njëkohësisht, ai ka mbikëqyrur zbatimin e vendimeve të Këshillit Drejtues dhe ka siguruar menaxhimin efikas të buxhetit dhe mjeteve financiare të Akademisë.

Në përputhje me kompetencën ligjore, Drejtori Ekzekutiv në koordinim me Departamentin për Çështje Ligjore dhe Shërbime të Përgjithshme, dy komisionet e themeluara nga Këshilli Drejtues për hartimin e projekt akteve nënligjore, ka organizuar dhe udhëhequr procesin e hartimit dhe plotësimin të një sërë aktesh normative të brendshme që rregullojnë funksionimin administrativ dhe menaxherial të Akademisë së Drejtësisë, duke përfshirë edhe pakon akteve nënligjore të dala nga ligji për zyrtaret publik. Këto përfshijnë projekt-aktet nënligjore që lidhen me procedurat e rekrutimit, vlerësimin e performancës në punë, disiplinën dhe ankesat, organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, menaxhimin e burimeve njerëzore, pagat dhe kompensimet, si dhe përdorimin e mjeteve dhe resurseve të institucionit.

Gjatë vitit 2025, Drejtori Ekzekutiv i Akademisë së Drejtësisë ka kontribuar gjithashtu në një sërë aktiviteteve trajnuese, projekte bashkëpunimi dhe iniciativa rajonale dhe ndërkombëtare me qëllim forcimin e kapaciteteve të sistemit gjyqësor dhe administrativ në Kosovë.

Në kuadër të zbatimit të Planit të Trajnimeve për të Punësuarit në Administratën e Sistemit Gjyqësor, janë zhvilluar takime koordinuese me Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK), Këshillin Prokurorial të Kosovës (KPK) si dhe akterë të tjerë relevantë, përfshirë projektin e KE që trajton Paditë Strategjike Kundër Pjesëmarrjes Publike (SLAPP). Ky projekt ka adresuar ndikimin e interesave politike dhe komerciale që përdorin mekanizma ligjorë për të kufizuar transparencën dhe llogaridhënien publike, duke synuar gjithashtu harmonizimin gradual të legjislacionit vendor me Direktivën e Bashkimit Evropian kundër padive SLAPP.

Në nivel ndërkombëtar, Akademia e Drejtësisë ka bashkëpunuar me organizata dhe projekte të ndryshme, përfshirë UNDP, SCJS Project in Kosovo, INL FMCS, UNHCR, Këshillin e Evropës, PROFREX, SIGMA, EIPA, EJTN dhe OSCE, EJTN, ERA, OSBE, GIZ, IRZ, për realizimin e trajnimeve, shkëmbimeve rajonale dhe punëtorive profesionale në fusha të ndryshme të drejtësisë. Këto aktivitete kanë trajtuar tema të rëndësishme si drejtësia tranzicionale, integriteti gjyqësor, luftimi i krimeve të lidhura me drogën, pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit, si dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut.

Gjithashtu, janë zhvilluar takime dhe aktivitete në bashkëpunim me institucione vendore, përfshirë Gjykatën Supreme, Agjencinë Kundër Korrupsionit, Universitetin e Prishtinës, Institucionin e

Avokatit të Popullit, Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, me qëllim identifikimin e nevojave trajnuese dhe zhvillimin e kurrikulave profesionale.

Në kuadër të përfaqësimit ndërkombëtar, Drejtori Ekzekutiv ka marrë pjesë në konferenca dhe tryeza rajonale dhe ndërkombëtare që kanë trajtuar çështje si standardet e lirisë së shprehjes, luftimin e gjuhës së urrejtjes, mbrojtjen e të drejtave pronësore të grave, praktikat gjyqësore në mbrojtjen ndërkombëtare të refugjatëve, trajtimin e dëshmitarëve të mbrojtur dhe bashkëpunues, si dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional në luftimin e krimeve ekonomike dhe pastrimit të parave.

Përmes takimeve zyrtare dhe bashkëpunimit me partnerë ndërkombëtarë, përfshirë TIKA, SECO, Shkollën e Magjistraturës së Shqipërisë, Akademinë e Drejtësisë së Turqisë, Shkollën Kombëtare të Magjistraturës në Francë, Departamentin e Thesarit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe UNODC, EJTN, ERA, Akademia e Drejtësisë ka zhvilluar iniciativa të rëndësishme për organizimin e trajnimeve ndërkombëtare dhe përmirësimin e performancës së sistemit gjyqësor dhe administrativ.

Pjesëmarrja e Drejtorit në programe si klinikat ligjore dhe trajnimet Training of Trainers (ToT) ka kontribuar në zhvillimin e kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve, prokurorëve dhe stafit administrativ, duke rritur aftësinë e tyre për të adresuar sfidat e sistemit të drejtësisë dhe për të përmirësuar efikasitetin e zbatimit të ligjit në Kosovë.

Gjithashtu, gjatë vitit 2025 Drejtori Ekzekutiv ka përfaqësuar Kosovën në takime të rëndësishme ndërkombëtare dhe ka kontribuar me ekspertizë në projekte të ndryshme të financuara nga Bashkimi Evropian dhe Keshilli Evropës, duke theksuar rëndësinë e zbatimit të legjislacionit kundër diskriminimit, mbrojtjes së lirisë së medias dhe forcimit të integritetit gjyqësor, si dhe duke kontribuar në zhvillimin e kurrikulave të reja trajnuese për gjyqtarë dhe prokurorë.

Aktivitetet e Drejtorit Ekzekutiv kanë qenë të orientuara në funksionimin më të mirë të punës së AD-së përmes përfaqësimit të rregullt, menaxhimit dhe administrimit të përgjithshëm, përfshirë edhe ligjshmërinë e punës së AD-së.

Një pjesë e konsiderueshme e angazhimit të tij ishte në funksion të zhvillimit dhe avancimit të programeve trajnuese për përfituesit e AD-së sipas ligjit.

4.5 Menaxhmenti i mesëm

Bazuar në Rregulloren Nr. 05/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Akademinë e Drejtësisë, struktura e menaxhmentit të mesëm gjatë vitit 2025 është përbërë nga:

- Departamenti i Programeve të Trajnimeve;
- Departamenti për Çështje Ligjore dhe Shërbime të Përgjithshme;
- Njësia e veçantë – Divizioni për Buxhet dhe Financa.

Këto njësi organizative kanë luajtur rol kyç në koordinimin dhe zbatimin e aktiviteteve të Akademisë së Drejtësisë, duke siguruar funksionimin e rregullt institucional dhe realizimin e objektivave të përcaktuara me planin e punës.

4.5.1 Mandati i Departamenteve

1. Departamenti i Programeve Trajnuese ka për mandat menaxhimin e programeve trajnuese dhe ofrimin e trajnimeve fillestare dhe trajnimeve të vazhdueshme për gjyqtarë dhe prokurorë të shtetit si dhe trajnimeve për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial, avokat shtetëror, avokat dhe profesione tjera të lira si dhe menaxhimin e aktiviteteve të Akademisë lidhur me analizat, hulumtimet dhe botimet.

Në kuadër të Departamentit të programeve trajnuese bëjnë pjesë:

- Divizioni për trajnimin fillestar të gjyqtareve dhe prokurorëve të shtetit;
- Divizioni për trajnimet e vazhdueshme për gjyqtarë dhe prokurorë të shtetit;
- Divizioni për trajnimet e stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial, avokateve shtetëror, avokateve dhe profesioneve tjera të lira;
- Divizioni për analiza, hulumtime, botime dhe trajnues.

Ndërsa , detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit të Programeve Trajnuese janë:

- ❖ Hartimi dhe propozimi i politikave, objektivave dhe strategjive për trajnime për gjyqtarët, prokurorët, si dhe për profesionistët e tjerë në fushën e drejtësisë, përfshirë analizat, hulumtimet dhe botimet;
- ❖ Përgatitja, organizimi dhe zbatimi i trajnimeve fillestare dhe të vazhdueshme për gjyqtarët, prokurorët dhe stafin administrativ të sektorit gjyqësor dhe prokurorial, pas koordinimit me KGJK-në dhe KPK-në;
- ❖ Vlerësimi i nevojave për trajnime dhe mbështetja e Këshillit Programor në zhvillimin dhe përditësimin e programeve të trajnimit;
- ❖ Menaxhimi i procesit të përzgjedhjes dhe angazhimit të trajnuesve dhe mentorëve, si dhe mbikëqyrja e përmbushjes së detyrave dhe përgjegjësisë të tyre;
- ❖ Zhvillimi dhe përmirësimi i standardeve të metodologjisë së trajnimit për Akademinë e Drejtësisë;
- ❖ Përpunimi i planit vjetor të trajnimit dhe implementimi i kalendarit të aktiviteteve trajnuese, përfshirë aspektet financiare;
- ❖ Realizimi i analizave, hulumtimeve dhe botimeve për mbështetje të mandatit të Akademisë, përfshirë publikimin e dokumenteve të rëndësishme që pasqyrojnë punën e Akademisë;
- ❖ Mbështetja e organeve të Akademisë dhe njësive organizative në përgatitjen e raporteve periodike dhe menaxhimi i të dhënave statistikore për aktivitetet trajnuese;
- ❖ Koordinimi dhe bashkëpunimi me njësitë e Akademisë dhe institucionet përkatëse të sektorit të drejtësisë për realizimin e aktiviteteve trajnuese;

2. Departamenti për shërbime ligjore dhe të përgjithshme ka për mandat menaxhimin e aktiviteteve të Akademisë lidhur me shërbimet ligjore, komunikimin, bashkëpunimin ndërinstitucional, shërbimet e teknologjisë së informacionit, kushtet fizike të punës, pajisjet e nevojshme, shërbimet mbështetëse dhe logjistike.

Ne kuadër të Departamentit për shërbime ligjore dhe të përgjithshme, bëjnë divizionet si ne vijim:

- Divizioni për shërbime ligjore dhe bashkëpunim ndërinstitucional
- Divizioni për teknologji informative dhe
- Divizioni për mbështetje administrative dhe Logjistikë.

Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit për shërbime ligjore dhe te përgjithshme janë:

- ❖ Ofrimi i këshillave dhe ekspertizës për çështjet ligjore, duke përfshirë hartimin, analizimin dhe/ose komentimin e akteve ligjore dhe nënligjore.
- ❖ Menaxhimi i komunikimeve të brendshme dhe të jashtme të Akademisë, përfshirë faqen e internetit dhe llogaritë e mediave sociale.
- ❖ Menaxhimi i komunikimit ndërinstitucional, bashkëpunimit ndërkombëtar dhe koordinimi me donatorët.
- ❖ Ofrimi i shërbimeve të përkthimit për aktivitetet e Akademisë.
- ❖ Ofrimi i mbështetjes për TI-në për stafin e Akademisë dhe sigurimi i ofritit të shërbimeve cilësore të pajisjeve për TI.
- ❖ Menaxhimi i sistemit të arkivit dhe dokumenteve të brendshme, hyrëse dhe dalëse të Akademisë.
- ❖ Ofrimi i shërbimeve dhe mbështetjes administrative dhe logjistike për Akademinë, përfshirë mirëmbajtjen dhe pastrimin e hapësirave të objekteve, menaxhimin dhe mirëmbajtjen e inventarit në depo, etj.
- ❖ Sigurimi i zbatimit të procedurave për menaxhimin e automjeteve që disponon Akademia në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe koordinimi me institucionet përkatëse për raportimin lidhur me gjendjen e automjeteve (servisimi, mirëmbajtja, shpenzimet e derivateve, etj.).
- ❖ Menaxhimi i pranimit, kontrollit të pasurisë, menaxhimit të stoqeve dhe inventarit të Akademisë.
- ❖ Sigurimi i ofritit të shërbimit të transportit dhe menaxhimi i automjeteve të Akademisë dhe atyre që janë në shfrytëzim të saj.

4.6 Burimet njerëzore

Gjatë periudhës raportuese, Akademia e Drejtësisë ka funksionalizuar në tërësi strukturën e brendshme organizative të përcaktuar me Rregulloren Nr. 05/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës, duke krijuar bazën për një menaxhim më efikas të burimeve njerëzore dhe realizimin e qëndrueshëm të aktiviteteve institucionale.

Në këtë kuadër, Akademia ka zhvilluar procedurat e rekrutimit në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregulloret e saj të brendshme, duke garantuar transparencë, konkurrencë të drejtë dhe dokumentim të plotë të çdo faze të procesit.

Gjatë vitit 2025 janë realizuar gjithsej tri (3) procedura të rekrutimit, të cilat kanë rezultuar të suksesshme me përzgjedhjen e kandidatëve fitues, si dhe një (1) procedurë e transferit të përhershëm në interes të institucionit. Po ashtu, në përputhje me Ligjin për Zyrtarët Publikë, janë nxjerrë aktet e reja të emërimit për të gjithë nëpunësit civilë të Akademisë së Drejtësisë, duke siguruar harmonizimin e statusit të tyre me kornizën ligjore në fuqi.

Stafi i Akademisë së Drejtësisë ka qenë i angazhuar në mënyrë aktive në menaxhimin efektiv të proceseve të punës, koordinimin e programeve trajnuese dhe ndërlidhjen e shërbimeve institucionale, në funksion të realizimit të mandatit ligjor të institucionit.

Në aspektin e kapaciteteve njerëzore, gjatë vitit 2025 Akademia e Drejtësisë ka pasur të punësuar gjithsej 29 (njëzet e nëntë) zyrtarë. Sipas Rregullores Nr. 05/2023, numri i përgjithshëm i pozitave të miratuara është 36 (tridhjetë e gjashtë), ndërsa sipas buxhetit të miratuar për vitin 2025 kanë qenë të aprovuara 32 (tridhjetë e dy) pozita.

Ky dallim ndërmjet pozitave të miratuara dhe atyre të financuara ka reflektuar kufizime buxhetore që ndikojnë në shfrytëzimin e plotë të kapaciteteve organizative dhe në zhvillimin afatgjatë të institucionit.

Gjatë periudhës raportuese, vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe ngritjes së kapaciteteve profesionale të stafit, përmes pjesëmarrjes në trajnime të bazuara në legjislacionin e administratës publike, si dhe në trajnime të tjera të realizuara në bashkëpunim me partnerët e Akademisë së Drejtësisë.

Menaxhimi i burimeve njerëzore gjatë vitit 2025 ka reflektuar përpjekje të vazhdueshme për konsolidimin e strukturës organizative dhe për përmirësimin e kapaciteteve profesionale të stafit, në funksion të realizimit të mandatit të Akademisë së Drejtësisë. Megjithatë, kufizimet buxhetore në numrin e pozitave të aprovuara krahasuar me ato të parashikuara me rregullore paraqesin një sfidë strukturore, e cila ndikon në mundësinë për zhvillim të plotë institucional dhe në rritjen e kapaciteteve në fusha kyçe si digjitalizimi dhe hulumtimet.

4.6.1 Numri i te punësuarve ne Akademinë e Drejtësisë

Në vitin 2025, Akademia e Drejtësisë ka pasur të punësuar gjithsej 29 (njëzet e nëntë) zyrtarë. Sipas Rregullores Nr. 05/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Akademinë e Drejtësisë, numri i përgjithshëm i pozitave të miratuara ka qenë 36 (tridhjetë e gjashtë), ndërsa sipas Ligjit për Buxhetin për vitin 2025 kanë qenë të aprovuara gjithsej 32 (tridhjetë e dy) pozita.

Nga ky numër, gjatë vitit 2025 Akademia e Drejtësisë ka pasur tri (3) pozita pune vakante. Në fillim të vitit është hartuar plani i personelit, i cili ka paraparë zhvillimin e procedurave të rekrutimit për tri pozitat aktualisht të lira në Akademi.

Në aspektin analitik, kjo paraqet një dallim të dukshëm ndërmjet strukturës së miratuar organizative dhe kapaciteteve reale të financuara, çka ndikon drejtpërdrejt në mundësinë e shfrytëzimit të plotë të strukturës së paraparë me rregullore dhe në mbulimin e të gjitha funksioneve organizative.

Kategoria funksionale	Nr. i stafit sipas Ligjit për Buxhetin 2025	Nr. i stafit sipas Rregullores nr.05/2023	Nr. i stafit në fillim të 2025	Nr. i stafit në fund të 2025
Kategoria e lartë drejtuese	1	1	1	1
Kategoria e mesme drejtuese	2	2	1	2
Kategoria e ulët drejtuese	6	8	6	5
Kategoria profesionale	22	25	20	20

Nëpunës teknik dhe mbështetës	1	/	1	1
Total	32	36	29	29

Tabelë 2: Numri i punëtorëve sipas kategorisë funksionale

4.6.2 Nevojat për punëtorë të rinj

Në funksion të zgjerimit të kapaciteteve dhe realizimit të mandatit ligjor, Akademia e Drejtësisë ka planifikuar zhvillimin e procedurave të rekrutimit për tri (3) pozitat e lira ekzistuese gjatë vitit 2025, si dhe për katër (4) pozita shtesë të miratuara me Rregulloren Nr. 05/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës, të cilat pritet të aprovohen me Ligjin për Buxhetin e vitit 2026.

Po ashtu, është planifikuar edhe zhvillimi i procedurave për zëvendësimin e pozitave që mund të lirohen ose të riorganizohen gjatë vitit 2026.

Për tri pozitat e lira në Akademinë e Drejtësisë, për të cilat do të zhvillohen procedurat e rekrutimit, janë paraparë këto pozita:

- Udhëheqës i Divizionit për Teknologji Informative;
- Zyrtar për mësim në distancë;
- Zyrtar për statistika.

Pozitat e tjera të miratuara me Rregulloren Nr. 05/2023, për të cilat pritet aprovimi i buxhetit, janë: Udhëheqës i Divizionit për Trajnime të Stafit Administrativ Gjyqësor dhe Prokurorial, Avokatëve Shtetërorë, Avokatëve dhe Profesioneve të Tjera të Lira;

- Udhëheqës i Divizionit për Mbështetje Administrative dhe Logjistikë;
- Zyrtar i Lartë për Trajnime;
- Zyrtar i Pasurisë.

Nevoja për këto pozita reflekton zgjerimin e kërkesave funksionale të Akademisë së Drejtësisë dhe domosdoshmërinë për forcimin e kapaciteteve në fusha kyçe si digjitalizimi, statistikat, administrimi i trajnimeve dhe mbështetja logjistike. Plotësimi i këtyre pozitave do të ndikonte drejtpërdrejt në rritjen e kapaciteteve organizative dhe në funksionalizimin e plotë të strukturës së brendshme të Akademisë.

Si rezultat, planifikimi i rekrutimeve të reja paraqet një hap të rëndësishëm për konsolidimin e mëtejshëm të burimeve njerëzore dhe për përmirësimin e performancës institucionale në periudhën në vijim.

4.6.3 Paraqitja në formë tabelare e numrit dhe llojit të trajnimeve të stafit

Zhvillimi profesional i stafit është mbështetur përmes realizimit të trajnimeve të ndryshme, të cilat kanë pasur për fokus ngritjen e kapaciteteve individuale dhe institucionale, në funksion të përmirësimit të performancës, profesionalizimit dhe përgjegjësisë në ushtrimin e detyrave zyrtare. Edhe gjatë vitit 2025, Akademia e Drejtësisë ka vazhduar bashkëpunimin me partnerët e saj dhe, varësisht nga programet e ofruara, ka përcaktuar stafin përfitues që ka marrë pjesë në trajnime të ndryshme profesionale.

Trajnimi	Organizatorë/Donatorë	Nr. i stafit përfitues
Trajnimi hyrës për nëpunësit e ri civil në Shërbimin Civil të Kosovës	IKAP	4
Trajnim lidhur me përgatitjen për procesin e deklarimit të pasurisë dhe dhuratave për vitin 2025	APK	1
Mekanizmi i Sinjalizimit – Trajnim i Avancuar	APK/OSCE	1
Rëndësia e Sinjalizimit në Sektorin Publik dhe Privat	APK	1
Trajnim Online në lidhje me funksionalizimin e integritit ndërmjet Sistemit të Informacionit për Menaxhimin Financiar të Kosovës (SIMFK) dhe sistemit elektronik të prokurimit të KRPP-së	THESARI	2
Bazat e Mbrojtjes së të Dhënave	AIP	1
Moduli i Shpenzimeve	THESARI	1

Tabelë 3: Trajnimet e stafit

Këto trajnime reflektojnë një fokus të qartë në forcimin e kapaciteteve të stafit në fusha që lidhen me administratën publike, integritetin institucional, menaxhimin financiar dhe mbrojtjen e të dhënave. Temat e trajtuara kanë qenë të lidhura drejtpërdrejt me kërkesat funksionale të institucionit dhe me nevojën për rritjen e cilësisë së punës administrative dhe menaxheriale.

Si rezultat, pjesëmarrja e stafit në këto trajnime ka kontribuar në ngritjen e kapaciteteve profesionale, në përmirësimin e përgjegjshmërisë institucionale dhe në avancimin e standardeve të punës brenda Akademisë së Drejtësisë.

4.7 Asetet në posedim të Akademisë së Drejtësisë

Në kuadër të regjistrimit të aseteve të Akademisë së Drejtësisë përfshihen pasuritë kapitale dhe jo kapitale, të klasifikuara sipas vlerës dhe natyrës së tyre.

Pasuritë me vlerë mbi 1,000 euro përfshijnë automjetet, pajisjet e teknologjisë informative, pajisjet e zyrës dhe pajisjet e zërimit, me vlerë neto prej 68,316.42 euro në fund të vitit 2025.

Ndërsa pasuritë me vlerë nën 1,000 euro përfshijnë pajisje të teknologjisë informative, mobilie, inventar të ndryshëm dhe fondin bibliotekar, me vlerë totale prej 51,860.79 euro.

Pasuritë jo financiare kapitale janë të regjistruara në sistemin SIMFK, ndërsa pasuritë jo kapitale në sistemin E-pasuri, duke reflektuar gjendjen reale të aseteve të Akademisë më 31 dhjetor 2025.

Struktura aktuale e aseteve reflekton një bazë funksionale për operimin e institucionit, por njëkohësisht evidentohet nevoja për investime të reja, veçanërisht në pajisje teknologjike dhe infrastrukturë mbështetëse, për shkak të amortizimit të një pjese të konsiderueshme të inventarit ekzistues.

4.7.1 Planet për asete të reja dhe funksionalizimi i ndërtesës së re

Akademia e Drejtësisë, që nga themelimi i saj, ka zhvilluar veprimtarinë në objekte me qira. Aktualisht, që nga data 08.07.2022, Akademia është e vendosur në një objekt privat me qira, në adresën rr. “Murat Mehmeti”, nr. 1–3, në Prishtinë, për shkak se ndërtimi i ndërtesës së re të Akademisë ende nuk ka përfunduar. Hapësirat aktuale, me një sipërfaqe prej rreth 2,000 m², nuk i plotësojnë më nevojat funksionale të institucionit. Rritja e vazhdueshme e aktiviteteve trajnuese, zhvillimi i programeve të specializuara, trajnimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve fillestarë, përfshirja e

profesionistëve të tjerë të drejtësisë, si dhe zhvillimi i veprimtarisë hulumtuese, botuese dhe organizimi i konferencave, kanë krijuar një kërkesë të shtuar për hapësira më të mëdha dhe më të përshtatshme.

Në këtë kontekst, funksionalizimi i ndërtesës së re të Akademisë së Drejtësisë paraqet një prioritet strategjik për institucionin. Ndërtimi i ndërtesës së re, i cili menaxhohet nga Departamenti për Standarde dhe Politika të Inxhinieringut dhe Menaxhimit të Ndërtesave Qeveritare (DSPIMNQ) në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ka kaluar në disa faza të ndërprerjeve dhe rifillimeve. Sipas informacioneve të konfirmuara në takimet me përfaqësuesit e këtij departamenti, operatori ekonomik ka rifilluar punimet në muajin tetor 2024, duke vazhduar zbatimin e projektit sipas planit dinamik të punës. Disa punime janë përfunduar, ndërsa të tjera janë ende në proces.

Ndërtesa e re e Akademisë, me një sipërfaqe prej rreth 4,300 m², pritet të përfundojë gjatë vitit 2026, duke krijuar kushte moderne për zhvillimin e aktiviteteve trajnuese dhe profesionale.

Megjithatë, gjatë procesit të ndërtimit janë identifikuar edhe sfida të rëndësishme në aspektin e planifikimit të brendshëm të objektit. Qysh në fazat e hershme të projektimit, Akademia e Drejtësisë ka kërkuar që në projekt të përfshihen komentet dhe rekomandimet e Projektit EUKOJUST, të cilat ishin miratuar edhe nga Këshilli Drejtues, me qëllim që ndërtesa të reflektojë plotësisht nevojat funksionale të institucionit. Megjithatë, në takimet me përfaqësuesit e DSPIMNQ është konfirmuar se këto komente nuk janë përfshirë në kontratën e lidhur më 16.08.2024 ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe operatorit ekonomik për ndërtimin e objektit.

Kjo situatë paraqet një sfidë shtesë për funksionalizimin optimal të ndërtesës në përputhje me kërkesat reale të Akademisë.

Njëkohësisht, një nga çështjet kryesore mbetet fakti se kontrata për ndërtimin e objektit nuk përfshin mobilimin, inventarin dhe pajisjet e teknologjisë informative, të cilat janë thelbësore për funksionalizimin e plotë të ndërtesës. Në këtë drejtim, Akademia e Drejtësisë ka qene ne komunikim dhe koordinim të vazhdueshëm me DSPIMNQ dhe Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit (ASHI), me qëllim identifikimin e nevojave për:

- mobilim dhe inventar
- pajisje të teknologjisë informative
- mirëmbajtje teknike
- hapësira për parking

Duke marrë parasysh këto nevoja, si dhe faktin që një pjesë e konsiderueshme e inventarit ekzistues është e amortizuar dhe nuk do të jetë e përdorshme pas zhvendosjes, Akademia ka planifikuar në kërkesën buxhetore për vitin 2026 mjete në vlerë prej 928,814 euro, të cilat konsiderohen të domosdoshme për funksionalizimin e plotë të ndërtesës së re.

Ndërtesa e re do të përfshijë:

- 8 salla trajnimi (përfshirë salla për simulime gjykimi);
- 2 salla për mësim në distancë dhe teknologji informative;
- 4 salla për takime pune;
- 10 kabina për përkthim simultan;
- zyra pune dhe hapësira të përbashkëta për stafin;

- bibliotekë, arkivi dhe depo;
- hapësira për shërbime mbështetëse dhe garazh për automjete.

Funksionalizimi i kësaj infrastrukture do të ndikojë drejtpërdrejt në rritjen e kapaciteteve institucionale të Akademisë së Drejtësisë, duke mundësuar zhvillimin e programeve trajnuese në përputhje me standardet bashkëkohore dhe kërkesat e sistemit të drejtësisë. Përfundimi dhe pajisja e ndërtesës së re përbën një nga faktorët kyç për zhvillimin afatgjatë dhe strategjik të Akademisë së Drejtësisë.

Meqenëse në Qarkoren Buxhetore 2025/01 të lëshuar nga MFPT nuk janë parashikuar mjete për shpenzime kapitale për vitin 2025, akademia e drejtësisë ka vlerësuar që në kërkesën buxhetore të planifikohet shuma e mjeteve, sipas përshkrimit të mëposhtëm. Mos adresimi në kohë i këtyre nevojave paraqet rrezik për vonesa në funksionalizimin e plotë të objektit dhe në realizimin efikas të mandatit ligjor të institucionit.

4.7.2 Përmirësimi i infrastrukturës së teknologjisë TI dhe investimet kapitale

Akademia e Drejtësisë është e përkushtuar në avancimin e teknologjisë informative dhe modernizimin e proceseve të punës. Aktualisht, Akademia Drejtësisë operon me Sistemin për Menaxhimin e Aktiviteteve Trajnuese (SMAT), i cili mbështet menaxhimin e plotë të ciklit të trajnimeve. Megjithatë, një pjesë e konsiderueshme e pajisjeve teknologjike është e amortizuar dhe kërkon zëvendësim ose përditësim.

Kalimi në ndërtesën e re rrit ndjeshëm nevojën për:

- pajisje të reja kompjuterike për stafin dhe sallat e trajnimit
- sisteme moderne audiovizuale dhe pajisje për mësim në distancë
- krijimin e një infrastrukture të integruar teknologjike në gjithë objektin
- përditësimi dhe avancimi i sistemeve ekzistuese
- mobilimin me inventar për salla , zyre, bibliotekë dhe laborator te TI

Në funksion të përmbushjes së këtyre objektivave dhe sigurimit të kushteve të nevojshme për funksionalizimin e plotë të ndërtesës së re të Akademisë së Drejtësisë, janë planifikuar investime kapitale në përputhje me kërkesën buxhetore për vitin 2026. Struktura e këtyre investimeve është paraqitur në tabelën në vijim:

Në këtë drejtim, Akademia ka planifikuar investime kapitale në teknologjinë informative gjatë vitit 2026, me qëllim sigurimin e funksionalitetit të plotë të ndërtesës së re dhe përmbushjen e standardeve bashkëkohore të trajnimit.

Viti	Investimet Kapitale për objektin e ri të AD-së	sasia	çmimi	vlera
2026				
	I Inventar (karriga, tavolina pune, takime, gjykatore, etj)			75,314.21
	1 Salla 780 m ² (140 + 126.2 + 141.6 + 184.5 + 187.7)	250	125.00 €	31,250.00
	2 Salla 272.4 m ² (70.4 + 84.1 + 117.9)	105	125.00	13,125.00
	3 Salla 208.6 m ² (78.8 + 129.8)	80	125.00	10,000.00
	4 Zyre pune per zyrtare	40	186.00	7,440.00
	5 Bibloteka	13	270.86	3,521.18
	6 Byfe	26	238.38	6,197.88
	7 Pritore (koridore)	33	114.55	3,780.15
	II Teknologji informatve			187,300.00
	1 Kompjuter dhe monitor	35	900.00	31,500.00
	2 Kompjuter për bibliotekë	12	900.00	10,800.00
	2 Zhvillimi dhe monitorimi i databazave	3	40,000.00	120,000.00
	3 Mirembajtje e SMAT	1	15,000.00	15,000.00
	4 Upgrate e sistemit koha dhe e-print të bibliotekës	1	10,000.00	10,000.00
	III Pajisje tjera			666,200.00
	1 Sistemit konferencial (Pajisje për përkthim, zërim si dhe pajisje për lidhje videokonferenc	10	60,000.00	600,000.00
	2 Smartboard (janë 13 salla trajnimit – ne salla te mdha janë planifikuar nga 2 smardboard -6 smardboard i kemi)	13	4,000.00	52,000.00
	3 Monitor për katë	4	400.00	1,600.00
	4 Laboratori i TI-së	14	900.00	12,600.00
	Shpenzimet totale			928,814 €

Tabela 10. Investimet kapitale për pajisje dhe inventar per objektin e ri të AD-së

Siç paraqitet në tabelë, investimet kapitale janë të orientuara kryesisht në pajisjen e infrastrukturës trajnuese, teknologjike dhe administrative, të cilat janë thelbësore për funksionalizimin e plotë dhe efikas të ndërtesës së re të Akademisë së Drejtësisë.

4.7.4 Automjetet

Në kuadër të menaxhimit të mjeteve logjistike, gjatë vitit 2025 Akademia e Drejtësisë ka planifikuar realizimin e pagesës për automjetet sipas kontratës së lidhur përmes Agjencisë Qendrore të Prokurimit.

Ky aktivitet i prokurimit është iniciuar në vitin 2023, ndërsa kontrata është finalizuar në vitin 2024, për shkak të ankesave gjatë procedurës së prokurimit. Megjithatë, për shkak të mungesës së buxhetit për investime kapitale në vitin 2024, pagesa është planifikuar për vitin 2025.

Përshkrimi	Sasia	Çmimi	Vlera
Automjete	1	30,000.00	€ 30,000.00

Tabela 11. Automjetet

5. AKTIVITETET E AKADEMISË SË DREJTËSISË PËR VITIN 2025

Bazuar në Planin e Punës dhe të Performancës për vitin 2025, aktivitetet e Akademisë së Drejtësisë gjatë periudhës raportuese janë orientuar në realizimin e objektivave strategjike të institucionit, në përputhje me mandatin ligjor dhe nevojat e sistemit gjyqësor dhe prokurorial në Republikën e Kosovës.

Gjatë vitit 2025, Akademia e Drejtësisë ka zhvilluar një gamë të gjerë aktivitetesh trajnuese dhe zhvillimore, të cilat kanë kontribuar në ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe ndërdisiplinare të gjyqtarëve, prokurorëve, stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial, si dhe profesionistëve të tjerë të drejtësisë.

Aktivitetet e realizuara janë fokusuar në arritjen e objektivave si në vijim:

1. Përgatitja profesionale e gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapoemëruar përmes Programit të Trajnimit Fillestar;
2. Avancimi i vazhdueshëm i njohurive profesionale dhe ndërdisiplinare të gjyqtarëve, prokurorëve, stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial, si dhe profesionistëve të tjerë ligjorë përmes Programit për Trajnime të Vazhdueshme (PTV);
3. Zhvillimi i programeve trajnuese dhe ngritja e cilësisë së trajnimeve, hulumtimeve dhe veprimtarisë botuese;
4. Avancimi dhe zgjerimi i bashkëpunimit me partnerët vendorë, donatorët dhe institucionet trajnuese ndërkombëtare;
5. Ngritja e kapaciteteve profesionale administrative, përmirësimi i cilësisë së shërbimeve administrative dhe menaxhimi efektiv i buxhetit.

Realizimi i këtyre objektivave ka kontribuar drejtpërdrejt në forcimin e kapaciteteve të sistemit të drejtësisë dhe në përmirësimin e cilësisë së zbatimit të ligjit në Republikën e Kosovës.

5.1 Krahasimi i punës së AD-se për tri vitet e fundit

Me qëllim të pasqyrimin të zhvillimit institucional dhe progresit të Akademisë së Drejtësisë, në vijim paraqitet analiza krahasuese e aktivitetëve dhe rezultateve kryesore gjatë tri viteve të fundit.

Akademia e Drejtësisë ka vazhduar përkushtimin e saj në përcjelljen e zhvillimeve në sistemin gjyqësor dhe prokurorial, veçanërisht në raport me ndryshimet legjislative, proceset e rekrutimit nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës, si dhe nevojat në rritje për zhvillim profesional të aktorëve të sistemit të drejtësisë.

Në këtë drejtim, Akademia ka ndërmarrë masa për hartimin e programeve trajnuese të përshtatura me këto zhvillime dhe ka siguruar zbatimin e trajnimeve për gjyqtarët dhe prokurorët e sapoemëruar menjëherë pas dekretimit të tyre, si dhe avancimin profesional të atyre në detyrë.

Gjatë vitit 2025:

- në Programin e Trajnimit Fillestar janë trajnuar 87 gjyqtarë dhe 24 prokurorë të rinj;
- janë përfunduar me sukses trajnime fillestar për gjeneratat XI dhe XII;
- janë në proces gjeneratat XIII dhe XIV të gjyqtarëve dhe XI e prokurorëve;
- janë realizuar gjithsej 190 trajnime të vazhdueshme për kategori të ndryshme përfituesish;

Po ashtu, Akademia ka zhvilluar aktivitete në fushën e botimeve dhe hulumtimeve, duke përfshirë përmbledhje me Gjykatën Supreme dhe publikime të mbështetura nga partnerë ndërkombëtarë.

Zhvillimet e Akademisë në raport me vitet paraprake janë të prezantuara më poshtë në formë tabelare.

Krahasimi i punës së AD-së për tri vitet e fundit			
Aktivitetet	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025
Trajnime fillestare	Vazhdimi dhe përfundimi i trajnimit fillestar për gjeneratën e IX të gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapo emëruar Fillimi dhe zbatimi i trajnimit fillestar për gjeneratën e X (29 gjyqtarë dhe 21 prokurorë)	Vazhdimi dhe përfundimi i trajnimit fillestar për gjeneratën e X të gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapo emëruar Fillimi dhe zbatimi i trajnimit fillestar për gjeneratën e XI dhe XII të gjyqtarëve të sapoemëruar	Vazhdimi trajnimit praktik dhe përfundimi i trajnimit fillestar për gjeneratën e XI të gjyqtarëve të sapo emëruar Vazhdimi i trajnimit teorik dhe praktik për gjeneratën e XII të gjyqtarëve të sapoemëruar si dhe Fillimi dhe zbatimi i trajnimit fillestar për gjeneratën e XI të prokurorëve të sapo emëruar Fillimi dhe zbatimi i trajnimit fillestar për gjyqtaret e sapo emëruar gjenerata e XIII Fillimi dhe zbatimi i trajnimit fillestar për gjyqtaret e sapo emëruar gjenerata e XIV
Trajnime të vazhdueshme	218	174	190
Trajnime për gjyqtar	140	84	83
Trajnime për stafin administrative gjyqësor dhe prokurorial	55 trajnime për bashkëpunëtorë profesional me 63 ditë trajnimi dhe 6 trajnime për stafin tjetër administrativ gjyqësor dhe prokurorial me 7 ditë trajnimi	60 trajnime për Bashkëpunëtor profesional dhe Zyrtar Ligjor (53 trajnime nga Moduli Bazik dhe 7 trajnime tjera për Bashkëpunëtor Profesional/Zyrtar Ligjor) si dhe; 15 trajnime për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial.	11 trajnime për Bashkëpunëtor profesional dhe Zyrtar Ligjor nga Moduli Bazik -i dhe; 87 trajnime për stafin administrativ gjyqësor 4 trajnime për stafin administrativ Prokurorial dhe - 3 trajnime të përbashkëta për Stafin Administrativ gjyqësor dhe prokurorial;
Trajnime për profesionet e lira	4 trajnime për ndërmjetësues	14 trajnime (12 për ndërmjetësues dhe 2 për avokatë)	2 trajnime për zyrtarët Ndihmës Juridike Falas dhe përmbarus
Aktivitete tjera ¹	Mbi 300	Mbi 245	Mbi 270
Pjesëmarrja gjyqtarë/prokurorë në trajnime të vazhdueshme	1479 gjyqtarë 479 prokurorë	962 nga radhët e gjyqtarëve, 274 nga radhët e prokurorëve,	861 nga radhët e gjyqtarëve, 296 nga radhët e prokurorëve,

¹ Aktivitete që nënkupton takimet e punës me KD, KP, trajnues, krerë të gjykatave dhe prokurorëve, të KGJK-së dhe KPK-së, vizita të ndërsjella në kuadër të bashkëpunimit institucional vendor dhe ndërkombëtarë, punëtori të ndryshme, takime koordinuese me partnerë ndërkombëtarë etj.

Numri i gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapo emëruar	45 gjyqtarë, gjen.IX 29 gjyqtarë, gjen.X 5 prokurorë, gjen IX 21 prokurorë, gjen.X	- Gjenerata X e gjyqtarëve të sapo emëruar (28), Gjenerata X e prokurorëve të sapo emëruar (23), - Gjenerata XI e gjyqtarëve të sapo emëruar (15), - Gjeneratat XII e gjyqtarëve të sapo emëruar (31)	- - Gjenerata XI e gjyqtarëve të sapo emëruar (15), - Gjeneratat XII e gjyqtarëve të sapo emëruar (31) Gjeneratat XIII e gjyqtarëve të sapo emëruar (21) Gjeneratat XIV e gjyqtarëve të sapo emëruar (19) Gjenerata e XI e prokurorëve të sapo emëruar (24)
Numri i pjesëmarrësve nga stafi administrativ gjyqësor dhe prokurorial	1517 pjesëmarrës qoftë në trajnime të përbashkëta me gjyqtarë dhe prokurorë ashtu edhe në trajnimet dedikuar vetëm profileve përkatëse	789 pjesëmarrës nga radhët e bashkëpunëtorëve profesional, 627 nga radhët e zyrtarëve ligjor dhe 273 nga stafi tjetër administrativ gjyqësor dhe prokurorial	2735 pjesëmarrës që nga radhët e bashkëpunëtorëve profesional dhe nga radhët e zyrtarëve ligjor janë 754 nga stafi tjetër administrativ gjyqësor 2231 dhe prokurorial 71.
Numri i personelit të AD-së	25	29	29

Tabela nr. 3: Krahasimi i punës së Akademisë për tri vitet e fundit

Pas paraqitjes së të dhënave në tabelën e mësipërme, vërehet se Akademia e Drejtësisë ka shënuar progres të qëndrueshëm në realizimin e aktiviteteve të saj gjatë tri viteve të fundit, si në aspektin sasior ashtu edhe në atë cilësor.

Rritja dhe stabilizimi i numrit të trajnimeve të vazhdueshme, si dhe zgjerimi i përfshirjes së përfituesve nga kategori të ndryshme, reflekton një intensifikim të angazhimit institucional në përmbushjen e mandatit ligjor dhe në adresimin e nevojave të sistemit të drejtësisë. Në veçanti, zhvillimi i programeve për gjenerata të reja të gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe rritja e pjesëmarrjes së stafit administrativ, dëshmojnë për një qasje gjithëpërfshirëse të Akademisë në zhvillimin profesional të të gjithë aktorëve të sistemit.

Gjithashtu, trendi i zhvillimit reflekton përmirësimin e kapaciteteve organizative dhe menaxheriale të Akademisë, si dhe rritjen e bashkëpunimit me partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë. Kjo rritje dhe konsolidim dëshmojnë për rolin gjithnjë e më të rëndësishëm të Akademisë së Drejtësisë si institucion kyç në zhvillimin profesional të sistemit të drejtësisë në Republikën e Kosovës.

5.2 Plani i punës dhe performances për vitin 2025

Plani i Punës dhe i Performancës për vitin 2025 i Akademisë së Drejtësisë është hartuar në përputhje me mandatin ligjor të institucionit, si dhe në koordinim të ngushtë me institucionet e sistemit gjyqësor dhe prokurorial, duke reflektuar nevojat reale për zhvillim profesional dhe institucional të sektorit të drejtësisë në Republikën e Kosovës. Ky plan ka përcaktuar prioritetet strategjike dhe aktivitetet kryesore të Akademisë së Drejtësisë, të cilat janë orientuar në përmbushjen e objektivave të saj në fushën e trajnimeve fillestare dhe të vazhdueshme, zhvillimit profesional, hulumtimeve dhe bashkëpunimit ndërinstitucional.

Zbatimi i Planit të Punës dhe Performancës gjatë vitit 2025 është realizuar përmes një qasjeje të strukturuar dhe të planifikuar, duke siguruar lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet objektivave dhe aktiviteteve konkrete të ndërmarra nga Akademia e Drejtësisë. Në këtë drejtim, aktivitetet e realizuara gjatë vitit 2025 kanë qenë të fokusuara në përmbushjen e objektivave të përcaktuara, duke kontribuar në rritjen e kapaciteteve profesionale dhe institucionale të sistemit gjyqësor dhe prokurorial.

Zbatimi i këtij plani është monitoruar në mënyrë të vazhdueshme, duke siguruar përputhshmëri ndërmjet aktiviteteve të realizuara dhe objektivave strategjike, si dhe duke mundësuar identifikimin e sfidave dhe nevojave për përmirësim të mëtejshëm.

Në vijim paraqiten aktivitetet kryesore të realizuara në përputhje me objektivat e Planit të Punës dhe të Performancës për vitin 2025, të prezantuara si me poshtë :

- Përgatitja profesionale e gjyqtarëve të sapo emëruar dhe prokurorëve të sapo emëruar
- Avancimi i vazhdueshëm të njohurive profesionale dhe interdisciplinare të gjyqtarëve, prokurorëve, stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial si dhe profesionistëve të tjerë ligjor-PTV;
- Zhvillimi i programeve trajnuese, ngritja e cilësisë së trajnimeve, hulumtimeve dhe veprimtarisë botuese trajnuese;
- Avancimi dhe zgjerimi i bashkëpunimit dhe koordinimit me partnerët vendor, partnerët ndërkombëtarë, donatorët dhe institucionet relevante trajnuese ndërkombëtare;
- Ngritja e kapaciteteve profesionale administrative, cilësisë së shërbimeve administrative dhe shpenzimeve financiare të buxhetit.

5.2.1 Përgatitja profesionale e gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapo emëruar

Përgatitja profesionale e gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapoemëruar përbën një nga funksionet themelore dhe prioritetet kryesore të Akademisë së Drejtësisë, në përputhje me mandatin e saj ligjor.

Ky proces realizohet përmes Programit të Trajnimit Fillestar, i cili synon zhvillimin e njohurive teorike dhe praktike, si dhe forcimin e aftësive profesionale dhe etike të gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapoemëruar, në funksion të ushtrimit të pavarur, të paanshëm dhe profesional të detyrës së tyre. Programi i Trajnimit Fillestar është i strukturuar në pjesën teorike dhe praktike dhe zbatohet në koordinim të ngushtë me Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në bazë të koordinimit dhe bashkëpunimit me KGJK dhe KPK, gjatë vitit 2025 Akademia e Drejtësisë ka planifikuar dhe zbatuar aktivitetet trajnuese për gjyqtarët dhe prokurorët e sapoemëruar, si në vijim:

1. Zbatimi i trajnimit praktik për 15 gjyqtarët e sapoemëruar të gjeneratës XI në gjykata, nën mbikëqyrjen e mentorëve gjyqtarë;
2. Zbatimi i trajnimit fillestar, duke përfshirë komponentin teorik dhe praktik, për 31 gjyqtarët e sapoemëruar të gjeneratës XII;
3. Zbatimi i trajnimeve fillestare për 24 prokurorët e sapoemëruar të gjeneratës XI;
4. Zhvillimi dhe zbatimi i trajnimit fillestar për 21 gjyqtarët e sapoemëruar të gjeneratës XIII;
5. Zhvillimi dhe zbatimi i trajnimit fillestar për 30 gjyqtarët e sapoemëruar të gjeneratës XIV, si dhe për 30 prokurorët e sapoemëruar të gjeneratës XII;
6. Zhvillimi i trajnimeve të detyrueshme bazuar në rezultatet e vlerësimit të performancës;
7. Zbatimi i trajnimeve për trajnues, me qëllim rritjen e kapaciteteve të tyre profesionale dhe përmirësimin e cilësisë së procesit trajnuese.

Përmes këtyre aktiviteteve, Akademia e Drejtësisë ka siguruar zbatim të qëndrueshëm dhe cilësor të Programit të Trajnimit Fillestar, duke kontribuar në përgatitjen profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve të rinj dhe në forcimin e kapaciteteve të sistemit të drejtësisë në Republikën e Kosovës.

5.2.2 Avancimi i vazhdueshëm i njohurive profesionale dhe interdisiplinare të gjyqtarëve, prokurorëve, stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial si dhe profesionisteve të tjerë ligjor

Avancimi i vazhdueshëm i njohurive profesionale dhe ndërdisiplinare përbën një nga shtyllat kryesore të veprimtarisë së Akademisë së Drejtësisë.

Gjatë periudhës raportuese, trajnimet e vazhdueshme janë zhvilluar në bazë të një qasjeje të strukturuar dhe gjithëpërfshirëse, duke reflektuar: prioritetet e KGJK-së dhe KPK-së dokumentet strategjike të sistemit të drejtësisë dhe vlerësimin e nevojave trajnuese.

Ky vlerësim është realizuar përmes takimeve me gjyqtarë, prokurorë, kryetarë gjykatash dhe kryeprokurorë, duke siguruar që programet trajnuese të adresojnë drejtpërdrejt sfidat e praktikës gjyqësore.

Në këtë kuadër, janë identifikuar fusha prioritare si:

- luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit
- sekuestrimi dhe konfiskimi
- keqpërdorimi i detyrës zyrtare
- dhuna në familje
- të drejtat e njeriut dhe çështje të tjera komplekse të praktikës

Në përputhje me Programin për Trajnime të Vazhdueshme për vitin 2025, janë planifikuar dhe realizuar trajnime në fushat si në vijim:

1. Lëmia penale
2. Lëmia civile
3. Drejtësia për fëmijë
4. Mbrojtja nga dhuna në familje
5. Lëmia komerciale
6. Drejtësia kushtetuese, administrative dhe kundërvajtëse
7. KEDNJ

8. E drejta e BE-së
9. Kompetencat ndërdisiplinare
10. Ndërmjetësimi
11. Menaxhimi i gjykatave dhe prokurorive
12. Trajnimet e detyrueshme sipas rregulloreve
13. Trajnimet për bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjorë
14. Trajnimet për stafin administrativ
15. Trajnimet për profesionet e lira
16. Trajnimet online dhe përmes platformave për mesim në distancë

Në aspektin analitik, Programi për Trajnime të Vazhdueshme ka reflektuar një qasje të orientuar në rezultate dhe të harmonizuar me prioritetet e sistemit të drejtësisë, duke kontribuar në përmirësimin e cilësisë së vendimmarrjes dhe rritjen e efikasitetit institucional.

5.2.3 Zhvillimi i programeve trajnuese, ngritja e cilësisë së trajnimeve hulumtimeve dhe veprimtarisë botuese

Zhvillimi i programeve trajnuese dhe ngritja e cilësisë së tyre përbën një nga prioritetet strategjike të Akademisë së Drejtësisë, në funksion të përmbushjes së mandatit të saj ligjor dhe avancimit të sistemit të drejtësisë. Analizat dhe hulumtimet kanë rol thelbësor në zhvillimin e programeve trajnuese të përshtatshme me nevojat reale të përfituesve, si dhe në krijimin e botimeve profesionale në fushën juridike, me theks të veçantë në modulet trajnuese, doracakët, udhëzuesit dhe format e tjera praktike që lehtësojnë ushtrimin e funksionit nga gjyqtarët dhe prokurorët.

Në këtë kontekst, në përputhje me Planin e Punës dhe të Performancës për vitin 2025, aktivitetet e Divizionit për Analiza, Hulumtime, Botime dhe Trajnues kanë qenë të orientuara në:

1. zbatimin e procesit për vlerësimin e nevojave trajnuese për vitin 2026;
2. ngritjen e cilësisë së trajnimeve përmes monitorimit dhe analizës së të dhënave të performancës së trajnuesve për vitin 2025;
3. hulumtimin dhe përmbledhjen e konkluzioneve për unifikimin e praktikës gjyqësore, si dhe publikimin e tyre;
4. zhvillimin e botimeve të reja dhe ofrimin e burimeve ligjore për përfituesit e Akademisë së Drejtësisë;
5. zbatimin e masave dhe politikave të ndërlidhura me procesin e integritetit evropian, si dhe raportimin e rregullt në mekanizmat përkatës;
6. monitorimin dhe zbatimin e Planit të Integritetit të Akademisë së Drejtësisë.

Në aspektin analitik, këto aktivitete kanë forcuar lidhjen ndërmjet analizës, zhvillimit të programeve trajnuese dhe cilësisë së tyre, duke kontribuar në ndërtimin e një sistemi më të qëndrueshëm të zhvillimit profesional dhe në avancimin e praktikës gjyqësore dhe prokuroriale. Si rezultat, është përmirësuar baza profesionale dhe metodologjike mbi të cilën zhvillohen trajnimet, si dhe është forcuar kapaciteti i Akademisë për të prodhuar përmbajtje profesionale dhe botime të dobishme për sistemin e drejtësisë.

5.2.4 Avancimi dhe zgjerimi i bashkëpunimit dhe koordinimit me partnerët vendor, partnerët ndërkombëtarë, donatorët dhe institucionet relevante trajnuese ndërkombëtare.

Rritja e bashkëpunimit me partnerët vendorë, si Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), gjykatat, prokuroritë dhe institucionet tjera të sistemit të drejtësisë, mbetet një ndër prioritetet e vazhdueshme dhe pjesë integrale e qasjes së Akademisë së Drejtësisë për zbatimin sa më efektiv të programeve trajnuese.

Përveç bashkëpunimit në nivel vendor, Akademia e Drejtësisë ka vazhduar të avancojë bashkëpunimin dhe koordinimin me partnerët ndërkombëtarë, donatorët dhe institucionet relevante trajnuese ndërkombëtare, me qëllim të zbatimit të standardeve evropiane dhe praktikave më të mira në fushën e trajnimit gjyqësor.

Në këtë kuadër, bashkëpunimi dhe koordinimi kanë qenë të orientuara në mbështetjen e zhvillimit të programeve trajnuese, shkëmbimin e përvojave profesionale, forcimin e përmbajtjes së aktiviteteve trajnuese dhe zgjerimin e mundësive për përfituesit e Akademisë në nivel vendor dhe ndërkombëtar.

Në aspektin analitik, ky bashkëpunim ka kontribuar në rritjen e rëndësisë së programeve trajnuese dhe në fuqizimin e dimensionit institucional të Akademisë, duke e pozicionuar atë si një partner aktiv në rrjetet profesionale të trajnimit gjyqësor.

Si rezultat, është forcuar kapaciteti i Akademisë për të zhvilluar programe më të avancuara dhe për të përfituar nga përvojat dhe praktikat më të mira ndërkombëtare, në funksion të ngritjes së kapaciteteve profesionale të akterëve të sistemit gjyqësor dhe prokurorial.

5.2.5 Ngritja e kapaciteteve profesionale administrative, cilësisë së shërbimeve administrative dhe shpenzimeve financiare të buxhetit

Shërbimet e përgjithshme dhe financat, në përputhje me kompetencat ligjore, mbështesin realizimin e të gjitha aktiviteteve të planifikuara në fushën e trajnimeve, veprimtarisë hulumtuese dhe botuese, si dhe aktiviteteve të tjera mbështetëse të Akademisë së Drejtësisë.

Në këtë drejtim, planifikimi i Akademisë gjatë vitit 2025 ka pasur për prioritet fuqizimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore, plotësimin e pozitave të lira në përputhje me rregulloren për organizimin e brendshëm dhe kapacitetet buxhetore, përmirësimin e infrastrukturës së teknologjisë informative, sigurimin e furnizimeve dhe mirëmbajtjes së objektit, si dhe zhvillimin e planit të prokurimit dhe planifikimin buxhetor për vitet në vijim.

Aktivitetet e planifikuara në këtë kuadër janë realizuar nën objektivat si në vijim:

1. transparenca dhe marrëdhënia me publikun;
2. avancimi i kapaciteteve profesionale administrative dhe zbatimi i rregullores për organizimin e brendshëm;
3. ngritja e cilësisë së shërbimeve të teknologjisë informative, administrative dhe logjistike;
4. menaxhimi dhe zbatimi efikas i resurseve financiare;
5. ngritja e cilësisë së furnizimeve me mallra dhe shërbime dhe menaxhimi efektiv i kontratave.

Në aspektin analitik, ky objektivi ka qenë thelbësor për sigurimin e bazës funksionale dhe mbështetëse të institucionit, pa të cilën nuk do të ishte i mundur realizimi efikas i objektivave programore të Akademisë. Si rezultat, është përforcuar kapaciteti administrativ dhe financiar i Akademisë, është përmirësuar cilësia e shërbimeve mbështetëse dhe është siguruar një menaxhim më i strukturuar i burimeve në funksion të realizimit të mandatit institucional.

5.2.6 NGRITJA E TRANSPARENCËS DHE MARRËDHËNIA ME PUBLIKUN

Akademia e Drejtësisë ka qenë e angazhuar në rritjen e transparencës dhe informimit publik për aktivitetet dhe veprimtarinë e saj, përmes publikimit të rregullt të informacioneve në portalin zyrtar, ueb-faqen dhe platformat e mediave sociale, përfshirë LinkedIn dhe Facebook.

Ngritja e transparencës dhe forcimi i marrëdhënies me publikun përbën një ndër objektivat e rëndësishëm të Akademisë së Drejtësisë, në funksion të rritjes së llogaridhënies institucionale dhe përmirësimit të qasjes së publikut në informacion.

Gjatë vitit 2025, Akademia e Drejtësisë ka qenë e angazhuar në mënyrë të vazhdueshme në publikimin e aktiviteteve dhe dokumenteve të saj përmes kanaleve zyrtare të komunikimit, duke përfshirë web-faqen zyrtare, si dhe rrjetet sociale si Facebook dhe LinkedIn.

Në këtë kuadër, gjatë tremujorit të parë të vitit janë publikuar dokumente kyçe strategjike, si:

- Plani i Punës dhe Performancës për vitin 2025;
- Raporti Vjetor i Punës dhe Performancës për vitin 2024.

Po ashtu, janë publikuar thirrje për aplikim për programe dhe seminare ndërkombëtare, duke përfshirë:

- seminarët e EJTN;
- programin HELP Programme of the Council of Europe “Të Drejtat e Njeriut dhe Mjedisi”;
- aktivitetet trajnuese të ofruara nga ERA (Academy of European Law).

Në aspektin e komunikimit publik, gjatë vitit 2025 janë realizuar:

- gjithsej 210 publikime dhe lajme në web-faqe;
- 48 publikime në rrjetin social Facebook;
- 30 publikime në platformën LinkedIn.

Këto aktivitete reflektojnë një qasje të strukturuar dhe proaktive të Akademisë në drejtim të komunikimit institucional dhe transparencës, duke siguruar qasje të hapur dhe të vazhdueshme në informacion për publikun dhe palët e interesit, dhe si rezultat, është rritur dukshmëria e veprimtarisë së Akademisë, është përmirësuar komunikimi me publikun dhe partnerët, si dhe është forcuar besimi institucional ndaj rolit dhe funksionit të saj në sistemin e drejtësisë.

Në aspektin analitik, këto aktivitete reflektojnë një qasje të strukturuar dhe proaktive të Akademisë në drejtim të transparencës dhe komunikimit publik, duke siguruar informim të rregullt dhe të qasshëm për publikun dhe palët e interesit.

Si rezultat i aktiviteteve të zhvilluar është rritur dukshmëria e aktiviteteve të Akademisë, është përmirësuar komunikimi institucional dhe është forcuar besimi i publikut dhe partnerëve në punën dhe rolin e Akademisë së Drejtësisë në sistemin e drejtësisë.

5.3 Aktivitetet e Akademisë së Drejtësisë në përmirësimin e veprimtarisë së saj të përcaktuar me ligj

Gjatë vitit 2025, Akademia e Drejtësisë ka ndërmarrë një sërë aktiviteteve të orientuara në përmirësimin dhe avancimin e veprimtarisë së saj, në përputhje me mandatin dhe kompetencat e

përcaktuara me legjislacionin në fuqi. Veprimtaria e Akademisë Drejtësisë gjatë periudhës raportuese është zhvilluar në një kontekst të karakterizuar nga nevoja për forcimin e mëtejshëm të bazës ligjore dhe funksionale të institucionit, si dhe nga proceset e vazhdueshme të reformës në sistemin e drejtësisë. Në këtë drejtim, Akademia ka kontribuar në mënyrë aktive në përmbushjen e mandatit të saj, duke u mbështetur në kornizën ligjore ekzistuese dhe duke adresuar në praktikë sfidat e identifikuar në kapitujt paraprakë të këtij raporti.

Akademia e Drejtësisë ka vazhduar përkushtimin e saj në lehtësimin e zbatimit praktik të legjislacionit në fuqi, përmes zhvillimit dhe zbatimit të programeve trajnuese të përshtatura me nevojat reale trajnuese, si dhe përmes zhvillimit të burimeve të reja ligjore në funksion të mbështetjes së praktikës gjyqësore dhe prokuroriale.

Në përputhje me kërkesat e Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës, Akademia ka hartuar dhe zbatuar programe trajnuese fillestare dhe të vazhdueshme për gjyqtarë, prokurorë dhe stafin administrativ të gjykatave dhe prokurorive, duke siguruar realizimin e tyre në kohë dhe në përputhje me standardet profesionale. Po ashtu, Akademia ka zhvilluar përmbledhje të praktikës gjyqësore në fusha të ndryshme materiale dhe procedurale, veçanërisht në të drejtën penale dhe civile, duke kontribuar në unifikimin e praktikës dhe rritjen e cilësisë së vendimmarrjes.

Në funksion të përmirësimit të cilësisë së trajnimeve, Akademia ka zbatuar metodologjinë trajnuese në përputhje me Doracakun për Trajnues, si dhe ka realizuar vlerësimin e performancës së trajnuesve të angazhuar gjatë vitit 2025, duke krijuar një bazë më të strukturuar për monitorimin dhe përmirësimin e cilësisë së trajnimeve.

Gjithashtu, Akademia është angazhuar në zbatimin e masave dhe kërkesave që rrjedhin nga dokumentet strategjike të vendit dhe procesi i integritetit evropian, si dhe në avancimin e bashkëpunimit dhe përfaqësimit në rrjetet dhe institucionet e trajnimit gjyqësor në nivel rajonal dhe ndërkombëtar.

Në aspektin e zhvillimit institucional, janë ndërmarrë veprime konkrete për funksionalizimin e plotë të strukturave organizative, përfshirë plotësimin e përbërjes së Këshillit Programor pas dorëheqjeve të evidentuara gjatë vitit, si dhe plotësimin e pozitave të lira në përputhje me Ligjin për Zyrtarët Publik dhe rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës.

Paralelisht, Akademia e Drejtësisë ka forcuar rolin e saj institucional përmes një qasjeje të integruar që lidh planifikimin strategjik, zhvillimin e programeve trajnuese, monitorimin e performancës dhe mbështetjen administrative dhe financiare. Në këtë kuadër, aktivitetet e ndërmarra gjatë periudhës raportuese janë fokusuar në:

- përmirësimin e planifikimit dhe zbatimit të programeve trajnuese, në përputhje me nevojat reale të sistemit të drejtësisë;
- avancimin e kornizës së brendshme rregullative dhe harmonizimin e akteve nënligjore;
- forcimin e mekanizmave të monitorimit, vlerësimit dhe raportimit të performancës;
- zhvillimin e kapaciteteve profesionale dhe administrative të stafit;
- avancimin e bashkëpunimit ndër-institucional dhe ndërkombëtar;
- rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe komunikimit me publikun.

Në të njëjtën kohë, Akademia e Drejtësisë ka vazhduar të adresojë sfidat që lidhen me zbatimin e plotë të mandatit të saj, veçanërisht në aspektin e kompletimit të infrastrukturës ligjore dhe funksionale, si dhe përshtatjen e vazhdueshme me zhvillimet dinamike në sistemin e drejtësisë.

Si rezultat, aktivitetet e realizuara gjatë vitit 2025 kanë kontribuar në përmirësimin e vazhdueshëm të veprimtarisë së Akademisë, duke forcuar rolin e saj institucional, duke rritur cilësinë e trajnimeve

dhe duke mbështetur në mënyrë efektive zhvillimin profesional të akterëve të sistemit të drejtësisë në Republikën e Kosovës.

Këto përpjekje janë në funksion të forcimit të sundimit të ligjit dhe harmonizimit të sistemit të drejtësisë me standardet evropiane.

6. PËRMBUSHJA E PLANIT TË PUNËS DHE TË PERFORMANCËS SI DHE PROGRAMEVE TRAJNUESE, REKOMANDIMET DHE SFIDAT

Plani i Punës dhe i Performancës për vitin 2025, në përgjithësi, është realizuar në masë të konsiderueshme, me përjashtim të disa aktiviteteve trajnuese në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme (PTV) dhe Programit për Trajnim Fillestar (PTF), për të cilat përgatitjet e Akademisë së Drejtësisë kanë qenë të plota, por realizimi i tyre është ndikuar nga faktorë të jashtëm. Programet trajnuese gjatë vitit 2025 janë zhvilluar në përputhje me nevojat e identifikuara të sistemit të drejtësisë, duke u fokusuar në përgatitjen profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve fillestarë, si dhe në avancimin e njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë. Në këtë kuadër, trajnimet kanë adresuar çështje ligjore për të cilat është vlerësuar se ekziston mungesë e praktikës së unifikuar gjyqësore apo që paraqesin sfida të vazhdueshme në praktikën gjyqësore dhe prokuroriale.

Trajnimi fillestar është zbatuar në përputhje me Planin e Punës dhe programet trajnuese për katër (4) gjenerata të gjyqtarëve (XI, XII, XIII dhe XIV) dhe një (1) gjeneratë të prokurorëve (XI). Gjatë vitit 2025, programi i trajnimit fillestar është përfunduar me sukses për gjeneratat XI dhe XII të gjyqtarëve, duke përmbushur në tërësi objektivat e përcaktuara, ndërsa gjeneratat XIII dhe XIV të gjyqtarëve dhe gjenerata XI e prokurorëve kanë qenë në proces të realizimit.

Trajnimet e vazhdueshme janë realizuar në përputhje me Programin për Trajnime të Vazhdueshme për vitin 2025, me përjashtim të disa aktiviteteve të caktuara që janë anuluar për shkak të mungesës së pjesëmarrjes nga përfituesit e planifikuar. Megjithatë, pjesa dërrmuese e aktiviteteve është realizuar dhe ka përfshirë gjyqtarë dhe prokurorë në detyrë, bashkëpunëtorë profesionalë dhe zyrtarë ligjorë, si dhe stafin administrativ dhe profesionistë të tjerë ligjorë.

Analizat dhe hulumtimet kanë pasur ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin e programeve trajnuese, përmes procesit të vlerësimit të nevojave trajnuese, i cili është realizuar në bashkëpunim me të gjithë akterët relevantë të sistemit gjyqësor dhe prokurorial, përfshirë organizimin e punëtorive të përbashkëta. Në kuadër të veprimtarisë botuese, gjatë vitit 2025 janë realizuar botime të rëndësishme në bashkëpunim me Gjykatën Supreme, të fokusuara në praktikën gjyqësore në çështje penale dhe civile, si dhe janë zhvilluar materiale profesionale si Udhëzuesi për provat elektronike dhe përmbledhje të praktikës gjyqësore në fusha specifike, përfshirë veprat penale që lidhen me armët e zjarrit dhe drejtësinë mjedisore.

Një komponent i rëndësishëm i realizimit të planit ka qenë ngritja e cilësisë së metodologjisë trajnuese, përmes zbatimit të Doracakut për Trajnues, organizimit të trajnimeve për trajnues (ToT) dhe vlerësimit të performancës së trajnuesve të angazhuar gjatë vitit raportues. Në këtë kuadër, programi i certifikimit të trajnuesve ka vazhduar, duke siguruar përputhjen e metodologjisë trajnuese me parimet e të nxënit për të rritur.

Në funksion të rritjes së transparencës dhe informimit publik, Akademia e Drejtësisë ka vazhduar publikimin e aktiviteteve, njoftimeve dhe ngjarjeve në ueb-faqen zyrtare dhe në platformat e mediave sociale.

Në funksion të përmirësimit të bazës ligjore dhe funksionale të Akademisë së Drejtësisë, gjatë periudhës raportuese janë ndërmarrë veprime konkrete për inicimin dhe zhvillimin e akteve nënligjore të nevojshme ta dala nga ligji për zyrtar publik për funksionalizimin më të plotë të mandatit të saj. Këto aktivitete janë zhvilluar në përputhje me nevojat e identifikuara gjatë zbatimit praktik të ligjit dhe në koordinim me institucionet relevante.

Në këtë kuadër, Akademia e Drejtësisë ka kontribuar në proceset për përmirësimin e kornizës ligjore, me theks në rregullimin e mëtejshëm të fushave që lidhen me trajnimet e vazhdueshme, veprimtarinë hulumtuese dhe botuese, si dhe zhvillimin e mekanizmave të brendshëm funksionalë.

Në këtë kapitull paraqiten në mënyrë të detajuar arritjet në zbatimin e Planit të Punës dhe të Performancës, programet trajnuese të realizuara, si dhe sfidat dhe rekomandimet për përmirësimin e mëtejshëm të performancës së Akademisë së Drejtësisë.

6.1 ARRITJET NË ZBATIMIN E PLANIT TË PUNËS DHE TË PERFORMANCËS SI DHE PROGRAMEVE TË TRAJNIMEVE GJATË VITIT 2025

Zhvillimet në sistemin gjyqësor dhe prokurorial gjatë vitit 2025 kanë përcaktuar në masë të konsiderueshme dinamikën e punës së Akademisë së Drejtësisë, si në trajnimet fillestare ashtu edhe në trajnimet e vazhdueshme, si dhe në aktivitetet e tjera të përcaktuara me ligj.

Gjatë periudhës raportuese, puna e Akademisë së Drejtësisë është zhvilluar në përputhje me objektivat e Planit të Punës dhe të Performancës, duke reflektuar nevojat dhe zhvillimet aktuale të sistemit gjyqësor dhe prokurorial. Kjo dinamikë ka mundësuar realizimin e suksesshëm të programeve trajnuese dhe arritjen e një niveli të lartë të përmbushjes së aktiviteteve të planifikuara.

Në kuadër të programit të trajnimit fillestar, gjatë vitit 2025 janë përfshirë katër (4) gjenerata të gjyqtarëve të sapoemëruar, përkatësisht gjeneratat XI, XII, XIII dhe XIV, me gjithsej 86 gjyqtarë, si dhe një (1) gjeneratë e prokurorëve të sapoemëruar, gjenerata XI, me 24 prokurorë. Këto programe kanë kontribuar drejtpërdrejt në forcimin e kapaciteteve profesionale të bartësve të rinj të funksioneve gjyqësore dhe prokuroriale. Gjeneratat XI dhe XII të gjyqtarëve kanë përfunduar me sukses të plotë programin e trajnimit teorik dhe praktik, përfshirë testimin përfundimtar, me ç'rast janë përgatitur dhe dorëzuar raportet përfundimtare dhe dosjet individuale për secilin gjyqtar, duke përmbushur plotësisht objektivat e përcaktuara në Planin e Punës për vitin 2025. Ndërkohë, gjatë vitit ka vijuar zbatimi i programit për gjeneratat XIII dhe XIV të gjyqtarëve, si dhe për gjeneratën XI të prokurorëve, duke siguruar vazhdimësi dhe stabilitet në realizimin e programeve trajnuese.

Në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, gjatë vitit 2025 janë realizuar gjithsej 190 aktivitete trajnuese, të cilat kanë përfshirë gjyqtarë, prokurorë, bashkëpunëtorë profesionalë, zyrtarë ligjorë, staf administrativ dhe profesionistë të tjerë ligjorë. Këto trajnime kanë qenë të orientuara në adresimin e çështjeve komplekse dhe sfiduese të praktikës gjyqësore dhe prokuroriale, si dhe në forcimin e kapaciteteve të kategorive të ndryshme të përfituesve sipas mandatit të Akademisë.

Karakteristikë e rëndësishme gjatë kësaj periudhe ka qenë edhe përfshirja e analizave dhe vlerësimeve të nevojave për publikime në çështje ligjore, si dhe vlerësimi i performancës së 73 trajnuesve të angazhuar gjatë vitit 2025 nga organet përkatëse të Akademisë. Kjo qasje ka kontribuar në përmirësimin e lidhjes ndërmjet nevojave të sistemit, zhvillimit të programeve trajnuese dhe cilësisë së zbatimit të tyre.

Në fushën e veprimtarisë botuese, Akademia e Drejtësisë ka kontribuar në zhvillimin e materialeve profesionale, përfshirë botime në bashkëpunim me Gjykatën Supreme që lidhen me praktikën gjyqësore në çështje penale dhe civile, si dhe publikime të tjera si Udhëzuesi për provat elektronike dhe përmbledhje të praktikës gjyqësore në fusha specifike. Këto botime kanë ndihmuar në mbështetjen e praktikës profesionale dhe në forcimin e dimensionit hulumtues dhe botues të institucionit.

Përveç arritjeve të shënuara, realizimi i disa aktiviteteve trajnuese është ndikuar nga faktorë të jashtëm, veçanërisht në rastet e anulimit të aktiviteteve për shkak të mungesës së pjesëmarrjes së përfituesve. Megjithatë, kjo nuk ka ndikuar në përmbushjen e përgjithshme të objektivave të planifikuara, pasi pjesa dërmuese e aktiviteteve është realizuar me sukses dhe në përputhje me programet dhe planifikimet e miratuara.

Në aspektin analitik, viti 2025 karakterizohet nga një përmbushje substanciale e Planit të Punës dhe të Performancës, me theks të veçantë në zhvillimin e programeve trajnuese për gjenerata të shumta të gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapoemëruar, zgjerimin e shtrirjes së trajnimeve të vazhdueshme dhe forcimin e veprimtarisë hulumtuese dhe botuese. Këto zhvillime dëshmojnë për konsolidimin e rolit të Akademisë si institucion kyç në zhvillimin profesional të sistemit të drejtësisë në Republikën e Kosovës.

Aktivitetet e realizuara gjatë vitit 2025 reflektojnë një shtrirje të gjerë të programeve trajnuese dhe një përfshirje të konsiderueshme të kategorive të ndryshme të përfituesve, duke dëshmuar për përmbushje të lartë të objektivave programore të Akademisë së Drejtësisë.

6.2 PËRGATITJA PROFESIONALE E GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE TË SAPO EMËRUAR SI DHE NGRITJA E SHKATHTËSIVE TRAJNUESE

Përgatitja profesionale e gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapoemëruar përfaqëson një nga funksionet themelore dhe më strategjike të Akademisë së Drejtësisë, duke qenë drejtpërdrejt e lidhur me garantimin e cilësisë, pavarësisë dhe profesionalizmit të sistemit gjyqësor dhe prokurorial në Republikën e Kosovës.

Programi i trajnimit fillestar zbatohet në bazë të kompetencave të përcaktuara me Ligjin për Akademinë e Drejtësisë dhe aktet përkatëse që rregullojnë sistemin gjyqësor dhe prokurorial. Zbatimi i këtij programi fillon menjëherë pas marrjes së mandatit zyrtar në funksionin e gjyqtarit apo prokurorit dhe shtrihet në një periudhë njëvjeçare, duke integruar në mënyrë të strukturuar komponentin teorik me atë praktik.

Gjatë vitit 2025, Akademia e Drejtësisë ka zbatuar në mënyrë të qëndrueshme Programin e Trajnimit Fillestar, duke përfshirë katër (4) gjenerata të gjyqtarëve të sapoemëruar, përkatësisht gjeneratat XI, XII, XIII dhe XIV, si dhe një (1) gjeneratë të prokurorëve të sapoemëruar, gjeneratën XI. Kjo shtrirje e programit në disa gjenerata njëkohësisht reflekton kërkesën e shtuar të sistemit të drejtësisë për përgatitje të strukturuar profesionale dhe rritjen e kapaciteteve organizative të Akademisë.

Trajnimi teorik është i konceptuar në formë modulare dhe përfshin gjashtë module për gjyqtarët e rinj dhe pesë module për prokurorët e rinj. Përmbajtja e këtyre moduleve mbulon degët themelore të së drejtës, legjisllacionin vendor në fuqi, standardet evropiane për të drejtat e njeriut, si dhe instrumente të tjera relevante ndërkombëtare. Theksi i veçantë i programit vihet në aspektet

materiale dhe procedurale të legjislacionit, si dhe në temat ndërdisiplinare që synojnë zhvillimin e aftësive praktike për trajtimin, menaxhimin dhe vendimmarrjen në raste konkrete.

Komponenti praktik i trajnimit zhvillohet në gjykatat dhe prokuroritë ku gjyqtarët dhe prokurorët ushtrojnë funksionin e tyre, nën udhëheqjen profesionale të mentorëve të caktuar. Ky proces u mundëson të sapoemëruarve të përfshihen drejtpërdrejt në punën praktike institucionale, ndërsa Akademia e Drejtësisë siguron ndjekjen dhe mbikëqyrjen e vazhdueshme të trajnimit përmes bashkëpunimit të strukturuar me mentorët dhe institucionet përkatëse.

Në kuadër të programit trajnues realizohen gjithashtu vizita dhe aktivitete trajnuese në institucione jashtë sistemit gjyqësor dhe prokurorial, me qëllim të thellimit të njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve të rinj lidhur me funksionimin, kompetencat dhe praktikat e institucioneve shtetërore që kanë ndërlidhje me ushtrimin e funksioneve gjyqësore dhe prokuroriale.

Gjatë vitit 2025, gjeneratat XI dhe XII të gjyqtarëve kanë përfunduar me sukses të plotë programin e trajnimit fillestar, duke përfshirë pjesën teorike, praktike dhe testimin përfundimtar. Për secilin gjyqtar janë përgatitur raportet përfundimtare dhe dosjet individuale, të cilat janë përcjellë institucioneve përkatëse në përputhje me kërkesat ligjore. Ndërkohë, gjatë vitit ka vijuar zbatimi i programit për gjeneratat XIII dhe XIV të gjyqtarëve, si dhe për gjeneratën XI të prokurorëve, duke siguruar vazhdimësi dhe konsistencë në realizimin e programeve trajnuese.

Në funksion të sigurimit të cilësisë, për secilin modul trajnues zhvillohet vlerësimi përfundimtar, ndërsa rezultatet dhe raportet përkatëse të vlerësimit për gjyqtarët i përcillen Këshillit Gjyqësor të Kosovës, përkatësisht Komisionit për Vlerësimin e Performancës, ndërsa për prokurorët Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe komisioneve përkatëse, brenda afateve të përcaktuara ligjore.

Në aspektin analitik, Programi i Trajnimit Fillestar gjatë vitit 2025 ka dëshmuar një shkallë të lartë të organizimit, koordinimit dhe zbatimit metodologjik, duke mundësuar ndërlidhjen efektive të përgatitjes teorike me përvojën praktike institucionale.

Andaj, Akademia e Drejtësisë ka dhënë një kontribut të drejtpërdrejtë në përgatitjen profesionale të gjeneratave të reja të gjyqtarëve dhe prokurorëve, duke forcuar bazën institucionale të sistemit të drejtësisë dhe duke avancuar standardet profesionale në përputhje me praktikat evropiane.

6.2.1 Aktivitetet e realizuara në Programet për Trajnim Fillestar gjatë vitit 2025

Në vitin 2025, Programin e Trajnimit Fillestar e kanë ndjekur katër (4) gjenerata të gjyqtarëve të sapoemëruar (Gjeneratat XI, XII, XIII dhe XIV) dhe një (1) gjeneratë e prokurorëve të sapoemëruar (Gjenerata XI), me gjithsej 110 pjesëmarrës, prej tyre 86 gjyqtarë dhe 24 prokurorë.

Gjatë periudhës raportuese, është siguruar zbatim i plotë dhe i strukturuar i Programit të Trajnimit Fillestar, duke përfshirë në mënyrë të integruar komponentin teorik dhe praktik, në përputhje me programet trajnuese dhe standardet metodologjike të Akademisë së Drejtësisë.

Gjeneratat XI dhe XII të gjyqtarëve kanë përfunduar me sukses programin e trajnimit fillestar gjatë vitit 2025, përfshirë trajnimin teorik, praktik dhe provimin përfundimtar. Në këtë kuadër, janë përgatitur raportet përfundimtare dhe dosjet individuale për secilin gjyqtar, të cilat janë dorëzuar në Këshillin Gjyqësor të Kosovës, në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurat përkatëse të vlerësimit të performancës.

Ndërkohë, gjatë vitit 2025 ka vijuar zbatimi i programit për gjeneratat XIII dhe XIV të gjyqtarëve, si dhe për gjeneratën XI të prokurorëve, të cilat pritet të përfundojnë trajnimin gjatë vitit 2026. Gjenerata XIII ka përfunduar komponentin teorik dhe është në fazën e realizimit të trajnimit praktik në gjykata, ndërsa gjenerata XIV ka filluar realizimin e trajnimit teorik në fund të vitit raportues. Sa i përket prokurorëve, programi i trajnimit fillestar ka filluar në janar 2025 dhe është zhvilluar paralelisht në komponentin teorik dhe praktik.

Në aspektin sasior, gjatë periudhës janar–dhjetor 2025 janë realizuar në total:

- 273 ditë trajnimi teorik
- 547 sesione trajnuese
- 1641 orë trajnimi
- 336 ditë trajnim praktik në gjykata dhe prokurori

Programet trajnuese janë zhvilluar mbi bazën e një qasjeje të integruar modulare, duke përfshirë trajtimin e legjislacionit penal, civil, administrativ dhe ndërkombëtar, si dhe zhvillimin e shkathtësive profesionale dhe ndërdisiplinare të pjesëmarrësve. Në këtë kuadër janë trajtuar tema që lidhen me procedurat penale dhe civile, të drejtat e njeriut, drejtësinë kushtetuese, bashkëpunimin juridik ndërkombëtar, si dhe çështje të tjera relevante për praktikën gjyqësore dhe prokuroriale.

Për realizimin e komponentit teorik janë angazhuar trajnues nga radhët e gjyqtarëve, prokurorëve, profesorëve universitarë dhe ekspertëve institucionalë, ndërsa për komponentin praktik janë angazhuar mentorë në gjykata dhe prokurori, duke siguruar ndërlidhjen efektive ndërmjet teorisë dhe praktikës.

Gjithashtu, gjatë zbatimit të programit është siguruar monitorimi i vazhdueshëm i progresit të pjesëmarrësve dhe vlerësimi i rezultateve të tyre përmes mekanizmave të përcaktuar në programet trajnuese, duke garantuar transparencë dhe cilësi në procesin e vlerësimit.

Në aspektin analitik, zbatimi i Programit të Trajnimit Fillestar gjatë vitit 2025 reflekton një nivel të lartë të konsolidimit institucional dhe të kapaciteteve organizative të Akademisë së Drejtësisë, duke mundësuar përgatitje sistematike dhe cilësore të gjeneratave të reja të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Tabela 5: Të dhënat e trajnimit fillestar për vitin 2025 për gjeneratat XI, XII, XIII dhe XIV e gjyqtarëve dhe gjenerata

Trajnimet fillestare të sapo emëruar	Të trajnuar	Gjinia		Trajnimi teorik			Trajnimi praktik	Totali i ditëve të trajnimit të trajnimit teorik dhe praktik	Trajnuesi	Mentorët
		M	F	Ditë	Sesione	Orë				
Gjyqtarët-gjen. XI	15	9	6	/	/	/	37	37	/	15
Gjyqtarët- gjen. XII	31	17	14	39	78	234	128	167	18	57
Gjyqtarët – gjen.XIII	21	8	13	116	232	696	40	156	31	19
Gjyqtarët – gjen.XIV	19	10	9	28	57	171	/	28	13	/
Prokuror – gjen. XI	24	13	11	90	180	540	131	221	34	24
Totali	110	57	53	273	547	1641	336	609	96	115

e XI e prokurorëve të sapo emëruar

Siç evidentohet nga të dhënat e paraqitura, Programi i Trajnimit Fillestar gjatë vitit 2025 është karakterizuar nga një intensitet i lartë i aktiviteteve trajnuese dhe një përfshirje e gjerë e përfituesve, duke reflektuar rolin kyç të Akademisë së Drejtësisë në zhvillimin profesional të sistemit të drejtësisë.

6.2.1.1 Zbatimi i Programit të Trajnimit Fillestar për gjeneratën XI të gjyqtarëve (2024–2025)

Programi i trajnimit fillestar për gjeneratën XI të gjyqtarëve të sapoemëruar (15 gjyqtarë) është zbatuar në një periudhë njëvjeçare, duke filluar më 05 shkurt 2024 dhe duke përfunduar më 28 shkurt 2025, në përputhje me kornizën ligjore dhe programin trajnues të miratuar nga Akademia e Drejtësisë.

Gjatë vitit 2025, fokusi i këtij programi ka qenë në përmbylljen e komponentit praktik të trajnimit, veçanërisht në fushën penale, ku pjesëmarrësit kanë qenë të angazhuar drejtpërdrejt në punën praktike në gjykatat ku janë emëruar.

Në këtë kuadër janë realizuar gjithsej 37 ditë trajnim praktik, duke u mundësuar gjyqtarëve të sapoemëruar të aplikojnë në praktikë njohuritë e fituara gjatë komponentit teorik dhe të zhvillojnë shkathtësitë profesionale në trajtimin e rasteve konkrete.

Procesi i trajnimit praktik është zhvilluar nën mbikëqyrjen dhe udhëheqjen profesionale të 15 mentorëve në fushën penale, të cilët kanë ofruar mbështetje të vazhdueshme profesionale dhe kanë kontribuar në orientimin praktik të gjyqtarëve gjatë ushtrimit të funksionit të tyre.

Pas përmbylljes së këtij komponenti, është realizuar provimi përfundimtar në përputhje me Rregulloren për Trajnimin Fillestar, duke përmbyllur në mënyrë të plotë ciklin e trajnimit për këtë gjeneratë.

Në vijim, Akademia e Drejtësisë ka përgatitur raportet përfundimtare dhe dosjet individuale për secilin gjyqtar, të cilat janë dorëzuar në Këshillin Gjyqësor të Kosovës, përkatësisht në Komisionin për Vlerësimin e Performancës, në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale.

Në aspektin analitik, kjo gjeneratë përfaqëson një fazë të rëndësishme të konsolidimit të modelit të trajnimit fillestar të Akademisë së Drejtësisë, duke reflektuar një qasje të strukturuar që siguron ndërlidhjen efektive ndërmjet komponentit teorik dhe atij praktik. Zbatimi i suksesshëm i këtij programi ka kontribuar drejtpërdrejt në përgatitjen profesionale të gjyqtarëve të rinj dhe në forcimin e cilësisë së ushtrimit të funksionit gjyqësor në praktikë.

6.2.1.2 Zbatimi i Programit të Trajnimit Fillestar për gjeneratën XII të gjyqtarëve (2024–2025)

Programi i trajnimit fillestar për gjeneratën XII të gjyqtarëve të sapoemëruar (31 gjyqtarë) është zbatuar në periudhën nga 06 shtator 2024 deri më 09 tetor 2025, duke ndjekur një qasje të strukturuar që kombinon në mënyrë të balancuar komponentin teorik me atë praktik. Ngjashëm me gjeneratën paraprake, programi është zhvilluar fillimisht përmes trajnimit teorik, i cili sipas programit ka përfunduar në muajin mars 2025, për të vazhduar më pas me komponentin praktik në gjykatat përkatëse ku janë emëruar gjyqtarët.

Në kuadër të komponentit teorik janë realizuar gjithsej 39 ditë trajnim, që përfshijnë 78 sesione trajnuese, përkatësisht 234 orë trajnim. Trajnimi është zhvilluar në kuadër të disa kurrikulave kryesore, të cilat kanë synuar ndërtimin e një baze të qëndrueshme profesionale dhe ndërdisiplinare për ushtrimin e funksionit gjyqësor.

Në këtë kuadër janë trajtuar:

- çështje nga Kodi i Procedurës Penale, me theks në procedurat që lidhen me kryerësit me çrregullime mendore;
- zhvillimi i shkathtësive personale dhe ndërdisiplinare, përfshirë arsyetimin e vendimeve në lëmin penale dhe civile, si dhe administratën dhe përgjegjësitë e gjyqësorit;
- aspektet e rendit juridik kombëtar dhe ndërkombëtar, përfshirë bashkëpunimin juridik ndërkombëtar në fushën civile;
- legjislacioni dhe shkathtësitë plotësuese, me fokus në ndërmjetësimin në çështje civile;
- fusha e së drejtës civile, administrative dhe ekonomike, duke përfshirë procedurat kontestimore, jokontestimore dhe përmbarimore, të drejtën e detyrimeve, të drejtën administrative, familjare, të punës, komerciale si dhe drejtësinë tranzicionale.

Për realizimin e këtij komponenti janë angazhuar gjithsej 18 trajnues, nga të cilët:

- 6 gjyqtarë nga Gjykata Supreme,
- 7 gjyqtarë nga Gjykata e Apelit,
- 1 gjyqtar nga Gjykata Themelore,
- dhe 4 përfaqësues nga Sekretariati i KGJK-së,

duke reflektuar një përfshirje të gjerë institucionale dhe ekspertizë të nivelit të lartë profesional.

Në vijim të komponentit teorik, është realizuar trajnimi praktik në gjykatat përkatëse, ku janë zhvilluar gjithsej 128 ditë trajnim praktik. Ky proces është mbështetur nga 57 mentorë, të cilët kanë luajtur rol kyç në orientimin praktik të gjyqtarëve dhe në zhvillimin e aftësive të tyre për trajtimin e çështjeve konkrete gjyqësore.

Në aspektin analitik, zbatimi i Programit të Trajnimit Fillestar për këtë gjeneratë dëshmon një avancim të mëtejshëm të modelit të trajnimit të Akademisë së Drejtësisë, duke reflektuar një strukturë të mirëorganizuar të kurrikulave dhe një integrim efektiv të komponentit teorik dhe praktik. Përfshirja e gjerë e trajnuesve dhe mentorëve nga nivele të ndryshme të sistemit gjyqësor ka kontribuar në rritjen e cilësisë së trajnimit dhe në përgatitjen profesionale të gjyqtarëve në përputhje me standardet bashkëkohore.

6.2.1.3 Zbatimi i Programit të Trajnimit Fillestar për gjeneratën XIII të gjyqtarëve (2025–2026)

Programi i trajnimit fillestar për gjeneratën XIII të gjyqtarëve të sapoemëruar (21 gjyqtarë) ka filluar më 18 prill 2025 dhe, sipas planifikimit, do të vazhdojë deri më 27 maj 2026. Ky program përfaqëson një nga ciklet më intensive dhe gjithëpërfshirëse të trajnimit, duke reflektuar një qasje të avancuar në zhvillimin profesional të gjyqtarëve të rinj.

Në kuadër të komponentit teorik, gjatë periudhës raportuese janë realizuar gjithsej 116 ditë trajnim, që përfshijnë 232 sesione trajnuese, përkatësisht 696 orë trajnim, të strukturuar në disa kurrikula themelore dhe të avancuara.

Programi ka përfshirë një gamë të gjerë fushash juridike dhe ndërdisiplinare, duke përfshirë:

- Të drejtën penale, përmes trajnimit të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, me fokus në pjesën e përgjithshme dhe të veçantë, krimin kibernetik dhe politikën ndëshkimore;
- Procedurën penale, përmes një numri të konsiderueshëm modulesh që kanë mbuluar të gjitha fazat e procedurës penale, duke përfshirë procedurën paraprake, rolin e palëve, provat, procedurat e veçanta, mjetet juridike dhe vendimmarrjen gjyqësore;

- Zhvillimin e shkathtësive personale dhe ndërdisiplinare, duke përfshirë etikën profesionale, menaxhimin e rasteve, komunikimin, arsyetimin e vendimeve dhe përgjegjësitë institucionale;
- Rendin juridik kombëtar dhe ndërkombëtar, përfshirë drejtësinë kushtetuese, të drejtën e BE-së, bashkëpunimin juridik ndërkombëtar dhe standardet e KEDNJ-së;
- Legjislacionin plotësues dhe temat ndërdisiplinare, si mbrojtja nga diskriminimi, drejtësia për të mitur, dhuna në familje dhe ndërmjetësimi;
- Të drejtën civile, administrative dhe ekonomike, përmes trajtimit të plotë të procedurave dhe instituteve kryesore juridike, duke përfshirë procedurën kontestimore, jokontestimore dhe përmbartimore, si dhe të drejtën pronësore, detyrimore, familjare, të punës dhe komerciale.

Për realizimin e këtij komponenti teorik janë angazhuar gjithsej 31 trajnues, nga të cilët:

- 12 gjyqtarë nga Gjykata Supreme,
- 9 gjyqtarë nga Gjykata e Apelit,
- 2 gjyqtarë nga Gjykata Komerciale,
- 2 prokurorë nga Prokuroria Speciale,
- 1 prokuror nga Prokuroria Themelore,
- 1 gjyqtar nga Gjykata Themelore,
- 3 profesorë universitarë,
- dhe 1 përfaqësues nga Departamenti për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar.

Kjo përbërje reflekton një ndërthurje të ekspertizës gjyqësore, prokuroriale, akademike dhe institucionale, duke garantuar cilësi të lartë të procesit trajnues.

Në vijim të komponentit teorik, gjatë vitit 2025 ka filluar edhe trajnimi praktik, në kuadër të të cilit janë realizuar 40 ditë trajnim praktik, të zhvilluara në gjykatat përkatëse ku gjyqtarët janë emëruar. Për këtë komponent janë angazhuar gjithsej 19 mentorë, të cilët kanë udhëhequr dhe mbështetur pjesëmarrësit në zhvillimin e aftësive praktike dhe në aplikimin e njohurive teorike në situata konkrete.

Në aspektin analitik, Programi i Trajnimit Fillestar për këtë gjeneratë karakterizohet nga një intensitet i lartë i aktiviteteve trajnuese dhe një shtrirje e gjerë tematike, duke reflektuar një qasje moderne dhe gjithëpërfshirëse ndaj përgatitjes profesionale të gjyqtarëve. Integrimi i thelluar i komponentit teorik me atë praktik, si dhe përfshirja e një numri të madh ekspertësh nga nivele të ndryshme të sistemit të drejtësisë, ka kontribuar në ndërtimin e një profili profesional të qëndrueshëm dhe të avancuar për gjyqtarët e kësaj gjenerate.

Ky program përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt konsolidimit të kapaciteteve të sistemit gjyqësor dhe forcimit të cilësisë së vendimmarrjes gjyqësore në përputhje me standardet evropiane dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare.

6.2.1.4 Zbatimi i Programit të Trajnimit Fillestar për gjeneratën XIV të gjyqtarëve (2025–2026)

Programi i trajnimit fillestar për gjeneratën XIV të gjyqtarëve të sapoemëruar (19 gjyqtarë) ka filluar më 17 nëntor 2025 dhe, sipas planifikimit, do të vazhdojë deri në dhjetor të vitit 2026. Kjo gjeneratë përfaqëson ciklin më të ri të trajnimit fillestar dhe shënon vazhdimësinë institucionale të përgatitjes së gjyqtarëve të rinj në sistemin e drejtësisë.

Gjatë periudhës raportuese, programi është fokusuar në zhvillimin e komponentit teorik, i cili përbën bazën për ndërtimin e njohurive profesionale dhe përgatitjen për fazën praktike të trajnimit. Në këtë

kuadër janë realizuar gjithsej 28 ditë trajnim, që përfshijnë 57 sesione trajnuese, përkatësisht 171 orë trajnim.

Trajnimi teorik është zhvilluar në bazë të një qasjeje modulare dhe ka përfshirë temat dhe fushat kryesore si në vijim:

- Kodi Penal i Republikës së Kosovës, me fokus në pjesën e përgjithshme dhe të veçantë, si dhe trajtimin e krimit kibernetik;
- Kodi i Procedurës Penale, duke përfshirë procedurën paraprake, rolin e palëve në procedurë, si dhe trajtimin e dëshmitarëve dhe të dëmtuarve;
- Shkathtësitë personale dhe ndërdisiplinare, me theks në etikën profesionale, menaxhimin e rasteve, vlerësimin e performancës, komunikimin dhe zhvillimin e aftësive sociale të gjyqtarëve;
- Rendi juridik kombëtar dhe ndërkombëtar, duke përfshirë drejtësinë kushtetuese, bashkëpunimin juridik në çështjet penale dhe standardet e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ);
- Legjislacioni dhe shkathtësitë plotësuese, përmes trajtimit të çështjeve që lidhen me ligjin për kundërvajtje dhe mbrojtjen nga diskriminimi.

Për realizimin e këtij komponenti janë angazhuar gjithsej 13 trajnues, të përbërë nga:

- 5 gjyqtarë nga Gjykata Supreme,
- 4 gjyqtarë nga Gjykata e Apelit,
- 1 prokuror nga Prokuroria Speciale,
- 2 profesorë universitarë,
- dhe 1 përfaqësues nga Departamenti për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar.

Kjo strukturë e trajnuesve siguron një kombinim të përvojës praktike gjyqësore dhe ekspertizës akademike, duke kontribuar në cilësinë dhe relevancën e përmbajtjes trajnuese.

Duke qenë se programi për këtë gjeneratë është në fazën fillestare të zbatimit, komponenti praktik i trajnimit do të zhvillohet në vijim, në përputhje me planin e programit, përmes angazhimit të mentorëve në gjykatat përkatëse ku gjyqtarët janë emëruar.

Në aspektin analitik, Programi i Trajnimit Fillestar për gjeneratën XIV karakterizohet nga një fokus i qartë në ndërtimin e bazës profesionale dhe orientimin fillestar të gjyqtarëve të rinj, duke vendosur themelet për zhvillimin e mëtejshëm të aftësive praktike dhe vendimmarrëse. Përmbajtja e strukturuar dhe përfshirja e temave kyçe juridike dhe ndërdisiplinare sigurojnë një fillim të qëndrueshëm të këtij cikli trajnues.

Ky program përfaqëson një vazhdimësi të rëndësishme të rolit të Akademisë së Drejtësisë në përgatitjen e gjeneratave të reja të gjyqtarëve, duke kontribuar në forcimin e kapaciteteve institucionale dhe në avancimin e standardeve profesionale në sistemin gjyqësor të Republikës së Kosovës.

6.2.1.5 Zbatimi i Programit të Trajnimit Fillestar për gjeneratën XI të prokurorëve (2025–2026)

Programi i trajnimit fillestar për gjeneratën XI të prokurorëve të sapoemëruar (24 prokurorë) ka filluar më 15 janar 2025 dhe, sipas planifikimit, do të vazhdojë deri më 20 shkurt 2026. Ky program përfaqëson një komponent të rëndësishëm të mandatit të Akademisë së Drejtësisë në zhvillimin e kapaciteteve profesionale të sistemit prokurorial.

Gjatë periudhës raportuese, programi është zbatuar në mënyrë të integruar, duke kombinuar komponentin teorik dhe atë praktik. Në këtë kuadër janë realizuar gjithsej 90 ditë trajnim teorik, që përfshijnë 180 sesione trajnuese, përkatësisht 540 orë trajnim, si dhe 131 ditë trajnim praktik në prokuroritë përkatëse.

Trajnimi teorik është zhvilluar në bazë të një strukture modulare dhe ka përfshirë fushat kryesore si në vijim:

- Kodi Penal, me fokus në pjesën e përgjithshme dhe të veçantë, krimin kibernetik dhe politikën ndëshkimore;
- Kodi i Procedurës Penale, si komponenti kryesor i programit, duke përfshirë të gjitha fazat e procedurës penale – nga kallëzimi penal, hetimet dhe masat e veçanta hetimore, deri te aktakuza, shqyrtimi gjyqësor dhe mjetet juridike;
- Rendi juridik kombëtar dhe ndërkombëtar, përfshirë drejtësinë kushtetuese, Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, të drejtën e Bashkimit Evropian dhe bashkëpunimin juridik ndërkombëtar;
- Shkathësitë personale dhe ndërdisiplinare, duke përfshirë etikën profesionale, komunikimin, menaxhimin e rasteve, arsyetimin e akteve akuzuese dhe zhvillimin e aftësive sociale;
- Legjislacionin plotësues, përmes trajtimit të çështjeve që lidhen me ligjin për kundërvajtje dhe dhunën në familje.

Për realizimin e komponentit teorik janë angazhuar gjithsej 34 trajnues, të përbërë nga:

- 10 prokurorë nga Prokuroria Speciale,
- 5 prokurorë nga Prokuroria e Apelit,
- 6 prokurorë nga Prokuroria Themelore,
- 4 prokurorë nga Zyra e Prokurorit të Shtetit,
- 3 profesorë universitarë,
- 1 gjyqtar nga Gjykata Supreme,
- 3 gjyqtarë nga Gjykata e Apelit,
- 1 përfaqësues nga Departamenti për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar,
- dhe 1 koordinator nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Kjo përbërje e gjerë e trajnuesve reflekton një përfshirje të thelluar të sistemit prokurorial dhe gjyqësor, duke siguruar një qasje praktike dhe të harmonizuar në zhvillimin e kapaciteteve profesionale.

Në kuadër të komponentit praktik, janë realizuar 131 ditë trajnim praktik, të zhvilluara në prokuroritë përkatëse ku prokurorët janë emëruar. Për këtë proces janë angazhuar gjithsej 24 mentorë, të cilët kanë mbështetur pjesëmarrësit në aplikimin praktik të njohurive dhe në zhvillimin e aftësive hetimore dhe procedurale.

Në aspektin analitik, Programi i Trajnimit Fillestar për këtë gjeneratë karakterizohet nga një fokus i theksuar në procedurën penale dhe rolin aktiv të prokurorit në sistemin e drejtësisë penale. Pësia e madhe e komponentit praktik dhe përfshirja e një numri të konsiderueshëm të trajnuesve nga nivele të ndryshme të sistemit prokurorial kontribuon në zhvillimin e aftësive profesionale të orientuara drejt praktikës dhe vendimmarrjes efektive.

Ky program përfaqëson një kontribut të drejtpërdrejtë në forcimin e funksionit prokurorial, duke ndikuar në rritjen e cilësisë së ndjekjes penale, efikasitetit të procedura

6.3 AVANCIMI I VAZHDESHËM I NJOHURIVE PROFESIONALE DHE INTERDISIPLINARE TË GJYQTARËVE, PROKURORËVE, STAFIT ADMINISTRATIV GJYQËSOR DHE PROKURORIAL SI DHE PROFESIONISTEVE TË TJERË LIGJOR - (PTV)

Avancimi i kapaciteteve profesionale dhe ndërdisiplinare të gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve të tjerë ligjorë përbën një parakusht thelbësor për funksionimin e një sistemi gjyqësor efikas, të drejtë dhe në përputhje me standardet etike dhe profesionale.

Në këtë drejtim, Programi për Trajnime të Vazhdueshme (PTV) ka për qëllim jo vetëm forcimin e njohurive profesionale, por edhe zhvillimin e shkathtësive analitike, komunikative dhe menaxhuese të përfituesve, duke ndërthurur aspektin teorik me atë praktik dhe duke kontribuar në unifikimin e praktikës gjyqësore dhe prokuroriale.

Gjatë vitit 2025, Akademia e Drejtësisë ka zbatuar Programin për Trajnime të Vazhdueshme në përputhje me Planin e Punës dhe të Performancës, duke u fokusuar në adresimin e nevojave konkrete të sistemit të drejtësisë, të identifikuar përmes mekanizmave të vlerësimit të nevojave trajnuese dhe analizës së praktikës gjyqësore dhe prokuroriale.

Në këtë kuadër, janë realizuar aktivitete trajnuese në fusha të ndryshme materiale dhe procedurale, si në vijim:

- në fushën penale: 27 aktivitete trajnuese;
- në fushën civile: 8 aktivitete trajnuese;
- në drejtësinë për fëmijë (aspekti civil dhe penal): 5 aktivitete;
- në fushën e dhunës ndaj grave, dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore: 5 aktivitete;
- në drejtësinë komerciale: 13 aktivitete;
- në fushën administrative: 7 aktivitete;
- në të drejtën kushtetuese: 1 aktivitet;
- në kundërvajtje: 1 aktivitet;
- në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ): 6 aktivitete;
- në të drejtën e Bashkimit Evropian: 2 aktivitete;
- në kompetencat ndërdisiplinare: 5 aktivitete;
- në ndërmjetësim: 1 aktivitet;
- në fushën e mosdiskriminimit: 2 aktivitete.

Metodologjia e realizimit të këtyre aktiviteteve trajnuese ka qenë e kombinuar, duke përfshirë trajnime klasike, tryeza diskutimi dhe punëtori praktike, çka ka mundësuar një qasje interaktive dhe të orientuar në zgjidhjen e çështjeve konkrete të praktikës profesionale.

Përveç trajnimeve për gjyqtarë dhe prokurorë, gjatë vitit 2025 Akademia e Drejtësisë ka zhvilluar aktivitete të rëndësishme edhe për kategori të tjera përfituese, duke reflektuar një qasje gjithëpërfshirëse në zhvillimin e kapaciteteve të sistemit të drejtësisë.

Në këtë kuadër:

- ❖ për bashkëpunëtorët profesionalë dhe zyrtarët ligjorë janë realizuar gjithsej 11 trajnime, me kohëzgjatje prej 11 ditësh, ku 10 prej tyre kanë qenë nga modulet bazike (penale dhe civile), ndërsa një trajnim ka qenë i dedikuar për menaxhimin e seancave gjyqësore;

- ❖ për stafin administrativ të sistemit gjyqësor janë realizuar gjithsej 87 trajnime, duke reflektuar rëndësinë e rritjes së kapaciteteve administrative në funksion të efikasitetit të sistemit;
- ❖ për stafin administrativ prokurorial janë realizuar 4 trajnime, si dhe 3 trajnime të përbashkëta për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial;
- ❖ gjithashtu janë realizuar 2 aktivitete trajnuese për profesionet e lira, me fokus në zyrtarët e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas dhe përmbaruesit privat.

Në aspektin analitik, Programi për Trajnime të Vazhdueshme gjatë vitit 2025 ka kontribuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në:

- rritjen e profesionalizmit dhe përgjegjshmërisë së akterëve të sistemit të drejtësisë;
- përmirësimin e cilësisë së vendimmarrjes gjyqësore dhe prokuroriale;
- unifikimin e praktikës në fusha të caktuara juridike;
- si dhe në forcimin e kapaciteteve institucionale në nivel sistemik.

Përmes një qasjeje të strukturuar dhe gjithëpërfshirëse, Akademia e Drejtësisë ka arritur të sigurojë një zhvillim të qëndrueshëm profesional për të gjitha kategoritë e përfituesve, duke kontribuar në forcimin e sundimit të ligjit dhe në harmonizimin e praktikës juridike me standardet evropiane.

6.3.1 Aktivitetet trajnuese të realizuara gjatë vitit 2025 në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, arritjet dhe sfidat

Në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme (PTV), gjatë vitit 2025 Akademia e Drejtësisë ka realizuar gjithsej 190 aktivitete trajnuese, me 231 ditë trajnimi dhe me një pjesëmarrje të përgjithshme prej 4456 pjesëmarrësish.

Struktura e pjesëmarrësve reflekton një përfshirje të gjerë dhe gjithëpërfshirëse të aktorëve të sistemit të drejtësisë dhe institucioneve të ndërlidhura. Në këtë kuadër, përfitues kanë qenë:

- 862 gjyqtarë;
- 296 prokurorë;
- 276 bashkëpunëtorë profesionalë;
- 29 zyrtarë ligjorë;
- 14 këshilltarë profesionalë;
- 52 zyrtarë policorë dhe përfaqësues nga institucione të tjera të sigurisë;
- përfaqësues nga institucione të drejtësisë dhe mbështetëse (Shërbimi Sprovues, ANJF, etj.);
- si dhe kategori të tjera përfituese, përfshirë profesionet e lira dhe organizatat relevante.

Një pjesë e konsiderueshme e përfituesve përbëhet nga stafi administrativ i sistemit gjyqësor (2231 pjesëmarrës), si dhe kategori të tjera si:

- 71 staf administrativ prokurorial;
- 48 staf administrativ i përbashkët gjyqësor dhe prokurorial;
- 57 përfaqësues të profesioneve të lira.

Kjo strukturë dëshmon për një qasje të gjerë dhe të integruar të Akademisë së Drejtësisë në zhvillimin e kapaciteteve të të gjitha niveleve të sistemit të drejtësisë.

Në aspektin e shpërndarjes së aktiviteteve trajnuese, nga 190 aktivitetet e realizuara:

- ❖ 83 aktivitete për gjyqtarë, prokurorë dhe kategori të tjera përfituese;
- ❖ 11 aktivitete për bashkëpunëtorë profesionalë dhe zyrtarë ligjorë;

- ❖ 87 aktivitete për të punësuarit në administratën e sistemit gjyqësor;
- ❖ 4 aktivitete për stafin administrativ prokurorial;
- ❖ 3 aktivitete të përbashkëta për administratën gjyqësore dhe prokuroriale;
- ❖ 2 aktivitete për profesionet e lira.

Kjo shpërndarje reflekton një orientim të qartë institucional drejt forcimit të kapaciteteve në të gjitha nivelet e sistemit të drejtësisë.

Në aspektin financiar dhe të bashkëpunimit ndërinstitucional:

- ✓ 141 aktivitete janë realizuar nga buxheti i Akademisë së Drejtësisë;
- ✓ 49 aktivitete janë realizuar me mbështetjen e partnerëve dhe donatorëve ndërkombëtarë.

Ndërkaq, nga 83 aktivitetet për gjyqtarë dhe prokurorë:

- ✓ 47 janë financuar nga buxheti i Akademisë;
- ✓ 36 janë mbështetur nga donatorët.

Ky kombinim reflekton një model të qëndrueshëm financiar dhe një nivel të lartë të bashkëpunimit ndërkombëtar.

Një komponent i rëndësishëm i këtij programi ka qenë edhe zhvillimi i trajnimeve bazike për bashkëpunëtorët profesionalë dhe zyrtarët ligjorë, si dhe trajnimeve për stafin administrativ, të cilat kanë kontribuar në rritjen e efikasitetit dhe cilësisë së funksionimit të institucioneve gjyqësore dhe prokuroriale.

Në tërësi, realizimi i Programit për Trajnime të Vazhdueshme gjatë vitit 2025 paraqet një nivel të lartë të përmbushjes së objektivave të planifikuara dhe një kontribut të drejtpërdrejtë në:

- rritjen e profesionalizmit të akterëve të sistemit të drejtësisë;
- përmirësimin e cilësisë së vendimmarrjes;
- forcimin e kapaciteteve institucionale;
- si dhe harmonizimin e praktikës me standardet evropiane.

Megjithatë, gjatë zbatimit të programit janë evidentuar edhe disa sfida, të cilat lidhen kryesisht me pjesëmarrjen jo të plotë të përfituesve në disa aktivitete trajnuese, çka në raste të caktuara ka ndikuar në anulimin e disa trajnimeve të planifikuara, pavarësisht përgatitjeve të plota nga ana e Akademisë. Përkundër këtyre sfidave, Akademia e Drejtësisë ka arritur të ruajë një nivel të lartë të cilësisë dhe relevancës së programeve trajnuese, duke siguruar orientimin e tyre drejt nevojave reale të sistemit të drejtësisë.

Pasqyra e detajuar e aktiviteteve trajnuese të realizuara në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme gjatë vitit 2025, përfshirë numrin e trajnimeve, ditët e trajnimit, pjesëmarrësit dhe kategoritë përfituese, është paraqitur në tabelën në vijim.

Aktivitetet trajnuese në PTV të realizuar gjatë viti 2025					
Nr.	Përfituesit	Trajnim e/ Tryeza	Ditë	Pjesë marrës	Tipi i Pjesëmarrjes
	Aktivitetet Trajnuese të realizuara gjatë vitit 2025	190	231	4456	Gjyqtarë, Prokurorë, Bashkëpunëtor Profesional, Zyrtar Ligjor dhe përfitues tjerë

Aktivitete Trajnuese të realizuara për gjyqtarë dhe prokurorë gjatë vitit 2025	83	123	1664	Gjyqtarë	8622	2483
				Prokurorë	2964	1095
				Bashkëpunëtorë Profesional	276	
				Zyrtar Ligjor	29	
				Këshilltar profesionale	14	
				Zyrtar Policor	52	
				Inspektoriati Policor i Kosovës	13	
				Zyrtar nga Shërbimi Sprovues	4	
				Inspektor	44	
				Zyrtar te Agjencisë për Ndihme Juridike Falas	7	
				Ndërmjetësues	5	
				Mbrojtës të viktimave	16	
				Oficer te Policisë gjyqësore	10	
				Staf I SKGJK	21	
				Zyrtar nga Ministrinë	6	
				OJQ	2	
Sos Fshati	1					
Tjerë	6					
Aktivitetet trajnuese të realizuara për Bashkëpunëtor profesional dhe Zyrtar Ligjor Modulet bazike aspekti penal dhe civil)	10	10	369	Bashkëpunëtor Profesional	133	
				Zyrtar Ligjor	96	
				Referent	5	
				Zyrtar te Agjencisë për Ndihme Juridike Falas	125	
				Praktikant	5	
				Tjerë	5	
				Trajnime tjera për Bashkëpunëtor Profesional	1	1
Zyrtar për Mbështetje Juridike				2		
Trajnime (fillestare dhe te vazhdueshme) të realizuara për të punësuarit në administratën e sistemit gjyqësor	87	87	2231	Bashkëpunëtorë Profesional	658	
				Zyrtar Ligjor	757	
				Këshilltar Ligjor	1	
				Zyrtar për Personel/BNJ	12	
				Inspektor Gjyqësor	23	
				Udhëheqës i Divizionit	2	
				Drejtor	3	
				Referent	272	
				Zyrtar për statistika	18	
				Zyrtar ekzekutiv	1	
				Sekretar juridik	67	
				Asistent	1	
				Zyrtar për Komunikim me Publik/Media	15	
				Zyrtar për te Hyra	40	
Certifikues	12					

² Numri prej 862 tregon pjesëmarrjen nga radhët e gjyqtarëve

³ Numri 248 tregon gjyqtarët e trajnuar

⁴ Numri prej 296 tregon pjesëmarrjen nga radhët e prokurorëve

⁵ Numri 109 tregon prokurorët e trajnuar

					Zyrtar për Buxhet dhe Financa	9
					Zyrtar për Pasuri	5
					TIK	105
					Arkivist	69
					Zyrtar për Përkthim	53
					Dorëzues	48
					Zyrtar për Inspektim	3
					Zyrtar për logjistike	20
					Zyrtar për transport/Vozitës	10
					Sigurim	3
					Recepcionist	24
	Aktivitetet trajnuese të realizuara për stafin administrativ prokurorial	4	4	71	Bashkëpunëtorë Profesional	18
					Zyrtar Ligjor	42
					Arkivist	2
					Referent	5
					Sekretar juridik	1
					Udhëheqës	1
					Zyrtar për komunikim	1
					TI	1
	Aktivitetet trajnuese të përbashkëta të realizuara për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial	3	3	48	Bashkëpunëtorë Profesional	10
					Zyrtar Ligjor	15
					Zyrtar për ndërmjetësim	1
					Referent	7
					Zyrtar për komunikim	6
					Zyrtar për personel	2
					Mbikëqyrës	1
					Recepcionist	6
	Aktivitetet trajnuese të realizuara për profesione të lira-dhe tjera	2	3	57	Agjencia për Ndihmë Juridike Falas	13
					Zyrtar policor	11
					Përmbaues Privat (21 përmbaues dhe 9 gjyqtarë)	30
					Instituti i Kosovës për Drejtësi	1
					KRTC	1
					OJQ	1

Tabela 12. Përmbledhje e aktiviteteve trajnuese të vazhdueshme të realizuara gjatë vitit 2025

6.3.2 Aktivitetet trajnuese të vazhdueshme të realizuara sipas fushave

Gjatë vitit 2025, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, Akademia e Drejtësisë ka realizuar aktivitete trajnuese në të gjitha fushat kryesore të së drejtës, duke përfshirë fushën penale, civile, drejtësinë për fëmijë në aspektin civil dhe penal, drejtësinë komerciale, administrative dhe kushtetuese, Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), të drejtën e Bashkimit Evropian, kundërvajtjet, ndërmjetësimin, si dhe fusha të rëndësishme ndërdisiplinare.

Gjithashtu, një vëmendje e veçantë i është kushtuar temave me ndjeshmëri të lartë sociale dhe institucionale, si dhuna ndaj grave, dhuna në familje dhe dhuna në bazë gjinore, si dhe çështjeve që

lidhen me mbrojtjen nga diskriminimi, duke reflektuar prioritetet e sistemit të drejtësisë dhe standardet ndërkombëtare.

Në total, në kuadër të kësaj pjese të Programit për Trajnime të Vazhdueshme janë realizuar **83** aktivitete trajnuese sipas fushave, ku vërehet një shpërndarje e balancuar dhe e orientuar në adresimin e nevojave praktike të sistemit gjyqësor dhe prokurorial.

Dominon fusha penale me 27 aktivitete trajnuese, duke reflektuar kompleksitetin dhe prioritetin e kësaj fushe, e ndjekur nga fusha komerciale me 13 aktivitete, fusha civile me 8 aktivitete, fusha administrative me 7 aktivitete, si dhe trajnimet në kuadër të KEDNJ me 6 aktivitete.

Po ashtu, janë realizuar aktivitete të rëndësishme në fusha të ndjeshme dhe me interes strategjik si:

- drejtësia për fëmijë (civile dhe penale);
- kompetencat ndërdisiplinare;
- ndërmjetësimi;
- e drejta e Bashkimit Evropian;
- drejtësia kushtetuese;
- kundër diskriminimi;
- dhe trajtimi i dhunës në baza gjinore.

Kjo shpërndarje tematike dëshmon për një qasje gjithëpërfshirëse dhe të balancuar të Akademisë së Drejtësisë, e orientuar në përmbushjen e nevojave reale të sistemit dhe në forcimin e kapaciteteve profesionale në fusha kyçe të së drejtës.

Pasqyra e detajuar e aktiviteteve trajnuese sipas fushave paraqitet në tabelën në vijim.

Nr.	Aktivitetet trajnuese të realizuar në PTV sipas fushave gjatë 2025	Gjithsej
1	Penale	27
2	Civile	8
3	Drejtësia për Fëmijë - Civile	3
4	Drejtësia për Fëmijë - Penale	2
5	Komerciale	13
6	Administrative	7
7	Kushtetuese	1
8	KEDNJ	6
9	E drejtë e BE-së	2
10	Kundërvajtje	1
11	Ndërmjetësim	1
12	Interdisiplinare	5
13	Dhunën ndaj grave, dhunën në familje dhe dhunën në bazë gjinore	5
14	Kundër diskriminim	2
Totali		83

Tabela nr.2 Aktivitetet trajnuese të realizuar në PTV sipas fushave gjatë 2025

6.3.2.1 Aktivitetet trajnuese nga lëmia penale (materiale dhe procedurale)

Në fushën penale, gjatë vitit 2025 janë realizuar gjithsej **27 aktivitete trajnuese**, në të cilat kanë marrë pjesë **557 pjesëmarrës**, duke reflektuar rëndësinë dhe prioritetin që kjo fushë ka në sistemin gjyqësor dhe prokurorial.

Në kuadër të këtyre aktiviteteve janë trajtuar çështje komplekse dhe aktuale nga e drejta penale materiale dhe procedurale, të cilat janë identifikuar si sfiduese në praktikën gjyqësore dhe prokuroriale. Temat kryesore kanë përfshirë:

- ❖ sekuestrimin dhe konfiskimin, hetimet financiare dhe pastrimin e parave;
- ❖ krimin e organizuar, krimet ekonomike dhe mashtrimet në prokurim publik;
- ❖ bashkëpunimin juridik ndërkombëtar në çështjet penale dhe gjykimin në mungesë;
- ❖ krimet e luftës dhe veprat penale kundër mjedisit;
- ❖ krimin kibernetik, piraterinë digjitale dhe falsifikimin;
- ❖ veprat penale kundër detyrës zyrtare dhe integritetit seksual;
- ❖ ekstremizmin e dhunshëm, radikalizmin dhe terrorizmin;
- ❖ trafikimin e armëve të zjarrit dhe masat e veçanta hetimore;
- ❖ procedurat penale ndaj kryerësve me çrregullime mendore;
- ❖ dëshmitarët e mbrojtur dhe dëshmitarët bashkëpunues;
- ❖ ankesa e të dëmtuarit dhe masat për sigurimin e prezencës së të pandehurit;
- ❖ artikulumin dhe arsyetimin juridik të aktakuzave dhe vendimeve gjyqësore;
- ❖ tryeza për harmonizimin e praktikës gjyqësore dhe bashkëpunimin ndërinstitucional.

Përmes këtyre aktiviteteve, Akademia e Drejtësisë ka synuar:

- ngritjen e kapaciteteve profesionale në interpretimin dhe zbatimin e legjislacionit penal;
- përditësimin e njohurive në përputhje me zhvillimet bashkëkohore dhe standardet ndërkombëtare;
- si dhe promovimin e unifikimit të praktikës gjyqësore dhe prokuroriale.

Kjo qasje ka kontribuar drejtpërdrejt në përmirësimin e cilësisë së trajtimit të rasteve penale dhe në forcimin e sundimit të ligjit.

6.3.2.2 Aktivitetet trajnuese nga lëmia civile (materiale dhe procedurale)

Në fushën civile, gjatë vitit 2025 janë realizuar gjithsej **8 aktivitete trajnuese**, në të cilat kanë marrë pjesë **221 pjesëmarrës**, duke kontribuar në forcimin e kapaciteteve profesionale në trajtimin e çështjeve civile dhe në përmirësimin e praktikës gjyqësore.

Në kuadër të këtyre aktiviteteve janë trajtuar çështje të rëndësishme dhe aktuale nga e drejta civile materiale dhe procedurale, të cilat lidhen drejtpërdrejt me sfidat e praktikës gjyqësore. Temat kryesore kanë përfshirë:

- ❖ procedurat gjyqësore të shpronësimit;
- ❖ mbrojtjen gjyqësore në kontestet e punës sipas Ligjit të Punës;
- ❖ unifikimin e praktikës gjyqësore në marrëdhëniet e detyrimeve dhe çështjet pronësore;
- ❖ marrëdhëniet detyimore dhe sendore me element të huaj dhe bashkëpunimin juridik ndërkombëtar në çështjet civile;
- ❖ marrëdhëniet familjare me element të huaj;
- ❖ analizën e praktikës gjyqësore lidhur me anulimin e vendimeve gjyqësore dhe kthimin e rasteve në rigjykim;
- ❖ praktikën gjyqësore në kontestet e sigurisë dhe shëndetit në punë.

Përmes këtyre aktiviteteve, Akademia e Drejtësisë ka synuar:

- avancimin e njohurive profesionale të gjyqtarëve në zbatimin korrekt të legjislacionit civil;
- forcimin e sigurisë juridike përmes interpretimit të njëtrajtshëm të dispozitave ligjore;
- si dhe promovimin e unifikimit të praktikës gjyqësore në fushën civile.

Këto aktivitete kanë kontribuar në përmirësimin e cilësisë së vendimmarrjes në çështjet civile dhe në rritjen e efikasitetit të trajtimit të kontesteve gjyqësore.

6.3.2.3 Aktivitetet trajnuese për drejtësinë për fëmijë – aspekti civil

Në kuadër të drejtësisë për fëmijë në aspektin civil, gjatë vitit 2025 janë realizuar gjithsej **3 trajnime**, me **60 pjesëmarrës**, duke adresuar çështje me rëndësi të veçantë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në procedurat civile.

Temat e trajtuara kanë përfshirë:

- ❖ mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në rastet e shkurorëzimit;
- ❖ mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në rastet e ndryshimit të statusit të tyre;
- ❖ mbrojtjen gjyqësore të fëmijëve pa kujdes prindëror.

Këto aktivitete kanë synuar avancimin e njohurive profesionale të pjesëmarrësve lidhur me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, me fokus në procedurat ligjore dhe mekanizmat mbrojtës, duke kontribuar në një qasje më të ndjeshme dhe më efektive gjyqësore në këtë fushë.

6.3.2.4 Aktivitetet trajnuese për drejtësinë për fëmijë – aspekti penal

Në aspektin penal të drejtësisë për fëmijë janë realizuar **2 trajnime**, me **43 pjesëmarrës**, të fokusuar në trajtimin e çështjeve që lidhen me mbrojtjen e fëmijëve në procedurën penale.

Temat kryesore kanë përfshirë:

- ❖ veprat penale kundër integritetit seksual;
- ❖ procedurën penale ndaj fëmijëve dhe të miturve.

Fokus i veçantë i këtyre trajnimeve ka qenë trajtimi i rasteve të dhunës seksuale dhe mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në procedurën penale, duke synuar forcimin e kapaciteteve profesionale për trajtim të specializuar dhe të ndjeshëm të këtyre rasteve.

6.3.2.5 Aktivitetet trajnuese nga fusha komerciale

Në fushën e drejtësisë komerciale, gjatë vitit 2025 janë realizuar gjithsej **13 trajnime**, me **306 pjesëmarrës**, duke reflektuar rëndësinë në rritje të kësaj fushe për zhvillimin ekonomik dhe forcimin e sigurisë juridike.

Në kuadër të këtyre aktiviteteve janë trajtuar tema të rëndësishme dhe komplekse, si:

- ❖ marrëdhëniet komerciale me element të huaj dhe bashkëpunimi juridik ndërkombëtar;
- ❖ procedura e falimentimit;
- ❖ Ligji për Shoqëritë Tregtare dhe zhvillimet ligjore përkatëse;
- ❖ kodi doganor dhe akcizat;
- ❖ kontratat në ekonomi, përfshirë kontratat e sigurimit, kreditë dhe kontratat e ndërtimit;
- ❖ kompensimi i dëmit dhe shkëputja e kontratës;

- ❖ njohja dhe përmbartimi i vendimeve të arbitrazhit;
- ❖ të drejtat e pronësisë intelektuale (markat tregtare dhe patentat);
- ❖ e drejta e konkurrencës dhe njohuritë financiare.

Përmes këtyre trajnimeve, Akademia e Drejtësisë ka synuar:

- avancimin e njohurive profesionale në interpretimin dhe zbatimin e legjislacionit komercial;
- përmirësimin e klimës së biznesit dhe forcimin e sigurisë juridike për subjektet tregtare;
- lehtësimin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve komerciale;
- si dhe rritjen e besueshmërisë së sistemit gjyqësor në këtë fushë.

6.3.2.6 Aktivitetet trajnuese nga fusha administrative

Në fushën administrative, gjatë vitit 2025 janë realizuar gjithsej **7 aktivitete trajnuese**, me **101 pjesëmarrës**, duke adresuar çështje kyçe të së drejtës administrative dhe praktikës gjyqësore në këtë fushë.

Temat e trajtuara kanë përfshirë:

- ❖ Ligjin për Konfliktet Administrative;
- ❖ harmonizimin e praktikës gjyqësore në konfliktin administrativ;
- ❖ veçoritë e juridiksionit të plotë dhe rolin e ekspertizës në konfliktet administrative;
- ❖ kontestet e punës sipas Ligjit për Nëpunësit Civilë;
- ❖ mbrojtjen ndërkombëtare të refugjatëve dhe praktikën evropiane përkatëse;
- ❖ çështjet e shtetësisë dhe rrezikun nga pashtetësia;
- ❖ sfidat në vendosjen meritore në çështjet e mbrojtjes ndërkombëtare.

Përmes këtyre aktiviteteve, Akademia e Drejtësisë ka synuar:

- ngritjen e njohurive dhe aftësive praktike për zbatimin efektiv të legjislacionit administrativ;
- forcimin e cilësisë së vendimmarrjes në konfliktet administrative;
- si dhe harmonizimin e praktikës gjyqësore ndërmjet instancave gjyqësore.

6.3.2.7 Aktivitetet trajnuese nga drejtësia kushtetuese

Në periudhën raportuese është realizuar **1 aktivitet trajnuese** në fushën e drejtësisë kushtetuese, në të cilin kanë marrë pjesë **20 gjyqtarë, 4 prokurorë dhe 6 bashkëpunëtorë profesionalë**.

Tema e trajtuar ka qenë:

- ❖ Çështjet aktuale në praktikën e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës në lidhshmëri me praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), sipas kërkesave në lëmin penale.

Ky trajnim ka kontribuar në thellimin e njohurive mbi ndërveprimin ndërmjet jurisprudencës kushtetuese dhe asaj evropiane, si dhe në forcimin e standardeve të kontrollit kushtetues në praktikën gjyqësore.

6.3.2.8 Aktivitetet trajnuese për Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ)

Në kuadër të trajnimeve për KEDNJ, gjatë vitit 2025 janë realizuar gjithsej **6 aktivitete trajnuese**, me **81 pjesëmarrës**, duke reflektuar rëndësinë e vazhdueshme të kësaj fushe për harmonizimin e sistemit të drejtësisë me standardet evropiane.

Temat e trajtuara kanë përfshirë:

- ❖ mbrojtjen e reputacionit, shpifjen dhe paditë SLAPP;
- ❖ përdorimin dhe referimin e jurisprudencës së GJEDNJ-së në arsyetimin e vendimeve gjyqësore;
- ❖ mjetet juridike efektive sipas nenit 13 të KEDNJ-së;
- ❖ nenin 5 të KEDNJ-së (e drejta për liri dhe siguri);
- ❖ nenin 6 të KEDNJ-së (gjykimi brenda një afati të arsyeshëm);
- ❖ zgjatjen e paarsyeshme të procedurave civile dhe penale në praktikën e GJEDNJ-së.

Përmes këtyre aktiviteteve, Akademia e Drejtësisë ka synuar:

- forcimin e kapaciteteve profesionale për aplikimin e drejtpërdrejtë të KEDNJ-së;
- integrimin e jurisprudencës së GJEDNJ-së në vendimmarrjen gjyqësore dhe prokuroriale;
- si dhe avancimin e standardeve të mbrojtjes së të drejtave të njeriut në sistemin e drejtësisë.

6.3.2.9 Aktivitetet trajnuese për të drejtën e Bashkimit Evropian

Në fushën e së drejtës së Bashkimit Evropian, gjatë vitit 2025 janë realizuar **2 aktivitete trajnuese**, me **14 pjesëmarrës**, të cilat kanë adresuar çështje kyçe të ndërlidhura me integrimin evropian dhe bashkëpunimin juridik ndërkombëtar.

Temat e trajtuara kanë përfshirë:

- ❖ bashkëpunimin gjyqësor dhe të zbatuesve të ligjit në çështje penale;
- ❖ aspektet fundamentale të së drejtës së Bashkimit Evropian.

Përmes këtyre aktiviteteve, Akademia e Drejtësisë ka synuar:

- rritjen e kapaciteteve profesionale për zbatimin e standardeve të BE-së;
- forcimin e njohurive mbi mekanizmat e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar;
- si dhe përgatitjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve për procesin e integritimit evropian dhe harmonizimin e praktikës gjyqësore me *acquis communautaire*.

6.3.2.10 Aktivitetet trajnuese nga fusha e kundërvajtjeve

Në fushën e kundërvajtjeve, gjatë periudhës raportuese është realizuar **1 aktivitet trajnuese**, me **24 pjesëmarrës**, i fokusuar në:

- ❖ tërheqjen e parashtresit të kërkesës pas parashtimit të saj në procedurat e inspektoratit.

Qëllimi i këtij trajnimi ka qenë:

- avancimi i njohurive profesionale të pjesëmarrësve në zbatimin korrekt të dispozitave ligjore;
- si dhe përmirësimi i praktikës në trajtimin e rasteve të kundërvajtjeve në përputhje me standardet procedurale.

6.3.2.11 Aktivitetet trajnuese për dhunën ndaj grave, dhunën në familje dhe dhunën me bazë gjinore

Në fushën e dhunës ndaj grave, dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, gjatë vitit 2025 janë realizuar gjithsej **5 aktivitete trajnuese**, me **103 pjesëmarrës**, duke reflektuar rëndësinë strategjike të kësaj fushe për sistemin e drejtësisë.

Temat e trajtuara kanë përfshirë:

- ❖ përgjigjen efektive të drejtësisë penale ndaj dhunës në familje;
- ❖ ndjekjen penale dhe gjykimin e rasteve që përfshijnë dhunën ndaj grave;

- ❖ qasjen e informuar nga trauma në trajtimin e viktimave;
- ❖ urdhrat mbrojtës dhe aspektet e së drejtës familjare në mbrojtjen e viktimave;
- ❖ kuadrin normativ vendor dhe standardet ndërkombëtare në këtë fushë.

Përmes këtyre aktiviteteve, Akademia e Drejtësisë ka synuar:

- avancimin e njohurive profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve;
- forcimin e qasjes së ndjeshme ndaj viktimave dhe mbrojtjes së tyre efektive;
- si dhe harmonizimin e praktikës me standardet ndërkombëtare dhe Strategjinë Kombëtare Kundër Dhunës në Familje dhe Dhunës ndaj Grave.

6.3.2.12 Aktivitetet trajnuese nga kompetencat ndërdisiplinare

Në kuadër të kompetencave ndërdisiplinare, gjatë vitit 2025 janë realizuar gjithsej **5 aktivitete trajnuese**, me **81 pjesëmarrës**, të cilat kanë adresuar fusha që tejkalojnë kornizën klasike juridike, por që janë thelbësore për ushtrimin profesional të funksioneve gjyqësore dhe prokuroriale.

Temat e trajtuara kanë përfshirë:

- ❖ trajtimin e informacionit të klasifikuar në proceset gjyqësore;
- ❖ etikën profesionale për gjyqtarë dhe prokurorë;
- ❖ hartimin dhe arsyetimin e vendimeve gjyqësore;
- ❖ menaxhimin e seancave gjyqësore.

Këto aktivitete trajnuese kanë pasur për qëllim:

- forcimin e kapaciteteve profesionale dhe ndërpersonale të pjesëmarrësve;
- zhvillimin e shkathtësive analitike, komunikative dhe menaxheriale;
- si dhe përmirësimin e cilësisë së vendimmarrjes dhe administrimit të proceseve gjyqësore dhe prokuroriale.

6.3.2.13 Aktivitetet trajnuese kundër diskriminimit

Në fushën e mbrojtjes nga diskriminimi, gjatë periudhës raportuese janë realizuar **2 aktivitete trajnuese**, me **11 pjesëmarrës**, të fokusuara në:

- ❖ mbrojtjen gjyqësore në çështjet që rrjedhin nga Ligji kundër Diskriminimit;
- ❖ trajtimin e diskriminimit me fokus të veçantë në antigjipsizëm.

Qëllimi i këtyre trajnimeve ka qenë:

- avancimi i njohurive profesionale për interpretimin dhe zbatimin korrekt të legjislacionit kundër diskriminimit;
- rritja e ndjeshmërisë institucionale ndaj formave specifike të diskriminimit;
- si dhe përmirësimi i trajtimit të rasteve në praktikën gjyqësore dhe administrative, në përputhje me standardet vendore dhe ndërkombëtare.

6.3.2.14 Aktivitetet trajnuese për ndërmjetësimin

Në fushën e ndërmjetësimit, gjatë vitit 2025 është realizuar **1 aktivitet trajnuese**, me **13 pjesëmarrës**, nga radhët e gjyqtarëve dhe ndërmjetësuesve.

Trajnimi ka qenë i fokusuar në:

- ❖ referimin e lëndëve në procedurën e ndërmjetësimit;

- ❖ zhvillimin e ndërmjetësimit të detyrueshëm, veçanërisht në rastet familjare;
- ❖ si dhe aprovimin ose anulimin e marrëveshjeve të ndërmjetësimit.

Ky aktivitet ka synuar:

- promovimin e përdorimit të mekanizmave alternativë të zgjidhjes së kontesteve;
- rritjen e efikasitetit të sistemit gjyqësor;
- si dhe forcimin e rolit të ndërmjetësimit në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në mënyrë më të shpejtë dhe më efektive.

6.3.2.15 Konferencat e realizuara gjatë vitit 2025

Në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme (PTV), gjatë vitit 2025 janë realizuar gjithsej **2 konferenca**, përkatësisht:

- ❖ Konferenca mbi lirinë e shprehjes dhe mediave;
- ❖ Dialogu gjyqësor për një përgjigje efektive ndaj të gjitha formave të dhunës.

Të dyja konferencat janë realizuar me mbështetjen e projekteve të **Këshillit të Evropës**, duke reflektuar bashkëpunimin e vazhdueshëm ndërkombëtar të Akademisë së Drejtësisë.

Këto konferenca kanë pasur për qëllim:

- ❖ shkëmbimin e njohurive dhe përvojave ndërmjet profesionistëve të drejtësisë;
- ❖ promovimin e praktikave më të mira evropiane;
- ❖ forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërkombëtar.

Po ashtu, ato kanë kontribuar në:

- rritjen e ndërgjegjësimit për çështje të ndjeshme dhe aktuale;
- avancimin e kapaciteteve profesionale të pjesëmarrësve;
- zgjerimin e rrjeteve të bashkëpunimit profesional.

Konferencat janë vlerësuar pozitivisht për cilësinë e përmbajtjes dhe ndikimin e tyre në arritjen e objektivave institucionale dhe ndërinstitucionale.

6.3.2.16 Punëtorja për hartimin e Programit për Trajnime të Vazhdueshme për vitin 2026

Në vijim të procesit të vlerësimit të nevojave trajnuese, gjatë vitit 2025 Akademia e Drejtësisë ka organizuar **punëtorinë për hartimin e Programit për Trajnime të Vazhdueshme për vitin 2026**.

Qëllimi i kësaj punëtorie ka qenë:

- ❖ përktimi i rezultateve të vlerësimit të nevojave trajnuese në planifikim konkret;
- ❖ hartimi i draft-programit të PTV-së për vitin 2026 në përputhje me prioritetet e sistemit të drejtësisë.

Në kuadër të kësaj punëtorie:

- janë identifikuar dhe përcaktuar temat prioritare trajnuese;
- janë zhvilluar konceptet trajnuese sipas metodologjisë së Akademisë së Drejtësisë;
- është siguruar përfshirja aktive e anëtarëve të Këshillit Programor dhe trajnuesve të angazhuar, në përputhje me vendimet e Këshillit Drejtues.

Ky proces ka garantuar një qasje të strukturuar dhe të bazuar në evidencë për planifikimin e aktiviteteve trajnuese për vitin pasues.

6.3.2.17 Aktivitetet trajnuese të anuluar gjatë vitit 2025

Siç është theksuar edhe në pjesët paraprake të këtij raporti, realizimi i Programit për Trajnime të Vazhdueshme gjatë vitit 2025 është karakterizuar nga një nivel i lartë i përmbushjes, megjithatë një numër i kufizuar aktivitetesh trajnuese nuk janë realizuar.

Këto aktivitete janë anuluar kryesisht për shkak të mungesës së pjesëmarrjes së aplikuesve, pavarësisht përgatitjeve të plota organizative dhe profesionale nga ana e Akademisë së Drejtësisë.

Ndër aktivitetet e anuluar përfshihen tema që lidhen me:

- ❖ menaxhimin e rasteve dhe të zyrës;
- ❖ trafikimin me qenie njerëzore;
- ❖ unifikimin e praktikës gjyqësore në Gjykatën e Apelit;
- ❖ hetimet financiare dhe krimin e organizuar;
- ❖ politikat ndëshkimore;
- ❖ ndërmjetësimin;
- ❖ bashkëpunimin juridik ndërkombëtar në çështjet civile dhe komerciale.

Këto sfida theksojnë nevojën për:

- përmirësimin e mekanizmave të koordinimit dhe pjesëmarrjes;
- rritjen e përgjegjësisë institucionale të përfituesve;
- si dhe planifikimin më fleksibil të aktiviteteve trajnuese në të ardhmen.

6.3.2.18 Trajnimet për bashkëpunëtorë profesionalë dhe zyrtarë ligjorë

Në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme gjatë vitit 2025, Akademia e Drejtësisë ka realizuar aktivitete trajnuese të dedikuara për bashkëpunëtorët profesionalë dhe zyrtarët ligjorë, të cilët përbëjnë një segment kyç mbështetës në funksionimin efikas të sistemit gjyqësor dhe prokurorial.

Duke marrë parasysh rolin e tyre në përgatitjen e akteve juridike, analizën e rasteve dhe mbështetjen e proceseve vendimmarrëse, ngritja e kapaciteteve profesionale të kësaj kategorie ka qenë ndër prioritetet e Akademisë së Drejtësisë edhe gjatë vitit 2025.

Gjatë periudhës raportuese janë realizuar gjithsej 11 aktivitete trajnuese, me kohëzgjatje prej 11 ditë trajnimi dhe me një pjesëmarrje të përgjithshme prej 385 pjesëmarrësish.

Në kuadër të këtyre aktiviteteve:

- ✓ 10 trajnime janë realizuar në kuadër të moduleve bazike (penale dhe civile);
- ✓ 1 trajnim është realizuar në fushën ndërdisiplinare.

Në aspektin përmbajtësor:

- ✓ Në lëmin penale (materiale dhe procedurale, përfshirë drejtësinë për fëmijë) janë realizuar 5 trajnime, me gjithsej 170 pjesëmarrës, prej tyre:
 - ✓ 35 bashkëpunëtorë profesionalë;
 - ✓ 66 zyrtarë ligjorë;
 - ✓ referentë;
 - ✓ 54 përfaqësues nga Agjencia për Ndihmë Juridike Falas;
 - ✓ 10 pjesëmarrës nga kategori të tjera.

Në lëmin civile (materiale dhe procedurale) janë realizuar 5 trajnime, me gjithsej 199 pjesëmarrës, prej tyre:

- ✓ 98 bashkëpunëtorë profesionalë;

- ✓ 30 zyrtarë ligjorë;
- ✓ 71 përfaqësues nga Agjencia për Ndihmë Juridike Falas.

Gjithashtu, është realizuar edhe një trajnim ndërdisiplinar me temë “Menaxhimi i seancave gjyqësore”, me 16 pjesëmarrës, prej tyre:

- ✓ 12 bashkëpunëtorë profesionalë;
- ✓ 4 udhëheqës të zyrave për menaxhim juridik.

Këto trajnime kanë kontribuar në:

- forcimin e kapaciteteve profesionale dhe praktike të stafit mbështetës;
- përmirësimin e cilësisë së përgatitjes së akteve juridike;
- rritjen e efikasitetit dhe cilësisë së proceseve gjyqësore dhe prokuroriale.

Trajnimet për Bashkëpunëtor Profesional dhe Zyrtar Ligjor					
Trajnimet	Lemia	Nr.	Numri i pjesëmarrjes	Tipi i Pjesëmarrjes	Financuesi
Modulet Bazike	Penale	5	170	35 bashkëpunëtor profesional 66 zyrtar ligjor 5 referent 54 nga Agjencia për Ndihmë Juridike Falas 10 tjerë	GIZ
	Civile	5	199	98 bashkëpunëtor profesional 30 zyrtar ligjor dhe 71 Agjencia për Ndihmë Juridike Falas	GIZ
Tjera	Interdisiplinare	1	16	12 Bashkëpunëtor Profesional 4 Udhëheqës të Zyrës për Menaxhim Juridik	KE - CEPEJ

Tabela nr. X: Trajnimet për bashkëpunëtorë profesionalë dhe zyrtarë ligjorë

6.3.2.19 Aktivitetet trajnuese të përbashkëta për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial

Stafi administrativ gjyqësor dhe prokurorial përbën një faktor kyç në funksionimin efikas të gjykatave dhe prokurorive, duke kontribuar drejtpërdrejt në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dhe në menaxhimin efektiv të proceseve administrative dhe procedurale.

Në këtë drejtim, gjatë vitit 2025 Akademia e Drejtësisë ka realizuar **3 aktivitete trajnuese të përbashkëta** për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial, me një pjesëmarrje të përgjithshme prej **48 pjesëmarrësish**.

Këto trajnime kanë qenë të orientuara në:

- forcimin e koordinimit dhe bashkëpunimit ndërmjet administratës gjyqësore dhe prokuroriale;
- harmonizimin e praktikave administrative dhe procedurale;
- avancimin e njohurive në fushën e menaxhimit të rasteve dhe proceseve administrative;
- përmirësimin e komunikimit institucional dhe standardeve të shërbimit publik.

Struktura e pjesëmarrësve në këto trajnime ka përfshirë kategori të ndryshme të stafit administrativ, përfshirë bashkëpunëtorë profesionalë, zyrtarë ligjorë, referentë, zyrtarë për komunikim dhe personel, si dhe funksione të tjera mbështetëse, duke reflektuar një qasje gjithëpërfshirëse në zhvillimin e kapaciteteve administrative.

Trajnime të realizuar	3	Financuesi
Ditë trajnimi	3	Akademia e Drejtësisë
Bashkëpunëtorë Profesional	10	
Zyrtar Ligjor	15	
Zyrtar për ndërmjetësim	1	
Referent	7	
Zyrtar për komunikim	6	
Zyrtar për personel	2	
Mbikëqyrës	1	
Receptionist	6	
Numri i pjesëmarrësve në total	48	

Tabela nr. X: Trajnimet për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial

6.3.2.20 Trajnimet (fillestare dhe të vazhdueshme) për të punësuarit në administratën e sistemit gjyqësor

Një komponent shumë i rëndësishëm i Programit për Trajnime të Vazhdueshme gjatë vitit 2025 ka qenë zhvillimi profesional i të punësuarve në administratën e sistemit gjyqësor, me qëllim rritjen e efikasitetit institucional, cilësisë së shërbimeve dhe transparencës në funksionimin e gjykatave.

Gjatë periudhës raportuese, Akademia e Drejtësisë ka realizuar gjithsej:

- ✓ 87 aktivitete trajnuese, me 87 ditë trajnimi dhe me 2231 pjesëmarrës

Këto trajnime kanë qenë të orientuara në:

- ❖ avancimin e kapaciteteve profesionale në menaxhimin administrativ;
- ❖ përmirësimin e zbatimit të legjislacionit për administratën publike;
- ❖ zhvillimin e shkathtësive në përdorimin e sistemeve të informacionit;
- ❖ rritjen e cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve.

Struktura e pjesëmarrësve reflekton një përfshirje të gjerë të kategorive administrative, duke përfshirë bashkëpunëtorë profesionalë, zyrtarë ligjorë, referentë, staf të financave, TI-së, arkivës, komunikimit publik dhe kategori të tjera mbështetëse.

Këto aktivitete kanë kontribuar drejtpërdrejt në:

- rritjen e efikasitetit të proceseve administrative;
- përmirësimin e koordinimit institucional;
- si dhe forcimin e kapaciteteve profesionale në të gjitha nivelet e administratës gjyqësore.

Trajnime e realizuara për të punësuarit në administratën e sistemit gjyqësor						
Nr.	Tema	Nr.	Ditë	Pjesëmarrës	Tipi i Pjesëmarrjes	
	Trajnime (fillestare dhe të vazhdueshme) të realizuara për të punësuarit në administratën e sistemit gjyqësor	87	87	2231	Bashkëpunëtorë Profesional	658
					Zyrtar Ligjor	757
					Këshilltar Ligjor	1
					Zyrtar për Personel/BNJ	12
					Inspektor Gjyqësor	23

				Udhëheqës i Divizionit	2
				Drejtor	3
				Referent	272
				Zyrtar për statistika	18
				Zyrtar ekzekutiv	1
				Sekretar juridik	67
				Asistent	1
				Zyrtar për Komunikim me Publik/Media	15
				Zyrtar për te Hyra	40
				Certifikues	12
				Zyrtar për Buxhet dhe Financa	9
				Zyrtar për Pasuri	5
				TIK	105
				Arkivist	69
				Zyrtar për Përkthim	53
				Dorëzues	48
				Zyrtar për Inspektim	3
				Zyrtar për logjistike	20
				Zyrtar për transport/Vozitës	10
				Sigurim	3
				Recepcionist	24

Tabela X: Trajnimet për administratën e sistemit gjyqësor

6.3.2.21 Trajnimet për stafin administrativ prokurorial

Përveç administratës gjyqësore, Akademia e Drejtësisë gjatë vitit 2025 ka realizuar edhe aktivitete trajnuese të dedikuara për stafin administrativ prokurorial, duke synuar forcimin e kapaciteteve mbështetëse në funksionimin e prokurorive.

Gjatë periudhës raportuese janë realizuar:

- ✓ 4 aktivitete trajnuese me një pjesëmarrje prej 71 pjesëmarrësish

Këto trajnime kanë qenë të fokusuar në:

- ❖ përmirësimin e njohurive profesionale në procedurat administrative;
- ❖ menaxhimin e dokumentacionit dhe organizimin e punës;
- ❖ forcimin e bashkëpunimit ndërinstytucional;
- ❖ si dhe rritjen e performancës në përputhje me standardet dhe kërkesat ligjore.

Struktura e pjesëmarrësve ka përfshirë kategori të ndryshme të stafit administrativ prokurorial, si bashkëpunëtorë profesionalë, zyrtarë ligjorë, arkivistë, referentë dhe funksione të tjera mbështetëse.

Këto aktivitete kanë kontribuar në:

- rritjen e efikasitetit të proceseve prokuroriale;
- përmirësimin e cilësisë së mbështetjes administrative;
- si dhe forcimin e kapaciteteve institucionale të prokurorive.

Trajnimet për Stafin administrativ prokurorial		
Trajnime të realizuar	4	Financuesi
Ditë trajnimi	4	Akademia e Drejtësisë
Bashkëpunëtorë Profesional	18	
Zyrtar Ligjor	42	
Arkivist	2	
Referent	5	
Sekretar juridik	1	
Udhëheqës	1	
Zyrtar për komunikim	1	
TI	1	
Total i pjesëmarrësve	71	

Tabela X: Trajnimet për stafin administrativ prokurorial

6.3.2.22 Aktivitetet trajnuese për profesionet e lira

Në kuadër të mandatit të saj ligjor dhe rolit në zhvillimin profesional të sistemit të drejtësisë, Akademia e Drejtësisë gjatë vitit 2025 ka realizuar aktivitete trajnuese edhe për profesionet e lira që ndërliken me funksionimin e këtij sistemi.

Në këtë drejtim, janë realizuar gjithsej **2 aktivitete trajnuese**, të dedikuara për:

- ✓ përmbarduesit privatë;
- ✓ zyrtarët e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas.

Këto aktivitete trajnuese janë zhvilluar në përputhje me nevojat e identifikuara të këtyre kategorive dhe kanë qenë të fokusuar në:

- ❖ zbatimin e risive të Ligjit për Konfliktet Administrative;
- ❖ dokumentin e besueshëm;
- ❖ shënimin e përmbardimit;
- ❖ si dhe shpenzimet përmbardimore.

Përmes këtyre trajnimeve, Akademia e Drejtësisë ka synuar:

- avancimin e njohurive profesionale të përfituesve;
- harmonizimin e praktikave me kornizën ligjore në fuqi;
- si dhe forcimin e koordinimit ndërmjet aktorëve të ndryshëm të sistemit të drejtësisë.

Këto aktivitete kontribuojnë në funksionimin më të integruar dhe efikas të sistemit të drejtësisë, duke përfshirë edhe profesionet e lira si pjesë e rëndësishme e tij.

6.3.3 Bashkëpunimi me donatorët dhe kapacitetet trajnuese në zbatimin e Programit për Trajnimet të Vazhdueshme gjatë vitit 2025

Në funksion të ngritjes së kapaciteteve profesionale të sistemit gjyqësor dhe prokurorial, Akademia e Drejtësisë gjatë vitit 2025 ka zhvilluar një bashkëpunim të qëndrueshëm me partnerët dhe donatorët

ndërkombëtarë, si dhe ka siguruar një angazhim të konsoliduar të trajnuesve në zbatimin e Programit për Trajnime të Vazhdueshme.

Gjatë periudhës raportuese, partnerët ndërkombëtarë kanë dhënë kontribut të rëndësishëm në realizimin e aktiviteteve trajnuese, përmes ofrimit të ekspertizës, shkëmbimit të praktikave të mira dhe mbështetjes financiare në fusha specifike.

Nga gjithsej 190 aktivitete trajnuese të realizuara në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme:

- 141 aktivitete (75%) janë realizuar nga buxheti i Akademisë së Drejtësisë;
- 49 aktivitete (25%) janë realizuar me mbështetjen e donatorëve.

Sa i përket aktiviteteve trajnuese për gjyqtarë dhe prokurorë (83 aktivitete):

- 47 aktivitete janë realizuar nga buxheti i AD-së;
- 36 aktivitete janë realizuar me mbështetjen e donatorëve.

Mbështetja e donatorëve ka qenë e shtrirë edhe në kategori të tjera përfituese, përfshirë bashkëpunëtorët profesionalë, zyrtarët ligjorë, stafin administrativ dhe profesionet e lira, duke reflektuar një qasje gjithëpërfshirëse në zhvillimin e kapaciteteve të sistemit të drejtësisë.

190 Aktivitetet Trajnuese të realizuara gjatë vitit 2025 në kuadër të PTV-së											
141 janë realizuar nga Buxheti i AD-se											
49 nga Donatorët											
Aktivitete Trajnuese për gjyqtarë dhe prokurorë		Bashkëpunëtor profesional		Aktivitetet trajnuese të përbashkëta të realizuara për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial		Trajnime (fillestare dhe te vazhdueshme) të realizuara për të punësuarit në administratën e sistemit gjyqësor		Aktivitetet trajnuese të realizuara për stafin administrativ prokurorial		Profesione të Lira Ndermjetesues	
AD	47	AD	0	AD	3	AD	87	AD	4	AD	0
Donator	36	Donator	11	Donator	0	Donator	0	Donator	0	Donator	2
83		11		3		87		4		2	
Totali 190											

Tabela 8: Aktivitetet trajnuese të realizuara sipas burimit të financimit gjatë vitit 2025

Bashkëpunimi me donatorët ka përfshirë një gamë të gjerë partnerësh ndërkombëtarë dhe organizatash, si GIZ, Këshilli i Evropës (përmes programeve të ndryshme), OSBE, UNDP, UNHCR, IRZ, UNODC, si dhe organizata të tjera vendore dhe ndërkombëtare.



Aktivitetet Trajnuese e financuara nga Donatorët	
GIZ (Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit)	11
GLPS- Grupi për studime juridike dhe politike	1
Fondi për të Drejtën Humanitare në Kosovë	2

IRZ (German Foundation for International Legal Cooperation)	2
Këshilli i Evropës - CYBERKOP	1
Këshilli i Evropës - CEPEJ (Komisioni Evropian për Efikasitet të Drejtësisë)	2
Këshilli i Evropës - Mbështetja e Gjykatës Kushtetuese në zbatimin dhe shpërndarjen e standardeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut	5
Këshilli i Evropës - Përafrimi i ligjeve dhe politikave me Konventën e Stambollit	5
Këshilli i Evropës - PRO-FREX-K (Protecting Freedom of Expression and of the Media)	2
Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve - KOMF	2
OJQ "Terre des hommes"	1
OSBE	4
Programi i Punëve të Brendshme i Bashkimit Evropian në Projektin e Kosovës (HAPE)	2
Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN)	1
Shkolla e Magjistratës në Shqipëri	1
UNDP	2
UNHCR	3
United Nations Office on Drugs and Crime - UNODC	1
Western Balkans Rule of Law Initiative (WBROLI)	1
Totali	49

Tabela 9: Aktivitetet trajnuese të financuara nga donatorët

Ky bashkëpunim ka kontribuar në:

- avancimin e cilësisë dhe diversitetit të programeve trajnuese;
- përfshirjen e ekspertizës ndërkombëtare;
- harmonizimin e praktikave vendore me standardet evropiane;
- si dhe forcimin e kapaciteteve institucionale të Akademisë së Drejtësisë.

6.3.4 Trajnuesit e angazhuar për zbatim të Programit për Trajnime të Vazhdueshme gjatë vitit 2025

Zbatimi i Programit për Trajnime të Vazhdueshme gjatë vitit 2025 është mbështetur në një strukturë të konsoliduar të trajnuesve, të cilët kanë kontribuar në realizimin e aktiviteteve trajnuese në përputhje me standardet profesionale dhe metodologjinë e Akademisë së Drejtësisë.

Gjatë vitit 2025 janë angazhuar gjithsej 74 trajnues, të cilët përfaqësojnë një kombinim të ekspertizës nga:

- sistemi gjyqësor;
- sistemi prokurorial;
- komuniteti akademik dhe profesional;
- institucionet publike dhe organizatat relevante.

Struktura e trajnuesve përfshin:

- ✓ 28 trajnues nga sistemi gjyqësor
- ✓ 20 trajnues nga sistemi prokurorial
- ✓ 26 nga radhët e profesionistëve të tjerë ligjorë dhe ekspertëve ndërkombëtar.

Kjo përbërje ka siguruar një balancë ndërmjet përvojës praktike dhe njohurive teorike dhe ndërdisiplinare, duke ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e cilësisë dhe relevancës së aktiviteteve trajnuese.

Në funksion të sigurimit të cilësisë së trajnimeve, Akademia e Drejtësisë ka vazhduar:

- vlerësimin e performancës së trajnuesve përmes feedback-ut të pjesëmarrësve;
- monitorimin e aktiviteteve trajnuese;
- zbatimin e Programit të Certifikimit të Trajnuesve dhe trajnimeve për trajnerë (ToT);
- përzgjedhjen e trajnuesve nga lista e miratuar nga Këshilli Drejtues.

Trajnuesit e angazhuar për zbatim të PTV gjatë 2025	
Trajnuesit nga radhët e sistemi gjyqësor	28
Gjykata Supreme	11
Gjykata e Apelit	9
Gjykata Komerciale	3
Gjykatat Themelore	5
Trajnuesit nga radhët e Sistemit Prokurorial	20
ZKPSH	2
Prokuroria e Apelit	4
PSRK	9
Prokuroria Themelore	5
Ekspert	4
Profesor Universitar	4
Policia e Kosovës	1
Njësia e Inteligjencës Financiare	1
MD	1
Ekspert Ndërkombëtar	15
Totali	74

Tabela X. Trajnuesit e angazhuar për zbatim të PTV gjatë vitit 2025

6.3.5 Aktivitetet trajnuese të realizuara me Rrjetin Evropian të Trajnimit Gjyqësor (EJTN)

Në kuadër të bashkëpunimit me Rrjetin Evropian të Trajnimit Gjyqësor (EJTN), gjatë vitit 2025 është realizuar një (1) trajnim dy-ditor me temë: *“Masat mbrojtëse procedurale në procedurat penale në BE në praktikë: fokus në Direktivën e Avancuar për Fëmijë”*, në të cilin ka marrë pjesë një prokuror.

Ky trajnim ka kontribuar në avancimin e njohurive lidhur me standardet evropiane në procedurat penale, me theks të veçantë në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, duke reflektuar përkushtimin e Akademisë së Drejtësisë për harmonizimin e praktikës vendore me *acquis* të Bashkimit Evropian.

6.3.6 Aktivitetet trajnuese të realizuara në bashkëpunim me ERA

Në bashkëpunim me Akademinë Evropiane të së Drejtës (ERA), gjatë periudhës raportuese janë realizuar gjithsej gjashtë (6) aktivitete trajnuese.

Nga këto:

- dy (2) trajnime kanë trajtuar temën *“E Drejta e BE-së për barazi gjinore”*;
- katër (4) trajnime kanë trajtuar temën *“E drejta e BE kundër diskriminimit”*.

Në këto aktivitete kanë marrë pjesë gjithsej 6 përfitues, duke kontribuar në avancimin e njohurive profesionale në fushën e të drejtave themelore, barazisë dhe mosdiskriminimit, si dhe në përafrimin me standardet e Bashkimit Evropian.

6.3.7 Zbatimi i trajnimeve përmes platformës HELP

Në kuadër të përdorimit të platformave moderne të mësimi në distancë, Akademia e Drejtësisë ka vazhduar zbatimin e trajnimeve përmes platformës HELP të Këshillit të Evropës.

Gjatë vitit 2025 janë realizuar dy (2) trajnime:

- “Të Drejtat e Njeriut dhe Mjedisi” – me 18 pjesëmarrës;
- “E drejta për Liri dhe Siguri (Neni 5 i KEDNJ)” – me 16 pjesëmarrës.

Këto trajnime kanë kontribuar në avancimin e njohurive të pjesëmarrësve në fushën e të drejtave të njeriut, duke reflektuar rëndësinë e integritetit të teknologjisë dhe metodave fleksibile të të nxënimit në zhvillimin profesional të vazhdueshëm.

6.3.8 Trajnimi i detyrueshëm për gjyqtarë dhe prokurorë bazuar në performancë

Në mbështetje të vendimeve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe në përputhje me Protokollin për Trajnime të Detyrueshme, gjatë vitit 2025 Akademia e Drejtësisë ka zhvilluar programin e trajnimit të vazhdueshëm obligativ për gjyqtarët dhe prokurorët, bazuar në rezultatet e vlerësimit të performancës.

Programi është hartuar duke respektuar të gjitha procedurat dhe mekanizmat përkatës, përfshirë përshtatjen e përmbajtjes së moduleve trajnuese sipas rekomandimeve të Komisionit për Vlerësimin e Performancës.

Gjatë zbatimit të këtij programi janë realizuar gjithsej:

- ✓ shtatë (7) sesione trajnuese, me një kohëzgjatje totale prej 21 orësh trajnim.

Qëllimi kryesor i këtij programi ka qenë:

- forcimi i kapaciteteve profesionale;
- përmirësimi i performancës individuale;
- zhvillimi i shkathtësive praktike në fushat ku janë identifikuar nevojat për avancim.

Ky program përfaqëson një mekanizëm të rëndësishëm për lidhjen e drejtpërdrejtë ndërmjet vlerësimit të performancës dhe zhvillimit profesional të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

6.4 ZHVILLIMI I PROGRAMEVE TRAJNUESE PËRMES ANALIZAVE HULUMTIMEVE DHE VEPRIMTARISË BOTUESE

Përmes aktiviteteve hulumtuese, analizeve të dhenave dhe veprimtarive botuese, Akademia e Drejtësisë ka për qëllim të ndihmojë ngritjen dhe zhvillimin profesional të gjyqtarëve, prokurorëve, stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial, si dhe profesionistëve të tjerë ligjor, përmes zhvillimit të programeve trajnuese të bazuara në nevojat reale të sistemit të drejtësisë, si dhe përmes publikimit të botimeve të reja juridike.

Në këtë kuadër, zhvillimi i programeve trajnuese është mbështetur drejtpërdrejt në procesin e analizave dhe hulumtimeve profesionale, duke siguruar që përmbajtja e trajnimeve të jetë e përditësuar, relevante dhe e orientuar në sfidat konkrete të praktikës gjyqësore dhe prokuroriale.

Në këto kontekste veprimtaria e Akademisë së Drejtësisë gjatë vitit 2025 është karakterizuar nga një qasje e integruar, e cila ndërlikohet në mënyrë funksionale:

- ✓ identifikimin e nevojave trajnuese;
- ✓ zhvillimin e programeve trajnuese;

- ✓ realizimin e botimeve profesionale;
- ✓ si dhe përditësimin e literatures juridike,

me theks të veçantë në mbështetjen e praktikës gjyqësore dhe prokuroriale dhe në promovimin e unifikimit të saj.

Aktivitetet kryesore të realizuara gjatë periudhës raportuese janë fokusuar në:

- përgatitjen e raporteve të punës, planeve dhe dokumenteve strategjike në përputhje me kërkesat ligjore;
- zhvillimin dhe publikimin e burimeve të reja juridike, përfshirë përmbledhjet e praktikës gjyqësore në fusha të ndryshme të së drejtës;
- përditësimin e bibliotekës elektronike me burime të reja ligjore dhe materiale profesionale;
- mbledhjen, analizimin dhe përpunimin e të dhënave statistikore në funksion të planifikimit dhe raportimit;
- si dhe shpërndarjen e informatave dhe raportimin ndaj institucioneve të sistemit të drejtësisë dhe mekanizmave të integritetit evropian.

Në të njëjtën kohë, Akademi e Drejtësisë ka luajtur rol kyç në krijimin e një baze të qëndrueshme njohurish, e cila mbështet zhvillimin e programeve trajnuese dhe kontribuon në përmirësimin e cilësisë së vendimmarrjes në praktikën gjyqësore dhe prokuroriale.

Në tërësi, aktivitetet e Akademisë së Drejtësisë kanë kontribuar në:

- ❖ rritjen e cilësisë dhe relevancës së programeve trajnuese;
- ❖ përmirësimin e qasjes në burime juridike;
- ❖ forcimin e kapaciteteve analitike dhe hulumtuese të institucionit;
- ❖ si dhe në konsolidimin e rolit të Akademisë së Drejtësisë si institucion kyç në zhvillimin profesional dhe unifikimin e praktikës në sistemin e drejtësisë në Republikën e Kosovës.

6.4.1 Zbatimi i procesit të nevojave trajnuese për hartimin e Programit Trajnues për vitin 2026

Edhe gjatë vitit 2025, në përputhje me kornizën ligjore dhe rregullative në fuqi, Akademia e Drejtësisë ka zbatuar në mënyrë sistematike mekanizmat për vlerësimin e nevojave trajnuese për të gjitha kategoritë përfituese, përfshirë gjyqtarët dhe prokurorët e sapoemëruar, gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë, si dhe stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial.

Procesi i vlerësimit të nevojave trajnuese është zhvilluar përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse dhe të integruar, duke shfrytëzuar në mënyrë të kombinuar burimet dhe instrumentet brenda Akademisë së Drejtësisë, si dhe inputet nga institucionet dhe akterët e jashtëm të sistemit të drejtësisë.

Ky proces ka filluar paralelisht me zbatimin e Programit Trajnues për vitin 2025, përmes analizës së të dhënave të mbledhura nga formularët e vlerësimit pas çdo moduli në kuadër të trajnimeve fillestare dhe të vazhdueshme. Gjetjet nga këto vlerësime janë shqyrtuar dhe analizuar në mënyrë të vazhdueshme, duke shërbyer si bazë për identifikimin e nevojave konkrete trajnuese.

Në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme, përveç formularëve të vlerësimit, një instrument i rëndësishëm ka qenë edhe pyetësi i shpërndarë gjatë muajit maj për të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët në sistem, i cili ka mundësuar identifikimin më të gjerë dhe më gjithëpërfshirës të nevojave trajnuese, përtej pjesëmarrësve aktualë në trajnime.

Procesi i vlerësimit të nevojave trajnuese është plotësuar edhe përmes konsultimeve të drejtpërdrejta me Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës, si dhe përmes takimeve me

gjyqtarë dhe prokurorë nga të gjitha nivelet dhe fushat juridike, duke siguruar reflektimin e perspektivave institucionale dhe praktike në hartimin e programeve trajnuese.

Një komponent i rëndësishëm i këtij procesi ka qenë edhe analiza e raporteve të trajnuesve pas realizimit të aktiviteteve trajnuese, si dhe shqyrtimi i kërkesave dhe obligimeve që rrjedhin nga dokumentet strategjike të vendit dhe raportet ndërkombëtare, veçanërisht Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën, Strategjia për Sundimin e Ligjit dhe raportet e institucioneve dhe organizatave që monitorojnë sistemin e drejtësisë.

Në funksion të konsolidimit të këtij procesi, gjatë muajit korrik është organizuar një punëtori e përbashkët me kryetarët e gjykatave, kryeprokurorët, partneret ndërkombëtare dhe donatorët , përfaqësues të agjencive, përmes së cilës janë identifikuar prioritetet kryesore të sistemit gjyqësor dhe prokurorial, duke orientuar përmbajtjen e Programit Trajnues për vitin 2026, i cili më pas i është propozuar Këshillit Programor për shqyrtim dhe miratim.

Një karakteristikë e veçantë e këtij viti ka qenë edhe avancimi i qasjes së Akademisë në drejtim të matjes së ndikimit të trajnimeve në përvetësim të njohurive, përtej vlerësimeve tradicionale të kënaqshmërisë me trajnimet. Në këtë kuadër, është realizuar një proces i veçantë vlerësimi i ndikimit të trajnimeve në përvetësim të njohurive në trajnim , për trajnimet e zhvilluara gjatë periudhës 2024–2025 në fushën e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, me mbështetjen e projektit të Këshillit të Evropës “Përafrimi i ligjeve dhe politikave me Konventën e Stambollit”.

Për realizimin e këtij procesi janë përdorur instrumente të avancuara, përfshirë pyetësorë të dedikuar për pjesëmarrësit në trajnime, intervista dhe fokus grupe me gjyqtarë, prokurorë dhe akterë të tjerë relevantë të sistemit të drejtësisë.

Rezultatet preliminare të këtij vlerësimi tregojnë një ndikim të dukshëm pozitiv të kurrikulës trajnuese të Akademisë së Drejtësisë, në veçanti në:

- ❖ rritjen e ndërgjegjësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve për trajtimin e rasteve të dhunës në familje;
- ❖ ndjeshmërinë e shtuar ndaj viktimave dhe ndërveprimin me to;
- ❖ njohjen dhe trajtimin e fëmijëve si dëshmitarë të dhunës;
- ❖ përmirësimin e cilësisë së arsytimit gjyqësor;
- ❖ vlerësimin më të saktë të rrethanave për lëshimin e urdhrave mbrojtës;
- ❖ si dhe kuptimin më të avancuar të formave të dhunës psikologjike dhe ekonomike.

Megjithatë, procesi ka identifikuar edhe sfida të vazhdueshme, të lidhura kryesisht me faktorë jashtë sistemit të trajnimit, si normat patriarkale dhe mungesa e shërbimeve sociale mbështetëse, të cilat ndikojnë në trajtimin e këtyre rasteve në praktikë.

Në tërësi, procesi i vlerësimit të nevojave trajnuese gjatë vitit 2025 ka rezultuar në një qasje më të strukturuar, më të bazuar në evidencë dhe më të orientuar në rezultate, duke kontribuar drejtpërdrejt në hartimin e një Programi Trajnues më cilësor dhe më të përshtatur me nevojat reale të sistemit të drejtësisë.

6.4.2 Ngritja e cilësisë së trajnimeve, monitorimi dhe analiza e të dhënave për vlerësimin e performancës së trajnuesve gjatë vitit 2025

Gjatë periudhës raportuese, në pajtim me Rregulloren Nr. 02/2019 për Trajnues dhe Mentorët e Akademisë së Drejtësisë, si dhe Rregulloren Nr. 01/2023 për plotësimin dhe ndryshimin e saj,

Akademia e Drejtësisë ka zhvilluar një proces të strukturuar për ngritjen e cilësisë së trajnimeve përmes monitorimit dhe analizës së performancës së trajnuesve të angazhuar në zbatimin e programeve trajnuese.

Në këtë kuadër, është realizuar mbledhja dhe analiza sistematike e të dhënave për trajnuesit e caktuar nga Këshilli Drejtues për zbatimin e trajnimeve fillestare dhe të vazhdueshme gjatë vitit 2025. Procesi i monitorimit është bazuar në kriteret dhe indikatorët e përcaktuar në rregulloret përkatëse, duke u mbështetur në:

- ❖ sistemin për menaxhimin e aktiviteteve trajnuese;
- ❖ formularët e vlerësimit nga pjesëmarrësit;
- ❖ raportet e trajnuesve pas realizimit të trajnimeve;
- ❖ si dhe instrumente të tjera të brendshme të vlerësimit.

Bazuar në këto të dhëna, është hartuar raporti i veçantë për secilin trajnues të angazhuar në zbatim të programeve trajnuese, ku pas shqyrtimit dhe vlerësimit nga Këshillin Programor janë dhënë rekomandimet për Këshillin Drejtues, për miratim të performancës së trajnuesve. Ky proces ka shërbyer si një bazë e rëndësishme për vendimmarrjen lidhur me angazhimin e trajnuesve në programet e ardhshme trajnuese.

Rezultatet e raportit të performancës tregojnë se trajnuesit:

- trajnuesit në përgjithësi i janë përmbajtur metodologjisë trajnuese dhe objektivave të përcaktuara sipas plan-programit;
- ka pasur koordinim të mirë paraprak ndërmjet trajnuesve dhe Akademisë së Drejtësisë;
- cilësia e ligjërimit dhe përmbajtjes trajnuese është vlerësuar pozitivisht nga pjesëmarrësit;
- dhe është evidentuar një nivel i kënaqshëm i profesionalizmit dhe angazhimit në procesin trajnuese.

Gjatë vitit 2025, në zbatimin e trajnimeve fillestare dhe të vazhdueshme janë angazhuar gjithsej 78 trajnues, nga lista prej 142 trajnuesve të certifikuar të Akademisë së Drejtësisë, përfshirë edhe dy trajnuesit e përhershëm të saj.

Struktura e trajnuesve reflekton një përfaqësim të gjerë institucional dhe profesional. Nga radhët e gjyqtarëve janë angazhuar 28 trajnues, prej tyre:

- ✓ 11 nga Gjykata Supreme e Kosovës;
- ✓ 9 nga Gjykata e Apelit;
- ✓ 3 nga Gjykata Komerciale;
- ✓ 5 nga Gjykatat Themelore.

Nga radhët e prokurorëve janë angazhuar gjithsej 20 trajnues, prej tyre:

- ✓ 2 nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit;
- ✓ 9 nga Prokuroria Speciale;
- ✓ 4 nga Prokuroria e Apelit;
- ✓ 5 nga Prokuroritë Themelore.

Nga radhët e profesionistëve të tjerë ligjorë dhe ekspertëve ndërkombëtar janë angazhuar 26 trajnues.

Ky diversitet profesional ka kontribuar ndjeshëm në pasurimin e përmbajtjes trajnuese dhe në ndërlidhjen më të mirë të teorisë me praktikën.

Raportet individuale të performancës u janë përcjellë secilit trajnuese, duke krijuar një mekanizëm transparent dhe zhvillimor, i cili synon përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së trajnimeve dhe forcimin e standardeve metodologjike të Akademisë së Drejtësisë.

Në tërësi, procesi i monitorimit dhe vlerësimit të performancës së trajnuesve gjatë vitit 2025 ka kontribuar në:

- konsolidimin e standardeve të cilësisë në trajnim;
- rritjen e efektivitetit të programeve trajnuese;
- përmirësimin e vazhdueshëm të metodologjisë trajnuese;
- si dhe në forcimin e bazës profesionale për planifikimin e programeve të ardhshme.

6.4.3 Hulumtimi dhe përmbledhja e konkluzioneve për unifikimin e praktikës gjyqësore dhe publikimi i tyre;

Gjatë vitit 2025, Akademia e Drejtësisë ka avancuar qasjen e saj në drejtim të hulumtimit të praktikës gjyqësore dhe identifikimit të çështjeve që ndikojnë në mungesën e unifikimit të saj, duke aplikuar një metodologji më të strukturuar dhe të bazuar në evidencë.

Në këtë kuadër, tryezat e planifikuara sipas Programit për Trajnime të Vazhdueshme për vitin 2025 në fushën penale dhe civile janë konceptuar pa përmbajtje të paracaktuar, me qëllim që tematika e tyre të përcaktohet mbi bazën e gjetjeve nga praktika reale gjyqësore.

Kjo qasje ka mundësuar që gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit të realizohet një proces i mirëfilltë hulumtimi për identifikimin e jokonsistencës në praktikën gjyqësore, ndërsa në gjashtëmujorin e dytë përmbajtja e tryezave të orientohet në trajtimin e çështjeve më sfiduese dhe më relevante për sistemin gjyqësor.

Për realizimin e këtij procesi janë përdorur disa instrumente dhe mekanizma të ndërlidhur, duke përfshirë:

- hartimin dhe shpërndarjen e pyetësorëve për gjyqtarët e Gjykatës së Apelit, si nivel kyç në unifikimin e praktikës gjyqësore;
- analizën e çështjeve të kthyera në rigjykim, si indikator i problematikave në interpretimin dhe zbatimin e ligjit;
- diskutimet e strukturuar me trajnuesit dhe panelistët e angazhuar në tryeza;
- si dhe shqyrtimin e praktikës gjyqësore relevante në rastet problematike.

Në bazë të këtyre gjetjeve dhe konfirmimit të tyre nga trajnuesit dhe panelistët, është përcaktuar përmbajtja e tryezave, duke u fokusuar në çështje konkrete dhe problematika të identifikuar në praktikë.

Gjatë realizimit të tryezave janë zhvilluar diskutime profesionale të strukturuar, të cilat kanë rezultuar me:

- ❖ identifikimin e qasjeve të ndryshme në vendimmarrje;
- ❖ analizën e boshllëqeve dhe paqartësive në interpretimin ligjor;
- ❖ dhe nxjerrjen e rekomandimeve konkrete për trajtimin e çështjeve juridike të caktuara.

Rekomandimet e dala nga këto tryeza janë përmbledhur përmes raporteve të trajnuesve dhe janë përdorur si bazë për:

- orientimin e programeve trajnuese të ardhshme;
- përmirësimin e përmbajtjes së moduleve trajnuese;
- si dhe adresimin e sfidave të identifikuar në praktikën gjyqësore.

Për më tepër, këto konkluzione kanë shërbyer edhe si bazë për zhvillimin e materialeve profesionale dhe publikimeve të Akademisë, duke kontribuar në shpërndarjen e praktikave të mira dhe në rritjen e qasjes në burime juridike për komunitetin ligjor.

Në tërësi, kjo qasje ka kontribuar në:

- ✓ rritjen e koherencës në vendimmarrje gjyqësore;
- ✓ përmirësimin e cilësisë së arsytimit gjyqësor;
- ✓ forcimin e lidhjes ndërmjet trajnimit dhe praktikës;
- ✓ si dhe në konsolidimin e rolit të Akademisë së Drejtësisë si një aktor aktiv në procesin e unifikimit të praktikës gjyqësore në Republikën e Kosovës.

6.4.4 Zbatimi i veprimtarisë botuese si dhe ofrimi i burimeve ligjore për përfituesit AD-së

Gjatë periudhës raportuese, Akademia e Drejtësisë ka vazhduar zhvillimin e veprimtarisë së saj botuese dhe ofrimin e burimeve juridike për përfituesit, duke e orientuar këtë aktivitet drejt mbështetjes praktike të sistemit gjyqësor dhe prokurorial, si dhe forcimit të cilësisë së vendimmarrjes.

Në fillim të vitit, fokusi kryesor ka qenë në përgatitjen, shqyrtimin dhe publikimin e Raportit Vjetor të Punës dhe Performancës për vitin 2024, i cili, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi, është miratuar nga Këshilli Drejtues dhe publikuar në faqen zyrtare të Akademisë.

Në vijim, një komponent i rëndësishëm i veprimtarisë botuese ka qenë zhvillimi i moduleve trajnuese në kuadër të programeve të trajnimit fillestar për gjyqtarët e sapoemëruar (gjeneratat XIII dhe XIV) dhe prokurorët e sapoemëruar (gjenerata XI), duke siguruar përmbajtje të strukturuar dhe të përshtatur për nevojat e këtyre kategorive.

Sa i përket botimeve për nevojat e sistemit gjyqësor dhe prokurorial, gjatë vitit 2025 është publikuar në faqen e Akademisë dhe në bibliotekën elektronike botimi “Drejtësia Mjedisore”, i realizuar në bashkëpunim me autorët dhe me mbështetjen e UNDP-së. Publikimi i këtij botimi është mundësuar përmes nënshkrimit të memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Akademisë, autorëve dhe UNDP-së.

Në kuadër të botimeve profesionale është realizuar edhe publikimi i punimit me temë “Aspekte të rëndësishme të së drejtës penale”, i miratuar nga Këshilli Drejtues dhe i shpërndarë për profesionistët ligjorë, me fokus të veçantë tek bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarët ligjor të gjykatave dhe prokurorive.

Gjithashtu, në kuadër të bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë, Akademia ka përfituar nga mbështetja e UNODC-së një numër të konsiderueshëm kopje botimesh të autorëve nga Gjykata Supreme, që trajtojnë çështje të rëndësishme si:

- veprat penale që lidhen me armët;
- masat e veçanta hetimore;
- si dhe përmbledhje të praktikës gjyqësore në këtë fushë.

Këto botime janë shpërndarë në mënyrë proporcionale për gjyqtarë dhe prokurorë, si dhe në bibliotekat e institucioneve të sistemit të drejtësisë, duke kontribuar në rritjen e qasjes në literaturë juridike cilësore.

Në fund të vitit janë realizuar edhe botime me rëndësi të veçantë për praktikën gjyqësore, përfshirë:

- përmbledhjet e praktikës së Gjykatës Supreme në çështje penale dhe civile;
- vendimet e përzgjedhura të kësaj gjykate;
- si dhe Udhëzuesi për provat elektronike.

Këto botime janë publikuar dhe shpërndarë për përfituesit e sistemit, duke kontribuar drejtpërdrejt në unifikimin e praktikës gjyqësore dhe në ngritjen e cilësisë profesionale.

Përveç veprimtarisë botuese, Akademia e Drejtësisë vazhdon të ofrojë edhe bibliotekën ligjore elektronike, e cila është në shërbim të përfituesve të saj sipas ligjit. Megjithatë, gjatë periudhës raportuese nuk është evidentuar një shfrytëzim i theksuar i këtyre burimeve, si dhe nuk ka pasur zhvillime të reja në zgjerimin e qasjes në databaza ndërkombëtare.

Në tërësi, veprimtaria botuese gjatë vitit 2025 ka kontribuar në:

- ✓ rritjen e qasjes në burime juridike cilësore;
- ✓ mbështetjen e praktikës gjyqësore dhe prokuroriale;
- ✓ dhe forcimin e rolit të Akademisë së Drejtësisë si një qendër e rëndësishme e zhvillimit dhe shpërndarjes së njohurive juridike.

6.4.5 Planifikimi institucional në zbatim të masave dhe politikave euro integruese

Gjatë periudhës raportuese, Akademia e Drejtësisë ka vazhduar përkushtimin e saj në zbatimin e masave dhe kërkesave që rrjedhin nga dokumentet strategjike në nivel nacional dhe ndërkombëtar, me theks të veçantë në procesin e integritimit evropian dhe harmonizimin me standardet e Bashkimit Evropian.

Në këtë kuadër, Akademia ka kontribuar në mënyrë aktive në procesin e raportimit për Komisionin Evropian, duke ofruar inpute për periudhat raportuese shtator 2024 – mars 2025 dhe prill – gusht 2025. Këto inpute kanë përfshirë të dhëna dhe analiza lidhur me:

- ❖ trajnimet në fushën e së drejtës së BE-së dhe pjesëmarrjen në to;
- ❖ zhvillimin e shkathtësive digjitale dhe kompjuterike të përfituesve;
- ❖ trajnimet për menaxhimin e gjykatave dhe kapacitetet institucionale;
- ❖ trajnimet e specializuara dhe ndikimin e tyre në praktikë;
- ❖ zbatimin e Programit për Trajnime të Vazhdueshme (PTV) dhe Programit për Trajnime Fillestare (PTF);
- ❖ si dhe çështje që lidhen me burimet financiare dhe mekanizmat për vlerësimin e nevojave trajnuese.

Përveç kësaj, Akademia ka përgatitur edhe raportimin në kuadër të CEPEJ për vitin 2024, duke ofruar të dhëna të detajuara mbi:

- trajnimet fillestare dhe të vazhdueshme;
- kohëzgjatjen dhe frekuencën e tyre;
- mekanizmat për vlerësimin e cilësisë së trajnimeve;
- si dhe indikatorë të tjerë relevantë për matjen e kapaciteteve trajnuese në përputhje me standardet evropiane.

Në funksion të zbatimit të dokumenteve strategjike vendore, gjatë vitit 2025 Akademia e Drejtësisë ka realizuar një sërë aktivitesh trajnuese që kontribuojnë drejtpërdrejt në përmbushjen e objektivave të këtyre dokumenteve.

Në kuadër të Strategjisë për Sundimin e Ligjit, janë realizuar trajnime në fusha kyçe si:

- drejtësia administrative, në funksion të zbatimit të ligjit të ri për konfliktet administrative;
- drejtësia komerciale;
- drejtësia për fëmijë;
- hetimi dhe gjykimi i krimeve të luftës;
- konfiskimi dhe kompetencat e zgjeruara;
- si dhe ndërmjetësimi në sistemin gjyqësor dhe prokurorial.

Në kuadër të Agjendës Evropiane dhe bashkëpunimit me ERA, janë realizuar aktivitete trajnuese që lidhen me:

- konfiskimin dhe sekuestrimin;

- hetimet financiare, shpëlarjen e parave dhe krimin e organizuar.

Në kuadër të Strategjisë për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave, janë realizuar aktivitete trajnuese të dedikuara për:

- trajtimin e dhunës ndaj grave;
- dhunën në familje;
- dhe dhunën me bazë gjinore.

Gjithashtu, në përmbushje të Planit Kombëtar për të Drejtat e Njeriut, janë realizuar trajnime që kanë adresuar:

- standardet evropiane për mbrojtjen e reputacionit, shpifjen dhe paditë SLAPP;
- zbatimin e neneve 5, 6 dhe 13 të KEDNJ-së dhe jurisprudencës së GJEDNJ-së;
- mbrojtjen nga dhuna në familje;
- si dhe çështjet e kundër diskriminimit.

Pasqyra e detajuar e aktiviteteve të realizuara sipas dokumenteve strategjike paraqitet në tabelën në vijim.

Aktivitete të realizuara në periudhën janar-dhjetor 2025 sipas kërkesave nga dokumentet strategjike	
Aktivitete në përmbushje të Strategjisë për sundimin e ligjit	
Trajnime	Numri
Trajnime në fushën administrative si rezultat i ligjit të ri për konfliktet administrative	7
Trajnime në fushën komerciale	13
Për drejtësinë për fëmijë	5
Trajnime me fokus në hetimin dhe gjykimin e krimeve të luftës	3
Trajnime për kompetencat e zgjeruara të konfiskimit	1
Ndërmjetësimi për zyrtarët e ndërmjetësimit në gjykata dhe prokurori	1
PKIE & Agjenda Evropiane (ERA)	
Trajnime	Numri
Trajnime për konfiskimin dhe sekuestrimin	1
Hetimet financiare, shpëlarja e parave dhe veprat tjera të krimit të organizuar	3
Aktivitete në përmbushje të Strategjisë për mbrojtjen nga dhuna në familje	
Trajnime	Numri
Dhuna ndaj Grave, Dhuna në Familje dhe Dhuna në Bazë Gjinore	5
Trajnim Standardet Evropiane: Mbrojtja e Reputacionit, Shpifja dhe Paditë SLAPP si dhe trajnime për nenin 5, 6, 13 dhe për praktikën e GGJEDNJ-së	6
Për mbrojtjen nga Dhuna në familje	5
Kundër diskriminimit	2

Tabelë 13: Masat dhe kërkesat nga dokumentet tjera strategjike

6.5 AVANCIMI I MËTEJMË I METODOLOGJISË TRAJNUESE

Gjatë vitit 2025, Akademia e Drejtësisë ka vazhduar të avancojë metodologjinë trajnuese si një komponent kyç për sigurimin e cilësisë dhe efektivitetit të programeve trajnuese, duke e orientuar këtë proces drejt zbatimit të standardeve bashkëkohore të mësimin për të rritur dhe përmirësimit të vazhdueshëm të praktikave trajnuese.

Një ndër aktivitetet kryesore ka qenë organizimi i programit të trajnimit për trajnuesit, i cili ka pasur për qëllim fuqizimin e kapaciteteve profesionale të tyre për zbatimin efektiv të metodologjisë trajnuese të Akademisë së Drejtësisë.

Ky trajnim është bazuar në Doracakun për Trajnues të AD-së dhe është fokusuar në zhvillimin e aftësive praktike për facilitimin e procesit të të nxënimit, komunikimin aktiv me pjesëmarrësit,

përdorimin funksional të mjeteve dhe teknologjisë në trajnim, si dhe në thellimin e njohurive profesionale në fushat përkatëse të specializimit.

Në këtë aktivitet kanë marrë pjesë gjithsej 20 trajnues, prej të cilëve 10 trajnues nga lista e trajnereve të Akademisë së Drejtësisë dhe 10 pjesëmarrës nga stafi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, duke reflektuar një qasje të përbashkët institucionale për ngritjen e kapaciteteve trajnuese në sistemin e drejtësisë.

Trajnimi i Trajnuesve -2025			
Fusha e trajnimit	Nr. i trajnimeve	Ditë trajnimi	Nr. i të trajnuarve
Metodologjia e sipas Doracakut për Trajnues të AD-së	1	2	20
Totali	1	2	20

Tabela X. Trajnimi i Trajnuesve – 2025

Zbatimi i këtij programi ka kontribuar drejtpërdrejt në përmirësimin e mënyrës së zhvillimit të trajnimeve, duke forcuar ndërlidhjen ndërmjet metodologjisë dhe cilësisë së procesit trajnuese. Në veçanti, është vërejtur një orientim më i theksuar drejt përdorimit të metodave interaktive, përfshirjes aktive të pjesëmarrësve dhe aplikimit të rasteve praktike gjatë sesioneve trajnuese.

Në këtë drejtim, metodologjia trajnuese nuk është zbatuar vetëm si një standard formal, por si një instrument praktik që ka ndikuar drejtpërdrejt në mënyrën e të nxëniet dhe në përvetësimin e njohurive nga përfituesit e trajnimeve. Trajnimet janë zhvilluar në mënyrë më dinamike dhe të orientuar drejt zgjidhjes së problemeve konkrete, duke mundur ndërlidhjen e drejtpërdrejtë ndërmjet teorisë dhe praktikës gjyqësore dhe prokuroriale.

Si rezultat i këtij avancimi metodologjik, gjatë vitit 2025 është evidentuar përmirësim i dukshëm në cilësinë e trajnimeve, i reflektuar në:

- rritjen e interaktivitetit gjatë sesioneve trajnuese;
- përfshirjen më të madhe të pjesëmarrësve;
- dhe aftësinë e tyre për të aplikuar njohuritë e përfituara në praktikë.

Po ashtu, është përmirësuar performanca e trajnuesve në drejtim të përdorimit të teknikave të mësimin për të rritur dhe menaxhimit efektiv të sesioneve trajnuese.

Në aspektin më të gjerë institucional, ky zhvillim ka kontribuar në forcimin e lidhjes ndërmjet programeve trajnuese dhe rezultateve të pritura në sistemin e drejtësisë, duke ndikuar në përmirësimin e cilësisë së vendimmarrjes dhe në rritjen e profesionalizmit të përfituesve të trajnimeve.

Në tërësi, avancimi i metodologjisë trajnuese gjatë vitit 2025 ka shërbyer si një mekanizëm i rëndësishëm për përmbushjen e objektivave të Akademisë së Drejtësisë, duke siguruar që trajnimet të jenë jo vetëm të strukturuar dhe cilësore, por edhe të orientuara drejt rezultateve konkrete dhe ndikimit në praktikë.

6.6 BASHKËPUNIMI DHE KOORDINIMI ME PARTNERËT VENDOR, PARTNERËT NDËRKOMBËTARË, DONATORËT DHE INSTITUCIONET RELEVANTE TRAJNUESE NDËRKOMBËTARE.

Gjatë periudhës raportuese, Akademia e Drejtësisë ka vazhduar të forcojë dhe zhvillojë bashkëpunimin dhe koordinimin me partnerët vendor dhe ndërkombëtarë, duke e konsideruar këtë dimension si një komponent thelbësor për përmbushjen efektive të mandatit të saj ligjor dhe për avancimin e cilësisë së programeve trajnuese.

Në këtë drejtim, bashkëpunimi institucional është zhvilluar jo vetëm në funksion të realizimit të aktiviteteve të përbashkëta, por edhe si një mekanizëm i rëndësishëm për identifikimin e nevojave të sistemit të drejtësisë, përshtatjen e programeve trajnuese dhe integrimin e standardeve dhe praktikave më të mira ndërkombëtare.

Akademia ka përcjellë në mënyrë të vazhdueshme zhvillimet në sistemin gjyqësor dhe prokurorial, duke adresuar kërkesat dhe prioritetet e institucioneve përkatëse përmes një komunikimi të rregullt dhe të strukturuar me partnerët strategjikë. Në këtë kuadër, janë zhvilluar takime të rregullta me krerët e sistemit gjyqësor dhe prokurorial, si dhe me partnerë të tjerë institucionalë dhe ndërkombëtarë, të cilat kanë shërbyer si platformë për koordinim, planifikim dhe harmonizim të aktiviteteve trajnuese.

Si rezultat i këtij bashkëpunimi, Akademia ka përfituar mbështetje të konsiderueshme në organizimin dhe realizimin e trajnimeve, punëtorive dhe tryezave profesionale, si dhe në pjesëmarrjen në konferenca dhe forume ndërkombëtare, duke kontribuar në ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe në forcimin e rolit të saj në sistemin e drejtësisë.

Në këtë kontekst, bashkëpunimi me partnerët vendor dhe ndërkombëtarë ka ndikuar drejtpërdrejt në:

- ❖ rritjen e cilësisë dhe diversitetit të programeve trajnuese;
- ❖ integrimin e standardeve evropiane dhe praktikave më të mira ndërkombëtare;
- ❖ dhe përmbushjen më efektive të objektivave strategjike të Akademisë për vitin 2025.

Në vijim të këtij kapitulli paraqiten në mënyrë të detajuar format e bashkëpunimit me partnerët kryesorë, aktivitetet e realizuara dhe kontributi i tyre në zhvillimin institucional dhe profesional të Akademisë së Drejtësisë.

6.6.1 Bashkëpunimi dhe koordinimi me KGJK dhe KPK si dhe me Gjykatat dhe Prokuroritë e Kosovës

Gjatë vitit 2025, Akademia e Drejtësisë ka zhvilluar një bashkëpunim të ngushtë dhe të strukturuar me Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK), Këshillin Prokurorial të Kosovës (KPK), si dhe me gjykatat dhe prokuroritë në të gjitha nivelet, duke e konsideruar këtë bashkëpunim si themelor për realizimin efektiv të mandatit të saj ligjor dhe për zhvillimin e kapaciteteve profesionale në sistemin e drejtësisë.

Në veçanti, tremujori i parë i vitit 2025 është karakterizuar me një dinamikë të shtuar të aktiviteteve, e lidhur drejtpërdrejt me trajnimin e gjeneratave të reja të gjyqtarëve, prokurorëve dhe stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial. Në këtë kontekst, Akademia ka bashkëpunuar ngushtë me KGJK dhe KPK, si dhe me Kryetarët e Gjykatave dhe Kryeprokurorët e Prokurorive, duke siguruar koordinim të vazhdueshëm në identifikimin e nevojave trajnuese dhe planifikimin e aktiviteteve përkatëse.

Ky bashkëpunim, i zhvilluar në kuadër të përgjegjësive të përcaktuara me ligj, ka mundësuar reagim të shpejtë dhe efektiv ndaj kërkesave të institucioneve të sistemit të drejtësisë, duke siguruar organizimin dhe realizimin e trajnimeve në përputhje me nevojat konkrete.

Në aspektin funksional, bashkëpunimi ka siguruar një ndërlidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet:

- ❖ nevojave reale të sistemit gjyqësor dhe prokurorial;
- ❖ përmbajtjes dhe strukturës së programeve trajnuese;
- ❖ dhe zbatimit praktik të trajnimeve.

Si rezultat, trajnimet kanë qenë më të targëtuara, më relevante dhe të orientuara drejt adresimit të sfidave konkrete të praktikës.

Gjithashtu, koordinimi i vazhdueshëm ka kontribuar në rritjen e efikasitetit të procesit trajnuese, përmes planifikimit më të mirë të aktiviteteve dhe shfrytëzimit optimal të burimeve institucionale.

Në tërësi, bashkëpunimi me KGJK, KPK, gjykatat dhe prokuroritë gjatë vitit 2025 ka ndikuar drejtpërdrejt në përmbushjen e objektivave të Akademisë së Drejtësisë, duke forcuar rolin e saj si institucion kyç në zhvillimin profesional të sistemit të drejtësisë në Republikën e Kosovës.

6.6.2 Bashkëpunimi dhe koordinimi me institucionet e tjera të sistemit të drejtësisë

Gjatë periudhës raportuese, Akademia e Drejtësisë ka zhvilluar një bashkëpunim të gjerë dhe të strukturuar me institucionet e tjera të sistemit të drejtësisë, duke kontribuar në proceset reformuese, zhvillimin e kornizës ligjore dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale ndërinstitutionale.

Në këtë drejtim, Akademia ka qenë pjesë aktive e grupeve punuese të themeluara nga Ministria e Drejtësisë, të cilat kanë pasur për qëllim hartimin dhe kompletimin e akteve nënligjore, si dhe planifikimin dhe zbatimin e masave që rrjedhin nga Strategjia për Sundimin e Ligjit dhe Strategjia për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave. Përfshirja në këto procese ka mundësuar që Akademia të kontribuojë me ekspertizën e saj, duke siguruar që politikat dhe masat e parapara të mbështeten me programe adekuate trajnuese.

Në funksion të zgjerimit të bashkëpunimit institucional, Akademia ka arritur marrëveshje bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë dhe Odën e Ndërmjetësuesve, duke mundësuar ofrimin e trajnimeve të vazhdueshme për ndërmjetësuesit e licencuar dhe duke kontribuar në forcimin e mekanizmave alternativë të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve.

Paralelisht, Akademia ka bashkëpunuar me një gamë të gjerë institucionesh, përfshirë Gjykatën Kushtetuese, Institucionin e Avokatit të Popullit, Inspektoratin e Policisë së Kosovës, Policinë e Kosovës, Shërbimin Sprovues, Shërbimin Korrektues, Doganën e Kosovës, Agjencinë për Informim dhe Privatësi dhe Institutin e Mjekësisë Ligjore. Ky bashkëpunim ka qenë veçanërisht i rëndësishëm në kuadër të realizimit të trajnimeve praktike për gjyqtarët dhe prokurorët e sapoemëruar.

Po ashtu, Akademia ka bashkëpunuar me Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit në zbatimin e Planit të Integritetit dhe kërkesave që rrjedhin nga Ligji për Parandalimin e Korrupsionit, duke kontribuar në forcimin e standardeve të integritetit institucional.

Analiza e këtij bashkëpunimi tregon se ai ka qenë i orientuar jo vetëm në realizimin e aktiviteteve të përbashkëta, por edhe në krijimin e një qasjeje të koordinuar për zhvillimin e kapaciteteve në të gjithë sistemin e drejtësisë.

Rezultatet e arritura përfshijnë:

- ❖ përfshirjen aktive në proceset e hartimit dhe zbatimit të politikave publike;
- ❖ rritjen e relevancës së programeve trajnuese;
- ❖ përmirësimin e komponentit praktik të trajnimeve;
- ❖ dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitutional.

Në tërësi, bashkëpunimi me institucionet e tjera gjatë vitit 2025 ka kontribuar në përmbushjen e objektivave të Akademisë së Drejtësisë, duke forcuar rolin e saj si institucion kyç në zhvillimin profesional dhe në mbështetjen e proceseve reformuese në sistemin e drejtësisë.

6.6.3 Bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë në zbatimin e trajnimeve dhe aktiviteteve tjera

Gjatë vitit 2025, Akademia e Drejtësisë ka vazhduar të konsolidojë dhe zgjerojë bashkëpunimin me partnerët ndërkombëtarë dhe donatorët, duke e konsideruar këtë dimension si një element kyç për avancimin e cilësisë së programeve trajnuese dhe për harmonizimin e tyre me standardet dhe praktikat më të mira evropiane dhe ndërkombëtare.

Në këtë drejtim, bashkëpunimi ndërkombëtar nuk është kufizuar vetëm në mbështetje financiare apo teknike, por ka shërbyer si një mekanizëm i rëndësishëm për transferimin e njohurive, shkëmbimin e përvojave dhe zhvillimin e kapaciteteve profesionale në sistemin e drejtësisë.

Gjatë periudhës raportuese, Akademia ka bashkëpunuar me një numër të konsiderueshëm partnerësh dhe projektsh ndërkombëtare, përfshirë GIZ, Këshillin e Evropës dhe projektet e tij relevante, CEPEJ, IRZ, OSBE, UNDP, UNHCR, UNODC, si dhe organizata dhe iniciativa të tjera rajonale dhe ndërkombëtare si WBROLI, GLPS, KOMF, Terre des hommes, BIRN dhe partnerë të tjerë institucionalë dhe akademikë.

Ky bashkëpunim është reflektuar në mbështetjen e drejtpërdrejtë të programeve trajnuese dhe aktiviteteve profesionale të Akademisë, duke mundësuar trajtimin e temave të specializuara dhe komplekse që lidhen me zhvillimet bashkëkohore në sistemin e drejtësisë, si:

- ❖ të drejtat e njeriut dhe zbatimi i standardeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- ❖ dhuna në familje dhe dhuna me bazë gjinore;
- ❖ krimi i organizuar, hetimet financiare dhe konfiskimi i pasurisë;
- ❖ drejtësia për fëmijë;
- ❖ krimi kibernetik dhe siguria digjitale;
- ❖ si dhe çështje të ndërlidhura me acquis të Bashkimit Evropian.

Në veçanti, projektet që lidhen me përafrimin e legjislacionit dhe politikave me standardet ndërkombëtare dhe iniciativat për sundimin e ligjit në rajon kanë kontribuar në forcimin e dimensionit evropian të programeve trajnuese të Akademisë.

Analiza e këtij bashkëpunimi tregon se ai ka qenë i orientuar në mënyrë të qartë drejt përmbushjes së nevojave konkrete të sistemit të drejtësisë, duke tejkaluar qasjen formale të realizimit të aktiviteteve.

Nëpërmjet këtij bashkëpunimi, Akademia ka arritur të integrojë përmbajtje dhe qasje të avancuara në programet e saj trajnuese, duke rritur ndjeshëm cilësinë dhe diversitetin e tyre.

Rezultatet e arritura përfshijnë:

- zgjerimin e gamës së trajnimeve në fusha të specializuara dhe prioritare;
- rritjen e kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve në përputhje me standardet ndërkombëtare;
- integrimin e praktikave më të mira evropiane në përmbajtjen trajnuese;
- si dhe rritjen e ekspozimit ndërkombëtar të Akademisë dhe përfituesve të saj.

Në aspektin institucional, ky bashkëpunim ka kontribuar gjithashtu në forcimin e rolit të Akademisë së Drejtësisë si një partner i besueshëm për organizatat ndërkombëtare dhe donatorët, duke krijuar bazë për zhvillimin e mëtejshëm të projekteve dhe iniciativave të përbashkëta.

Në tërësi, bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë gjatë vitit 2025 ka pasur ndikim të drejtpërdrejtë në përmbushjen e objektivave të Akademisë, duke mbështetur zhvillimin profesional të përfituesve, përmirësimin e cilësisë së trajnimeve dhe avancimin e standardeve të sistemit të drejtësisë në përputhje me praktikën evropiane.

6.6.4 Bashkëpunimi me Këshillin e Evropës dhe projektet e tij

Gjatë vitit 2025, bashkëpunimi i Akademisë së Drejtësisë me Këshillin e Evropës ka qenë ndër komponentët më të rëndësishëm të dimensionit ndërkombëtar të aktiviteteve trajnuese, duke kontribuar drejtpërdrejt në avancimin e standardeve të të drejtave të njeriut dhe përafrimin e praktikës gjyqësore me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Ky bashkëpunim është zhvilluar përmes projekteve dhe iniciativave konkrete që kanë mbështetur zhvillimin dhe realizimin e aktiviteteve trajnuese në fusha të ndjeshme dhe prioritare për sistemin e drejtësisë.

Në veçanti:

- ✓ në kuadër të projektit “Përafrimi i ligjeve dhe politikave me Konventën e Stambollit” janë realizuar katër trajnime dhe një konferencë;
- ✓ përmes projektit “Mbështetja e Gjykatës Kushtetuese në zbatimin dhe shpërndarjen e standardeve të GJEDNJ-së” janë realizuar pesë aktivitete trajnuese;
- ✓ si dhe janë realizuar aktivitete specifike përmes projekteve CYBERKOP, PRO-FREX dhe CEPEJ.

Ky bashkëpunim ka qenë i orientuar qartë drejt:

- ❖ forcimit të mbrojtjes së të drejtave të njeriut;
- ❖ rritjes së ndjeshmërisë ndaj barazisë gjinore dhe dhunës në familje;
- ❖ integritimit të jurisprudencës së GJEDNJ-së në praktikën gjyqësore.

Si rezultat, është krijuar një ndërlidhje e fortë ndërmjet programeve trajnuese dhe standardeve evropiane.

Bashkëpunimi me Këshillin e Evropës ka ndikuar drejtpërdrejt në ngritjen e cilësisë së trajnimeve dhe harmonizimin e tyre me standardet evropiane.

6.6.4.1 Punëtorja ndërkombëtare për luftimin e veprave penale të narkotikëve

Gjatë vitit 2025, Akademia e Drejtësisë ka qenë nikoqire e një punëtorie ndërkombëtare për luftimin e veprave penale të narkotikëve, e realizuar me mbështetjen e TIKA-s dhe në bashkëpunim me Akademinë e Drejtësisë së Turqisë dhe Shkollën e Magjistraturës së Shqipërisë.

Qëllimi i këtij aktiviteti ka qenë forcimi i bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar, si dhe avancimi i kapaciteteve profesionale përmes shkëmbimit të praktikave më të mira.

Gjatë punëtorisë janë trajtuar:

- hetimi dhe ndjekja e veprave penale të narkotikëve;
- sfidat aktuale në këtë fushë;
- qasjet bashkëkohore në gjykim.

Delegacionet pjesëmarrëse realizuan gjithashtu vizita në institucionet kryesore të drejtësisë në Kosovë, duke kontribuar në thellimin e bashkëpunimit ndërinstitucional.

Ky aktivitet ka tejkaluar dimensionin e një trajnime klasik, duke shërbyer si platformë për:

koordinim rajonal, harmonizim të qasjeve profesionale dhe integrim të praktikave ndërkombëtare.

Punëtorja ka kontribuar ndjeshëm në luftimin e krimit të organizuar dhe në forcimin e rolit ndërkombëtar të Akademisë së Drejtësisë.

6.6.4.2 Projekti i KE -Qasja e grave në drejtësi (Women Access to Justice)

Në kuadër të bashkëpunimit me Këshillin e Evropës, gjatë vitit 2025 është realizuar një aktivitet trajnues në Budapest, në kuadër të projektit rajonal Qasja e Grave në Drejtësi “Women Access to Justice”, pjesë e “Horizontal Facility III”.

Ky trajnim ka synuar forcimin e kapaciteteve profesionale për promovimin e qasjes së barabartë të grave në drejtësi dhe eliminimin e barrierave gjinore në sistem.

Programi ka qenë i orientuar në:

- zhvillimin e mentorëve në sistemin e drejtësisë;
- promovimin e praktikave të ndjeshme ndaj gjinisë;
- forcimin e përgjegjshmërisë institucionale.

Në këtë aktivitet kanë marrë pjesë 4 përfaqësues nga Kosova, dhe ka kontribuar në integrimin e perspektivës gjinore në drejtësi, rritjen e ndërgjegjësimit për barrierat gjinore, si dhe forcimin e rolit të profesionistëve si promotorë të barazisë.

Ky aktivitet përfaqëson një hap të rëndësishëm në promovimin e barazisë gjinore dhe në përmbushjen e standardeve ndërkombëtare të drejtësisë.

6.6.4.3 Aktivitetet e realizuara me GIZ

Gjatë vitit 2025, Akademia e Drejtësisë ka vazhduar bashkëpunimin me GIZ, përmes të cilit janë realizuar gjithsej njëmbëdhjetë (11) aktivitete trajnuese, të orientuara kryesisht në forcimin e kapaciteteve profesionale të stafit mbështetës në sistemin e drejtësisë.

Në kuadër të këtij bashkëpunimi është organizuar një tryezë ndërinstitucionale ndërmjet inspektorateve të nivelit qendror dhe prokurorive të Republikës së Kosovës, e cila ka shërbyer si platformë për diskutim dhe koordinim ndërinstitucional në trajtimin e çështjeve të përbashkëta.

Gjithashtu, janë realizuar dhjetë (10) trajnime në kuadër të moduleve bazike nga fusha penale dhe civile, të cilat u janë dedikuar bashkëpunëtorëve profesional të gjykatave dhe prokurorive, si dhe zyrtarëve të ndihmës juridike falas.

Ky bashkëpunim ka qenë i orientuar në mënyrë të qartë drejt forcimit të kapaciteteve të stafit profesional mbështetës, i cili luan një rol të rëndësishëm në funksionimin efikas të sistemit gjyqësor dhe prokurorial.

Përmes këtyre aktiviteteve është siguruar një ndërlidhje më e mirë ndërmjet praktikës institucionale dhe zhvillimit profesional, duke kontribuar në rritjen e cilësisë së punës në nivel operativ.

Bashkëpunimi me GIZ ka kontribuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në përmirësimin e kapaciteteve profesionale dhe në rritjen e efikasitetit të sistemit të drejtësisë, veçanërisht në nivelin e stafit mbështetës.

6.6.4.5 Aktivitetet e realizuara me Fondin për të Drejtën Humanitare në Kosovë

Në kuadër të bashkëpunimit me Fondin për të Drejtën Humanitare në Kosovë, gjatë vitit 2025 janë realizuar dy aktivitete trajnuese të fokusuara në trajtimin e krimeve të luftës, si një nga fushat më komplekse dhe sfiduese për sistemin e drejtësisë.

Këto aktivitete kanë qenë pjesë integrale e Programit për Trajnime të Vazhdueshme dhe janë orientuar veçanërisht drejt gjyqtarëve të departamenteve speciale dhe prokurorëve të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës.

Duke marrë parasysh kompleksitetin dhe ndjeshmërinë e rasteve të krimeve të luftës, si dhe mungesën relative të përvojës praktike në trajtimin e tyre, këto trajnime kanë pasur një rëndësi të veçantë në ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe në përmirësimin e qasjes ndaj këtyre rasteve.

Ky bashkëpunim ka reflektuar nevojën për specializim të vazhdueshëm në fusha të caktuara të drejtësisë.

Ky bashkëpunim ka kontribuar në forcimin e dimensionit profesional dhe specializues të trajnimeve, duke mbështetur trajtimin më efikas dhe të standardizuar të krimeve të luftës në Kosovë.

6.6.4.6 Aktivitetet e realizuara me Koalicionin e OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve (KOMF)

Gjatë vitit 2025, në kuadër të bashkëpunimit me Koalicionin e OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve (KOMF), Akademia e Drejtësisë ka realizuar aktivitete trajnuese në fushën e drejtësisë për fëmijë, të cilat kanë adresuar çështje të rëndësishme që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Trajnimet janë fokusuar në tema specifike si mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në rastet e shkurorëzimit dhe mbrojtja gjyqësore e të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror.

Ky bashkëpunim ka qenë në përputhje me prioritetet e sistemit të drejtësisë në fushën e mbrojtjes së fëmijëve dhe me obligimet që rrjedhin nga instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve. Trajnimet kanë kontribuar në zhvillimin e një qasjeje më të ndjeshme dhe të specializuar ndaj çështjeve që lidhen me të miturit.

Bashkëpunimi me KOMF ka kontribuar në avancimin e drejtësisë për fëmijë dhe në forcimin e mbrojtjes së të drejtave të tyre në sistemin e drejtësisë.

6.6.4.7 Aktivitetet e realizuara me Terre des Hommes

Në kuadër të bashkëpunimit me organizatën Terre des Hommes, gjatë vitit 2025 është realizuar një trajnim i fokusuar në luftimin e diskriminimit, me theks të veçantë në antigjipsizëm.

Ky trajnim ka adresuar çështje të rëndësishme që lidhen me diskriminimin ndaj komuniteteve të marginalizuara, duke synuar ngritjen e kapaciteteve profesionale për trajtimin e këtyre rasteve në mënyrë të drejtë dhe të barabartë.

Ky aktivitet ka qenë në përputhje me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe me obligimet që rrjedhin nga legjislacioni vendor për luftimin e diskriminimit.

Trajnimi ka kontribuar në integrimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në praktikën gjyqësore dhe prokuroriale.

Bashkëpunimi me Terre des Hommes ka kontribuar në promovimin e parimeve të barazisë dhe mosdiskriminimit, duke forcuar dimensionin e të drejtave të njeriut në programet trajnuese të Akademisë.

6.6.4.8 Aktivitetet e realizuara me OSBE

Gjatë vitit 2025, në kuadër të bashkëpunimit me OSBE-në, Akademia e Drejtësisë ka realizuar katër (4) aktivitete trajnuese, të cilat kanë kontribuar në ngritjen e kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve të tjerë ligjor në sistemin e drejtësisë.

Trajnimet janë fokusuar në tema me rëndësi të veçantë për praktikën gjyqësore dhe prokuroriale, përfshirë artikullimin dhe mbështetjen e aktakuzave dhe vendimeve gjyqësore (shkrimi ligjor), etikën profesionale për gjyqtarë, hartimin dhe arsyetimin e vendimeve gjyqësore, si dhe procedurën penale për kryerësit me çrregullime mendore.

Ky bashkëpunim ka qenë i orientuar në përmirësimin e cilësisë së vendimmarrjes dhe në forcimin e standardeve profesionale në sistemin e drejtësisë.

Trajnimet kanë adresuar drejtpërdrejt sfidat që lidhen me cilësinë e arsyetimit juridik, etikën profesionale dhe trajtimin e rasteve komplekse, duke ndikuar në përmirësimin e praktikës gjyqësore. Bashkëpunimi me OSBE ka kontribuar në ngritjen e standardeve profesionale dhe në përmirësimin e cilësisë së vendimmarrjes në sistemin e drejtësisë.

6.6.4.9 Aktivitetet e realizuara me projektin HAPE (BE)

Në kuadër të bashkëpunimit me projektin e Bashkimit Evropian “Programi i Punëve të Brendshme në Kosovë – HAPE”, gjatë vitit 2025 janë realizuar dy aktivitete trajnuese të fokusuara në trajtimin e krimeve ekonomike dhe zbatimin e masave të veçanta hetimore.

Këto trajnime kanë synuar forcimin e kapaciteteve profesionale për hetimin dhe ndjekjen e veprave komplekse penale, duke përfshirë aspektet praktike dhe procedurale të këtyre proceseve.

Ky bashkëpunim është në përputhje me prioritetet strategjike për luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit, si dhe me kërkesat që rrjedhin nga procesi i integritetit evropian.

Trajnimet kanë kontribuar në zhvillimin e kapaciteteve për trajtimin e rasteve të ndërlikuara financiare dhe në përdorimin efektiv të mjeteve hetimore.

Bashkëpunimi me projektin HAPE ka kontribuar në forcimin e kapaciteteve hetimore dhe në përmirësimin e efektivitetit të ndjekjes penale në Kosovë.

6.6.4.10 Aktivitetet e realizuara me IRZ

Në bashkëpunim me IRZ, gjatë vitit 2025 janë realizuar aktivitete trajnuese të fokusuar në çështje specifike dhe të ndjeshme të praktikës gjyqësore dhe prokuroriale, përfshirë mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në rastet e ndryshimit të statusit të tyre dhe trajtimin e dëshmitarëve të mbrojtur dhe dëshmitarëve bashkëpunues.

Këto trajnime kanë adresuar çështje komplekse që kërkojnë njohuri të avancuara dhe qasje të specializuara në trajtimin e rasteve.

Ky bashkëpunim ka kontribuar në forcimin e dimensionit të të drejtave të njeriut dhe në trajtimin e çështjeve sensitive në sistemin e drejtësisë.

Trajnimet kanë ndihmuar në zhvillimin e qasjeve profesionale dhe të standardizuara në trajtimin e kategorive të veçanta të rasteve.

Bashkëpunimi me IRZ ka kontribuar në avancimin e trajtimit profesional të çështjeve të ndjeshme dhe në forcimin e standardeve të drejtësisë në Kosovë.

6.6.4.11 Aktivitetet e realizuara me BIRN

Në kuadër të bashkëpunimit me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN), gjatë vitit 2025 është realizuar një trajnim i fokusuar në trajtimin e çështjeve që lidhen me ekstremizmin e dhunshëm, radikalizmin dhe terrorizmin.

Ky trajnim ka adresuar fenomenet bashkëkohore që paraqesin sfida për sistemin e drejtësisë, duke synuar rritjen e kapaciteteve profesionale për identifikimin dhe trajtimin e këtyre formave të kriminalitetit.

Ky bashkëpunim është në përputhje me prioritetet për sigurinë dhe sundimin e ligjit, duke adresuar çështje që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në stabilitetin dhe sigurinë publike.

Trajnimi ka kontribuar në rritjen e njohurive për fenomenet e ekstremizmit dhe në zhvillimin e qasjeve për trajtimin e tyre në kuadër të sistemit të drejtësisë.

Bashkëpunimi me BIRN ka kontribuar në adresimin e sfidave bashkëkohore të sigurisë dhe në forcimin e rolit të sistemit të drejtësisë në këtë drejtim.

6.6.4.12 Aktivitetet e realizuara me Shkollën e Magjistraturës së Shqipërisë

Në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Akademisë së Drejtësisë dhe Shkollës së Magjistraturës së Shqipërisë, gjatë vitit 2025 është realizuar një trajnim i përbashkët për gjyqtarë dhe prokurorë nga të dy vendet, i fokusuar në hetimin e veprës penale të pastrimit të parave dhe kompleksitetin e saj.

Trajnimi ka trajtuar aspekte të rëndësishme që lidhen me nivelin e provueshmërisë përpara gjykatës në lidhje me origjinën e pasurisë, vlerën e aktit të ekspertimit kontabël dhe standardet që duhet të ndiqen në caktimin e detyrave të ekspertëve.

Ky bashkëpunim ka kontribuar në forcimin e dimensionit rajonal të trajnimeve dhe në shkëmbimin e praktikave ndërmjet dy sistemeve të drejtësisë.

Trajnimi ka adresuar një nga fushat më komplekse të drejtësisë penale, duke rritur kapacitetet për trajtimin e rasteve të pastrimit të parave.

Ky bashkëpunim ka kontribuar në avancimin e kapaciteteve profesionale dhe në forcimin e bashkëpunimit rajonal në fushën e drejtësisë penale.

6.6.4.13 Aktivitetet e realizuara me UNDP

Gjatë periudhës raportuese, në bashkëpunim me UNDP, Akademia e Drejtësisë ka realizuar dy aktivitete trajnuese në fushën e krimeve të luftës, të cilat janë dedikuar gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve të tjerë ligjor.

Përveç mbështetjes në organizimin e trajnimeve, UNDP ka kontribuar edhe në veprimtarinë botuese të Akademisë, përmes mbështetjes së publikimit “Drejtësia Mjedisore”.

Ky bashkëpunim ka reflektuar një qasje të integruar që lidh zhvillimin profesional me krijimin e burimeve juridike, duke forcuar kështu bazën teorike dhe praktike të përfituesve.

Trajnimet dhe publikimet kanë kontribuar në ngritjen e cilësisë së trajtimit të rasteve penale komplekse.

Bashkëpunimi me UNDP ka kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm profesional dhe në përmirësimin e cilësisë së burimeve juridike në sistemin e drejtësisë.

6.6.4.14 Aktivitetet e realizuara me UNHCR/CRPK

Gjatë vitit 2025, në kuadër të bashkëpunimit me UNHCR dhe CRPK, janë realizuar aktivitete trajnuese të dedikuara gjyqtarëve të departamenteve administrative, me fokus në mbrojtjen ndërkombëtare dhe çështjet e shtetësisë.

Temat e trajtuara kanë përfshirë praktikën gjyqësore në vend dhe në Evropë në fushën e mbrojtjes ndërkombëtare të refugjatëve, sfidat në vendosjen meritorë të kërkesave për mbrojtje ndërkombëtare dhe shtetësi, si dhe rrezikun nga pa-shtetësia.

Ky bashkëpunim ka qenë i rëndësishëm për avancimin e kapaciteteve në një fushë shumë specifike dhe të ndjeshme të drejtësisë administrative.

Trajnimet kanë kontribuar në harmonizimin e praktikës vendore me standardet ndërkombëtare në fushën e refugjatëve dhe shtetësisë.

Bashkëpunimi me UNHCR/CRPK ka kontribuar në forcimin e drejtësisë administrative dhe në mbrojtjen më efektive të të drejtave të refugjatëve dhe personave pa shtetësi.

6.6.4.15 Aktivitetet e realizuara me UNODC

Gjatë vitit 2025, UNODC ka mbështetur Akademinë e Drejtësisë si në aspektin e zhvillimit të trajnimeve, ashtu edhe në veprimtarinë botuese, veçanërisht në fushën e luftimit të trafikimit të armëve të zjarrit.

Në këtë kuadër, janë zhvilluar aktivitete trajnuese dhe janë përgatitur tri botime dhe publikime të rëndësishme, të cilat janë vlerësuar si të domosdoshme për punën praktike të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Ky bashkëpunim ka reflektuar një qasje të integruar ndërmjet trajnimeve dhe zhvillimit të burimeve juridike, duke forcuar kapacitetet profesionale në trajtimin e çështjeve që lidhen me armët e zjarrit.

Aktivitetet kanë kontribuar në përmirësimin e njohurive dhe praktikës në një fushë me rëndësi të lartë për sigurinë publike.

Bashkëpunimi me UNODC ka kontribuar në forcimin e kapaciteteve profesionale dhe në zhvillimin e burimeve të specializuara juridike.

6.6.4.16 Aktivitetet e realizuara me GLPS dhe projektin WBROLI

Në kuadër të bashkëpunimit me Grupin për Studime Juridike dhe Politike (GLPS), gjatë vitit 2025 është realizuar një tryezë profesionale me temë praktikën gjyqësore në kontestet e sigurisë dhe

shëndetit në punë, duke adresuar çështje të rëndësishme që lidhen me të drejtat e punëmarrësve dhe përgjegjësitë ligjore të punëdhënësve.

Po ashtu, në bashkëpunim me projektin WBROLI është realizuar një trajnim i fokusuar në standardet evropiane për mbrojtjen e reputacionit, shpifjen dhe paditë SLAPP, me theks të veçantë në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Trajnimit ka trajtuar elemente kyçe si dallimi ndërmjet fakteve dhe opinioneve, niveli i mbrojtjes së reputacionit, si dhe përgjegjësia ligjore në rastet e shpifjes, duke u fokusuar në standardet e zhvilluara nga GjEDNj.

Ky bashkëpunim ka kontribuar në avancimin e njohurive në fusha të rëndësishme që lidhen me të drejtat e njeriut dhe standardet evropiane.

Trajnimet kanë ndikuar në harmonizimin e praktikës gjyqësore me jurisprudencën evropiane dhe në forcimin e mbrojtjes së të drejtave themelore.

Bashkëpunimi me GLPS dhe WBROLI ka kontribuar në forcimin e dimensionit të të drejtave të njeriut dhe në harmonizimin e praktikës gjyqësore me standardet evropiane.

6.6.4.17 Aktivitetet e realizuara në bashkëpunim me Rrjetin Evropian të Trajnimit Gjyqësor (EJTN)

Gjatë vitit 2025, Akademia e Drejtësisë ka vazhduar angazhimin e saj në forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar përmes pjesëmarrjes në aktivitetet e Rrjetit Evropian të Trajnimit Gjyqësor (EJTN), në kuadër të projektit për Ballkanin Perëndimor të financuar nga Komisioni Evropian.

Në këtë kuadër, është realizuar pjesëmarrja në një seminar të avancuar me temë “Garancitë procedurale në procedurat penale në Bashkimin Evropian në praktikë: fokus në Direktivën për Fëmijët”, në të cilin ka përfutur një prokuror nga Prokuroria Themelore e Prishtinës.

Ky aktivitet ka pasur për qëllim forcimin e njohurive profesionale mbi zbatimin praktik të standardeve të Bashkimit Evropian lidhur me të drejtat procedurale, me theks të veçantë në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në procedurat penale.

Pjesëmarrja në programet e EJTN-së përfaqëson një komponent të rëndësishëm të integritimit profesional të sistemit të drejtësisë në rrjetet evropiane të trajnimit.

Ky bashkëpunim ka mundësuar:

- ekspozimin e profesionistëve ligjor ndaj standardeve dhe praktikave të BE-së;
- përmirësimin e njohurive për zbatimin e direktivave evropiane;
- si dhe ndërlidhjen e sistemit vendor me rrjetet profesionale evropiane.

Bashkëpunimi me EJTN ka kontribuar në avancimin e standardeve profesionale dhe në afrimin e sistemit të drejtësisë në Kosovë me praktikën dhe kërkesat e Bashkimit Evropian.

6.6.4.18 Aktivitetet e realizuara në bashkëpunim me Akademinë e së Drejtës Evropiane (ERA)

Gjatë vitit 2025, Akademia e Drejtësisë ka vazhduar bashkëpunimin e ngushtë me Akademinë e së Drejtës Evropiane (ERA), duke ofruar mundësi për pjesëmarrjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve nga Kosova në programe të avancuara trajnimit dhe shkëmbimi në fushën e së drejtës së Bashkimit Evropian.

Ky bashkëpunim ka përfshirë organizimin e trajnimeve në formë fizike dhe pjesëmarrjen në programe ndërkombëtare, me qëllim zhvillimin e kapaciteteve profesionale në fusha kyçe të së drejtës, me theks të veçantë në të drejtën e Bashkimit Evropian, barazinë gjinore dhe luftën kundër diskriminimit.

Qëllimi kryesor i këtij bashkëpunimi ka qenë rritja e kompetencave profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve të Kosovës në fusha të rëndësishme për procesin e integritetit evropian, si dhe për forcimin e një sistemi drejtësie të harmonizuar me standardet dhe praktikën evropiane.

Në kuadër të këtij programi janë realizuar gjithsej gjashtë (6) seminare, përkatësisht dy (2) seminare në fushën e së drejtës së BE-së për barazi gjinore dhe katër (4) seminare në fushën e së drejtës së BE-së kundër diskriminimit.

Në këto aktivitete trajnuese kanë marrë pjesë gjithsej pesë (5) përfitues nga Kosova, përfshirë tre (3) gjyqtarë nga Gjykatat Themelore në Prishtinë, Prizren dhe Ferizaj, si dhe dy (2) prokurorë nga Prokuroritë Themelore në Prishtinë dhe Gjiilan.

Përveç pjesëmarrjes në seminare ndërkombëtare, në kuadër të këtij bashkëpunimi Akademia e Drejtësisë ka realizuar edhe një trajnim të specializuar për gjyqtarët e Gjykatës Komerciale me temë “E drejta Evropiane e konkurrencës”.

Ky trajnim është organizuar me qëllim të forcimit të kapaciteteve të gjyqtarëve për zbatimin efektiv të së drejtës së konkurrencës, në përputhje me standardet dhe zhvillimet më të fundit të Bashkimit Evropian. Në kuadër të këtij trajnimi janë trajtuar çështje të avancuara si:

- ❖ përcaktimi i tregut relevant dhe sfidat në tregjet digjitale;
- ❖ interpretimi dhe zbatimi i dispozitave të nenit 101 dhe 102 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian (TFBE);
- ❖ vlerësimi i provave ekonomike në rastet e konkurrencës;
- ❖ abuzimi i pozitës dominuese në tregjet tradicionale dhe digjitale;
- ❖ si dhe zbatimi privat i së drejtës së konkurrencës, përfshirë provimin dhe kalkulimin e dëmit.

Ky bashkëpunim përfaqëson një nga mekanizmat kryesor për integrimin e standardeve të së drejtës së Bashkimit Evropian në sistemin e drejtësisë në Kosovë.

Në veçanti, aktivitetet e realizuara kanë kontribuar në:

- rritjen e njohurive për acquis të BE-së në fusha prioritare;
- forcimin e parimeve të barazisë dhe mosdiskriminimit në praktikë;
- zhvillimin e kapaciteteve në fusha të specializuara si e drejta e konkurrencës;
- si dhe përgatitjen e sistemit të drejtësisë për procesin e integritetit evropian.

Në tërësi, bashkëpunimi me ERA gjatë vitit 2025 ka kontribuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në zhvillimin e kapaciteteve profesionale dhe në harmonizimin e praktikës gjyqësore me standardet e Bashkimit Evropian, duke mbështetur objektivat strategjike të Akademisë së Drejtësisë dhe procesin e integritetit evropian të Kosovës.

6.6.4.19 PËRMBLEDHJE E AKTIVITETEVE NE BASHKËPUNIM NDËRKOMBËTAR

Në tërësi, bashkëpunimi dhe koordinimi i Akademisë së Drejtësisë gjatë vitit 2025 me institucionet vendore, partnerët ndërkombëtarë dhe donatorët ka përfaqësuar një nga shtyllat kryesore në realizimin e mandatit të saj ligjor dhe në avancimin e kapaciteteve të sistemit të drejtësisë në Kosovë. Përmes një qasjeje të strukturuar dhe të koordinuar, Akademia ka arritur të ndërtojë dhe të forcojë partneritete të qëndrueshme me institucionet kyçe të sistemit gjyqësor dhe prokurorial, si dhe me një gamë të gjerë organizatash dhe mekanizmash ndërkombëtarë, duke siguruar kështu një ndërlidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet nevojave të sistemit të drejtësisë dhe zhvillimit të programeve trajnuese.

Bashkëpunimi ndërkombëtar, në veçanti, ka kontribuar në integrimin e standardeve evropiane dhe praktikave më të mira në programet trajnuese të Akademisë, duke mundësuar jo vetëm ngritjen e kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve, por edhe harmonizimin gradual të praktikës gjyqësore me acquis të Bashkimit Evropian dhe instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Në këtë kontekst, aktivitetet e realizuara kanë pasur një ndikim të drejtpërdrejtë në:

- rritjen e cilësisë së vendimmarrjes gjyqësore dhe prokuroriale;

- forcimin e specializimit në fusha të ndjeshme dhe komplekse të drejtësisë;
- përmirësimin e bashkëpunimit ndërinstytucional në nivel vendor dhe ndërkombëtar;
- si dhe në rritjen e ekspozimit dhe integritit profesional të sistemit të drejtësisë së Kosovës në rrjetet evropiane dhe ndërkombëtare.

Rezultatet e arritura dëshmojnë se bashkëpunimi me partnerët strategjik ka qenë një faktor kyç në përmbushjen e objektivave të Akademisë, duke kontribuar në zhvillimin e një sistemi drejtësie më profesional, më të pavarur dhe më të harmonizuar me standardet evropiane.

Në përfundim, Akademia e Drejtësisë mbetet e përkushtuar që edhe në të ardhmen të thellojë dhe të zgjerojë bashkëpunimin me të gjithë partnerët relevantë, me qëllim të sigurimit të një zhvillimi të qëndrueshëm të kapaciteteve profesionale dhe të përmbushjes së prioriteteve strategjike të sistemit të drejtësisë dhe procesit të integritit evropian.

6.7 NGRITJA E TRANSPARENCËS DHE MARRËDHËNIA ME PUBLIKUN

Gjatë periudhës raportuese, Akademia e Drejtësisë ka vazhduar të avancojë transparencën institucionale dhe të forcojë marrëdhënien me publikun, duke siguruar qasje të drejtpërdrejtë, të saktë dhe në kohë në informacionet që ndërlidhen me veprimtarinë, vendimmarrjen dhe menaxhimin financiar të saj.

Në këtë drejtim, Akademia ka intensifikuar komunikimin publik përmes përdorimit të platformave zyrtare, përfshirë ueb-faqen zyrtare, portalin institucional dhe rrjetet sociale si LinkedIn dhe Facebook, duke i shfrytëzuar këto kanale si mjete kryesore për informimin e vazhdueshëm të publikut dhe palëve të interesit.

Gjatë vitit 2025, janë publikuar në mënyrë të rregullt të gjitha materialet që ndërlidhen me veprimtarinë e Akademisë, përfshirë njoftimet dhe raportet për realizimin të trajnimeve dhe aktiviteteve të zhvilluara në kuadër të programeve të saj, me gjithsej rreth 210 publikime në ueb-faqen zyrtare. Paralelisht, janë realizuar rreth 48 postime në LinkedIn dhe mbi 30 postime në Facebook, duke kontribuar në rritjen e dukshmërisë institucionale dhe në komunikimin më të drejtpërdrejtë me publikun.

Në këtë kuadër, janë ndërmarrë veprime të vazhdueshme për:

- përditësimin e rregullt të ueb-faqes zyrtare dhe rrjeteve sociale me informacione dhe njoftime zyrtare;
- publikimin e njoftimeve për takimet zyrtare të Drejtorit Ekzekutiv me partnerë vendor dhe ndërkombëtar, si dhe informimin për trajnimet dhe aktivitetet e realizuara nga Akademia;
- publikimin e akteve nënligjore të miratuara nga Këshilli Drejtues, përfshirë rregulloret, vendimet dhe dokumentet strategjike;
- publikimin e raporteve financiare në baza mujore dhe kumulative, përfshirë Buxhetin për vitin 2025 dhe raportet vjetore financiare për periudhën 2019–2024;
- publikimin e raporteve të auditimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit dhe të Departamentit të Auditimit të Brendshëm të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.

Masat e ndërmarra gjatë kësaj periudhe reflektojnë një qasje të konsoliduar institucionale për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies publike, duke siguruar që informacionet relevante të jenë të qasshme, të strukturuar dhe të verifikueshme.

Në veçanti, publikimi i rregullt i, aktiviteve trajnuese, dokumenteve strategjike dhe akteve nënligjore, si dhe i të dhënave financiare dhe raporteve të auditimit, ngrisin llogaridhënien dhe synojnë të forcojnë besimin e publikut dhe të partnerëve institucional ndaj punës së Akademisë.

Në tërësi, gjatë vitit 2025, Akademia e Drejtësisë ka bërë përparim të dukshëm në avancimin e transparencës dhe komunikimit publik, duke e konsoliduar këtë fushë si një komponent thelbësor të qeverisjes së mirë dhe të përmbushjes së standardeve për një institucion modern, të hapur dhe të përgjegjshëm ndaj publikut.

6.8 NGRITJA E KAPACITETEVE PROFESIONALE ADMINISTRATIVE, CILËSISË SË SHËRBIMEVE ADMINISTRATIVE DHE SHPENZIMEVE FINANCIARE TË BUXHETIT

Në funksion të përmbushjes së mandatit të saj ligjor dhe realizimit efektiv të programeve trajnuese, Akademia e Drejtësisë gjatë vitit 2025 ka ndërmarrë një sërë aktivitetesh strategjike në drejtim të forcimit të kapaciteteve profesionale administrative, përmirësimit të cilësisë së shërbimeve mbështetëse dhe menaxhimit efikas, transparent dhe të qëndrueshëm të burimeve financiare dhe materiale.

Këto aktivitete janë zhvilluar në përputhje të plotë me objektivat e Planit të Punës dhe të Performancës për vitin 2025, duke reflektuar një qasje të integruar institucionale që synon:

- rritjen e efikasitetit organizativ;
- forcimin e menaxhimit dhe udhëheqjes së brendshme;
- dhe sigurimin e kushteve optimale për zhvillimin e veprimtarisë trajnuese dhe profesionale të Akademisë.

Në këtë kontekst, Akademia ka synuar jo vetëm funksionimin e rregullt administrativ, por edhe avancimin cilësor të proceseve të saj të brendshme, përmes:

- ✓ përmirësimit të bazës ligjore;
- ✓ rritjes së koordinimit institucional;
- ✓ dhe zhvillimit të infrastrukturës mbështetëse administrative dhe teknike.

6.8.1 Aktivitetet në fushën e shërbimeve ligjore dhe shërbimeve të përgjithshme

Gjatë periudhës raportuese, Akademia e Drejtësisë ka zhvilluar aktivitete të rëndësishme në fushën e shërbimeve ligjore dhe të përgjithshme, të cilat kanë qenë të orientuara drejt mbështetjes së vazhdueshme të organeve drejtuese, forcimit të bazës ligjore dhe përmirësimit të funksionimit institucional.

Në këtë drejtim, është siguruar mbështetje e drejtpërdrejtë për funksionimin e Këshillit Drejtues dhe Këshillit Programor, si dhe për departamentet dhe njësitë tjera të Akademisë, duke garantuar koordinim institucional dhe zbatim të qëndrueshëm të aktiviteve të planifikuara.

Njëkohësisht, gjatë vitit 2025 është shënuar një angazhim i shtuar në drejtim të përmirësimit të bazës ligjore të Akademisë, veçanërisht në kontekst të ndryshimeve që ndërliken me statusin e nëpunësve civilë me status të veçantë. Në këtë kuadër, Akademia ka luajtur rol aktiv në inicimin e procesit të hartimit të akteve nënligjore, përmes organizimit të punëtorive, ofrimit të komenteve profesionale dhe mbështetjes së komisioneve përkatëse për hartimin e pakos së projekt-akteve nënligjore.

Këto aktivitete kanë reflektuar një qasje të strukturuar dhe proaktive institucionale, duke kontribuar në harmonizimin e funksionimit të brendshëm me kërkesat ligjore në fuqi dhe në krijimin e një baze të qëndrueshme normative për zhvillimin e mëtejshëm të Akademisë së Drejtësisë.

Në kuadër të aktiviteteve konkrete të realizuara gjatë periudhës raportuese, vlen të theksohen:

- ✓ hartimi i Rregullores Nr. 01/2025 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 05/2023 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Akademinë e Drejtësisë;
- ✓ mbështetja dhe ofrimi i shërbimeve ligjore për Këshillin Drejtues dhe komisionet përkatëse në hartimin e gjithsej 20 akteve nënligjore, në përputhje me nenin 6, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L-294 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrarët Publikë;
- ✓ organizimi i takimeve të komisioneve për hartimin e akteve nënligjore, përfshirë prezantimin e praktikave dhe rregullativës së institucioneve publike të Kosovës;
- ✓ hartimi i gjithsej 60 propozim-vendimeve për Këshillin Drejtues;
- ✓ hartimi i Memorandumit të Bashkëpunimit me Grupin për Studime Juridike dhe Politike;
- ✓ raportimi mbi zbatueshmërinë e Planit të Integritetit për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2025;
- ✓ ushtrimi i rolit të pikës së kontaktit me Zyrën Kombëtare të Auditimit dhe Departamentin e Auditimit të Brendshëm të MFPT, përfshirë adresimin e gjetjeve dhe rekomandimeve të auditimit.

Paralelisht, Akademia ka siguruar mbështetje të vazhdueshme në aspektin administrativ, logjistik dhe të teknologjisë së informacionit, duke garantuar funksionimin e rregullt të proceseve të brendshme dhe krijimin e kushteve adekuate për zhvillimin e aktiviteteve trajnuese.

Aktivitetet e realizuara në këtë fushë tregojnë se Akademia e Drejtësisë ka bërë përparim të dukshëm në konsolidimin e bazës së saj ligjore dhe në forcimin e qeverisjes institucionale.

Në tërësi, rezultatet e arritura në këtë fushë reflektojnë një avancim të rëndësishëm të kapaciteteve institucionale të Akademisë së Drejtësisë, duke krijuar një bazë të qëndrueshme për zhvillimin e mëtejshëm dhe për përmbushjen efektive të mandatit të saj ligjor.

6.8.2 Aktivitetet në funksion të koordinimit institucional dhe bashkëpunimit ndërinstytucional

Në kuadër të zbatimit të Planit të Punës për vitin 2025 dhe në funksion të përmbushjes së përgjegjësisë ligjore dhe institucionale, Akademia e Drejtësisë ka zhvilluar një sërë aktivitete që kanë kontribuar në forcimin e koordinimit institucional dhe avancimin e bashkëpunimit ndërinstytucional dhe ndërkombëtar.

Në këtë drejtim, një fokus i veçantë është vendosur në mbështetjen e funksionimit të organeve drejtuese të Akademisë së Drejtësisë, përkatësisht Këshillit Drejtues dhe Këshillit Programor, si organe kyçe për orientimin strategjik dhe zhvillimin e programeve trajnuese.

Në kuadër të kësaj mbështetjeje janë realizuar:

- ✓ organizimi i shtatë (7) takimeve të Këshillit Drejtues, përfshirë përgatitjen dhe shpërndarjen e materialeve përkatëse;
- ✓ organizimi i tre (3) takimeve të Këshillit Programor, me përgatitje të dokumentacionit dhe materialeve mbështetëse.

Përveç kësaj, në funksion të sigurimit të funksionimit të plotë të Këshillit Programor, Akademia ka zhvilluar procedurat për plotësimin e përbërjes së tij përmes shpalljes publike, shqyrtimit të aplikimeve dhe dorëzimit të listës së kandidatëve për përzgjedhje dhe emërim. Ky proces ka kontribuar në rritjen e kapaciteteve profesionale dhe funksionalitetit të këtij organi.

Paralelisht, Akademia ka vazhduar të forcojë bashkëpunimin ndërinstytucional dhe ndërkombëtar përmes organizimit të aktiviteteve të përbashkëta, seminareve dhe vizitave studimore, duke mundësuar shkëmbimin e përvojave dhe avancimin e njohurive profesionale të përfituesve.

Në funksion të përmbushjes së obligimeve institucionale dhe kontraktuale, janë hartuar gjithashtu propozim-vendime të brendshme që kanë mbështetur realizimin e aktiviteteve dhe përmbushjen e përgjegjësisë ndaj institucioneve relevante, përfshirë Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit. Në tërësi, bashkëpunimi i zhvilluar gjatë kësaj periudhe ka përfshirë një gamë të gjerë partnerësh dhe projektesh, duke kontribuar në zhvillimin profesional të gjyqtarëve dhe prokurorëve nga të gjitha nivelet e sistemit të drejtësisë.

Aktivitetet e ndërmarra në këtë fushë tregojnë se Akademia ka konsoliduar ndjeshëm mekanizmat e koordinimit institucional dhe bashkëpunimit ndërinstitutional, e ne veçanti:

- ✓ funksionimi i rregullt i organeve drejtuese ka rritur cilësinë e vendimmarrjes;
- ✓ plotësimi i përbërjes së Këshillit Programor ka përmirësuar orientimin strategjik të programeve trajnuese;
- ✓ bashkëpunimi me partnerët vendor dhe ndërkombëtar ka zgjeruar mundësitë për zhvillim profesional;
- ✓ dhe është forcuar përgjegjshmëria institucionale përmes akteve të brendshme dhe koordinimit me institucionet relevante.

Në tërësi, kjo ka rezultuar në një avancim të qëndrueshëm të kapaciteteve institucionale për koordinim dhe menaxhim.

6.8.3 Aktivitetet në menaxhimin administrativ, logjistik dhe financiar

Gjatë vitit 2025, Akademia e Drejtësisë ka zhvilluar aktivitete të vazhdueshme në funksion të sigurimit të mbështetjes administrative, logjistike dhe financiare, duke synuar krijimin e kushteve optimale për realizimin e programeve trajnuese dhe funksionimin e përgjithshëm institucional.

Në këtë drejtim, një fokus i veçantë është vendosur në:

- menaxhimin dhe administrimin e pasurisë, inventarit dhe pajisjeve;
- garantimin e funksionimit të rregullt të proceseve financiare;
- dhe sigurimin e mbështetjes logjistike për aktivitetet trajnuese.
- Akademia ka vazhduar regjistrimin sistematik të aseteve dhe pasurisë jo-financiare në sistemet përkatëse, duke siguruar transparencë dhe kontroll në menaxhimin e pasurisë publike.

Njëkohësisht, janë zhvilluar procese të strukturuar për administrimin financiar, përfshirë: pranimin, verifikimin dhe protokolimin e faturave, dhe procedimin e tyre për pagesë në përputhje me procedurat financiare në fuqi.

Një pjesë e rëndësishme e angazhimit ka qenë sigurimi i mbështetjes logjistike për zhvillimin e trajnimeve, përmes përgatitjes dhe mirëmbajtjes së sallave dhe kushteve teknike.

Në aspektin strategjik, gjatë vitit 2025 është kushtuar vëmendje e veçantë përgatitjes për funksionalizimin e ndërtesës së re të Akademisë së Drejtësisë. Në këtë kuadër janë realizuar:

- ✓ takime të rregullta me institucionet përgjegjëse dhe operatorin ekonomik;
- ✓ vizita në terren për monitorimin e progresit të ndërtimit;
- ✓ planifikimi i nevojave buxhetore për pajisje dhe inventar;
- ✓ si dhe koordinimi për zhvillimin e dizajnit funksional të objektit.

Paralelisht, Akademia ka menaxhuar kontratat për shërbime dhe furnizime, duke përfshirë: mirëmbajtjen dhe pastrimin, sigurimin, përkthimin, shtypin dhe botimin, furnizimet ushqimore; dhe mirëmbajtjen e automjeteve zyrtare.

6.8.4 Digjitalizimi dhe përdorimi i teknologjisë informative në realizimin e funksioneve të Akademisë së Drejtësisë

Gjatë vitit 2025, Akademia e Drejtësisë ka vazhduar të zhvillojë dhe të konsolidojë përdorimin e teknologjisë informative në funksion të mbështetjes së proceseve operative, administrative dhe trajnuese, duke reflektuar një qasje të qartë drejt digjitalizimit dhe modernizimit institucional.

Në këtë drejtim, është siguruar funksionimi i qëndrueshëm i infrastrukturës së teknologjisë së informacionit, përfshirë serverët, rrjetin, pajisjet kompjuterike dhe mjetet teknologjike të përdorura në proceset trajnuese dhe administrative. Mirëmbajtja dhe administrimi i vazhdueshëm i kësaj infrastrukture kanë qenë thelbësore për garantimin e funksionimit të pandërprerë të sistemeve dhe për realizimin efektiv të aktiviteteve të Akademisë.

Njëkohësisht, është ofruar mbështetje e përditshme teknike për stafin përmes shërbimeve të asistencës (Helpdesk), duke mundësuar zgjidhjen në kohë të çështjeve teknike dhe sigurimin e funksionimit normal të proceseve të punës. Në këtë kuadër, është kushtuar rëndësi edhe zbatimit të politikave të sigurisë së informacionit dhe menaxhimit të të dhënave, përfshirë krijimin dhe monitorimin e kopjeve rezervë të dhënave kritike (backup) të të dhënave kritike.

Në funksion të mbështetjes së proceseve trajnuese, Akademia ka avancuar përdorimin e teknologjisë përmes Sistemit për Menaxhimin e Aktivitetit Trajnues (SMAT), duke mundësuar realizimin e materialeve trajnuese, detyrave dhe vlerësimeve në mënyrë digjitale. Vendosja dhe menaxhimi i pajisjeve teknologjike në sallat e trajnimit ka kontribuar në rritjen e efikasitetit dhe cilësisë së procesit mësimor.

Paralelisht, gjatë kësaj periudhe është ofruar mbështetje teknike për zhvillimin e trajnimeve në gjatë kësaj periudhe është ofruar mbështetje teknike për zhvillimin e trajnimeve në distancë, përfshirë kurset online të ofruara në bashkëpunim me partnerë ndërkombëtarë.

Në funksion të përmirësimit të infrastrukturës teknologjike, Akademia është furnizuar me pajisje shtesë të teknologjisë së informacionit, duke përfshirë pajisje për ruajtjen e të dhënave, rrjetin dhe pajisje të tjera mbështetëse, të cilat kanë ndikuar në rritjen e kapaciteteve teknologjike dhe në përmirësimin e performancës së sistemeve ekzistuese.

Një aspekt i rëndësishëm i rëndësishëm gjatë vitit 2025 ka qenë bashkëpunimi me Agjencinë për Shoqëri të Informacionit (ASHI) lidhur me menaxhimin e serverëve të Akademisë. Ky bashkëpunim ka përfshirë ndërhyrje teknike për adresimin e problemeve të paraqitura dhe zëvendësimin e serverëve në fund të vitit. Megjithëse këto ndërhyrje kanë shkaktuar ndërprerje të përkohshme në funksionimin e disa sistemeve, ato kanë qenë të domosdoshme për stabilizimin dhe përmirësimin afatgjatë të infrastrukturës teknologjike.

Në të njëjtën kohë, teknologjia informative është përdorur edhe në funksion të transparencës institucionale, përmes mirëmbajtjes dhe përditësimit të ueb-faqes zyrtare dhe platformave të rrjeteve sociale, duke siguruar publikimin e rregullt të njoftimeve, dokumenteve dhe materialeve relevante për publikun dhe palët e interesit.

6.8.5 Ngritja e cilësisë së furnizimeve me mallra dhe shërbime dhe menaxhimi efektiv i kontratave (prokurimi i mallrave dhe shërbimeve)

Gjatë vitit 2025, Akademia e Drejtësisë ka realizuar aktivitetet e saj në fushën e prokurimit publik në përputhje me kornizën ligjore në fuqi, duke reflektuar ndryshimet ligjore që përcaktojnë kompetencat e institucioneve në këtë fushë. Në bazë të legjislacionit përkatës, zhvillimi i procedurave të prokurimit realizohet përmes Agjencisë Qendrore të Prokurimit, ndërsa Akademia ushtron rolin e saj në planifikimin, specifikimin teknik dhe menaxhimin e kontratave.

Në këtë kuadër, Akademia ka zhvilluar një qasje të strukturuar në planifikimin e prokurimit, duke hartuar planifikimin paraprak dhe përfundimtar për nevojat vjetore, si dhe duke përgatitur specifikacionet teknike për furnizimet, shërbimet dhe punët që lidhen drejtpërdrejt me realizimin e aktiviteteve institucionale dhe trajnuese.

Gjatë vitit raportues janë planifikuar gjithsej 14 aktivitete të prokurimit, të cilat kanë përfshirë një gamë të gjerë furnizimesh dhe shërbimesh, duke përfshirë furnizimet me materiale zyrtare, pajisje të teknologjisë informative, shërbime të transportit, mirëmbajtje të sistemeve, si dhe shërbime të akomodimit dhe ushqimit për pjesëmarrësit në trajnim.

Nga këto aktivitete, Akademia ka dërguar 12 kërkesa për zhvillim të procedurave të prokurimit në Agjencinë Qendrore të Prokurimit, ndërsa për një pjesë të aktiviteteve të planifikuara nuk është arritur zhvillimi i plotë i procedurave ose finalizimi i kontratave, për shkak të faktorëve të ndryshëm proceduralë dhe operacionalë.

Gjatë kësaj periudhe, Akademia ka pranuar gjithsej 19 kontrata të nënshkruara nga Agjencia Qendrore e Prokurimit, të cilat kanë mbuluar furnizime dhe shërbime esenciale për funksionimin e institucionit, duke përfshirë furnizimet me karburant, materiale zyrtare, pajisje teknologjike, shërbime të përkthimit, transportit, pastrimit, sigurimit fizik dhe shërbime të tjera mbështetëse.

Në të njëjtën kohë, Akademia ka qenë përgjegjëse për menaxhimin e këtyre kontratave, duke përfshirë emërimin e menaxherëve të kontratave, mbikëqyrjen e zbatimit të tyre dhe pranimin e mallrave dhe shërbimeve në përputhje me kushtet kontraktuale. Gjithashtu, janë ndërmarrë veprime për ekzekutimin e urdhërblërjeve dhe për sigurimin e furnizimeve të nevojshme për funksionimin e përditshëm të institucionit.

Një aspekt i rëndësishëm gjatë vitit 2025 ka qenë edhe menaxhimi i ndryshimeve kontraktuale, përfshirë amendamentet e kontratave të lidhura në nivel qendror, të cilat janë reflektuar në përputhje me ndryshimet ligjore dhe ekonomike, siç është rasti i ndryshimit të pagës minimale.

Në funksion të mbështetjes së aktiviteteve institucionale dhe trajnuese, Akademia ka siguruar vazhdimësinë e furnizimeve dhe shërbimeve përmes menaxhimit efektiv të kontratave, duke mbuluar nevojat për logjistikë, transport, komunikim, mirëmbajtje dhe shërbime të tjera mbështetëse.

Në funksion të mbështetjes së aktiviteteve institucionale dhe trajnuese, Akademia ka siguruar vazhdimësinë e furnizimeve dhe shërbimeve përmes menaxhimit efektiv të kontratave, duke mbuluar nevojat për logjistikë, transport, komunikim, mirëmbajtje dhe shërbime të tjera mbështetëse.

Planifikimi i prokurimit për vitin 2025	Kërkesat e dërguara nga AD në AQP për zhvillim të aktiviteti të prokurimit në vitin 2025	Kontratat e pranuar nga AQP në vitin 2025	Aktivite të prokurimit të dështuara në vitin 2025
14	12	19	3

Tabela x. Aktivitetet e prokurimit në vitin 2025

Aktivitetet të realizuara në këtë fushë tregojnë se Akademia e Drejtësisë ka arritur të sigurojë një nivel të qëndrueshëm të menaxhimit të prokurimit dhe furnizimeve, pavarësisht kufizimeve institucionale që lidhen me zhvillimin e procedurave përmes Agjencisë Qendrore të Prokurimit. Në të njëjtën kohë, menaxhimi i kontratave të pranuar ka kontribuar në rritjen e efikasitetit operacional dhe në sigurimin e vazhdimësisë së shërbimeve thelbësore për funksionimin e Akademisë. Megjithatë, mosrealizimi i plotë i disa aktivitetet të planifikuara tregon nevojën për forcimin e koordinimit me institucionet përgjegjëse dhe për përmirësimin e planifikimit operacional në periudhat në vijim.

7. PLANIFIKIMI DHE EKZEKUTIMI I BUXHETIT DHE RAPORTI FINANCIAR

Gjatë vitit 2025, Akademia e Drejtësisë ka demonstruar një menaxhim të qëndrueshëm dhe efikas të burimeve financiare, duke siguruar që buxheti institucional të mbështesë drejtpërdrejt realizimin e mandatit ligjor dhe objektivave strategjike të saj.

Buxheti përfundimtar për vitin 2025 ka qenë **737,099.16 euro**, ndërsa niveli i ekzekutimit ka arritur në **96.86%**, duke reflektuar një planifikim realist dhe një disiplinë të lartë në menaxhimin financiar. Struktura e shpenzimeve ka qenë e orientuar kryesisht drejt realizimit të aktivitetet trajnuese, me mbi gjysmën e buxhetit të dedikuar për mallra dhe shërbime që mbështesin drejtpërdrejt zhvillimin profesional të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Në funksion të përmbushjes së objektivave institucionale, një pjesë e konsiderueshme e shpenzimeve është alokuar për programe trajnuese, duke përfshirë angazhimin e trajnerëve, mentorëve dhe sigurimin e kushteve logjistike për pjesëmarrësit. Ky orientim financiar dëshmon një lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet përdorimit të buxhetit dhe rezultateve në ngritjen e kapaciteteve të sistemit të drejtësisë.

Paralelisht, Akademia ka përfituar mbështetje të rëndësishme nga donatorët në vlerë prej **159,652.16 euro**, të cilat kanë mundësuar zgjerimin e aktivitetet trajnuese dhe përfshirjen e temave të specializuara në përputhje me standardet evropiane. Kjo mbështetje ka kontribuar në rritjen e cilësisë dhe diversitetit të programeve trajnuese, duke e kursyer në mënyrë komplementare buxhetin institucional.

Proceset e menaxhimit financiar janë karakterizuar nga transparencë dhe llogaridhënie, përmes raportimit të rregullt financiar dhe përdorimit të sistemeve të standardizuara për menaxhimin e financave publike. Auditimi i realizuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit ka rezultuar me **opinion pozitiv**, duke konfirmuar besueshmërinë e pasqyrave financiare dhe funksionimin efektiv të kontrolleve të brendshme.

Në tërësi, performanca financiare e Akademisë së Drejtësisë gjatë vitit 2025 reflekton një nivel të avancuar të qeverisjes financiare, ku fondet publike dhe mbështetja e donatorëve janë menaxhuar në mënyrë të integruar dhe strategjike, duke kontribuar drejtpërdrejt në përmirësimin e cilësisë së trajnimeve dhe në forcimin e sistemit të drejtësisë në Kosovë.

7.1 Menaxhimi i buxhetit dhe funksionimi financiar

Gjatë vitit 2025, Akademia e Drejtësisë ka vazhduar të zbatojë një qasje të konsoliduar dhe të përgjegjshme në menaxhimin e financave publike, duke siguruar që burimet financiare të planifikohen dhe të shfrytëzohen në funksion të realizimit të mandatit ligjor dhe objektivave strategjike të institucionit.

Menaxhimi financiar është realizuar përmes një koordinimi të vazhdueshëm ndërmjet njësive organizative, monitorimit sistematik të shpenzimeve dhe analizës periodike të realizimit buxhetor. Kjo ka mundësuar identifikimin në kohë të devijimeve dhe ndërmarrjen e masave korrigjuese, duke kontribuar në rritjen e efikasitetit financiar dhe në përdorimin optimal të burimeve në dispozicion. Divizioni për Buxhet dhe Financa ka siguruar zbatimin e legjisllacionit për financat publike, monitorimin dhe ekzekutimin e të gjitha transaksioneve financiare, si dhe raportimin e rregullt financiar në përputhje me standardet dhe kërkesat ligjore, duke garantuar transparencë dhe llogaridhënie institucionale.

Ne mbështetje të Ligjit mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës, buxheti i aprovuar për Akademinë Drejtësisë për vitin 2025 ishte 864,973.00 euro ndërsa buxheti përfundimtar duke i përfshirë kursimet dhe reduktime ishte 737,099.16 euro.

Gjatë vitit 2025 janë realizuar aktivitetet si në vijim:

- Janë përgatitur pasqyrat vjetore financiare për vitin 2024;
- Është përgatitur pyetësori për vetëvlerësim për vitin 2024;
- Është përgatitur rrjedha e parasë së gatshme për vitin 2025;
- Është përgatitur Korniza Afatmesme e Shpenzimeve dhe Buxheti për periudhën 2026-2028;
- Janë bërë barazimet periodike të shpenzimeve me thesar;
- Janë përgatitur raporte të ndryshme periodike financiare;
- Të gjitha shpenzimet e proceduara për këtë periudhë janë regjistruar në databazën e brendshme të financave, në SIMFK dhe të gjitha lëndët e pagesave janë skanuar.

Shpenzimet e krijuara gjatë kësaj periudhe janë mbuluar nga Buxheti i Republikës së Kosovës si burim kryesor financiar si dhe nga mbështetja e granteve të donatorëve.

Shpenzimet e buxhetit përfshihen në këto kategori kryesore ekonomike: pagat dhe mëditjet, mallrat dhe shërbimet dhe shpenzimet komunale. Tabela në vijim pasqyron buxhetin fillestar dhe buxhetin përfundimtar për vitin 2025, duke përfshirë kategoritë ekonomike.

Buxheti dhe Shpenzimet 2025				
Kategoria	Buxheti Fillestar	Reduktimet dhe Kursimet Buxhetore	Buxheti Përfundimtar	Shpenzimet
Pagat dhe Shtesa	324,275.14	(3,675.98)	320,599.16	320,599.16
Mallrat dhe Shërbimet	535,000.00	(132,000.00)	403,000.00	381,510.98
Shpenzimet Komunale	16,500.00	(3,000.00)	13,500.00	11,826.46
Totali	875,775.14	(138,675.98)	737,099.16	713,936.60

Tabela nr. 19: Raporti i Buxheti për vitin 2024

Me Ligjin mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, buxheti fillestar për këtë vit ka qenë 864,973.00 euro, për të gjitha kategoritë ekonomike përfshirë këtu pagat dhe mëditje, mallrat dhe shërbimet, shpenzime komunale dhe shpenzime kapitale.

Buxheti përfundimtar për vitin 2025 në të gjitha kategoritë është në vlerë prej 737,099.16 euro:


- Paga dhe shtesa, buxheti ka qenë 313,473.00 euro, sipas nenit 33 të Ligjin mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025 kjo shume është rritur edhe për 10,802.14 euro, ndërsa sipas vendimit të datës 24.12.2025 me numër 01/281 të Qeverisë së Republikës së Kosovës është reduktuar buxheti në këtë kategori për 3,675.98 euro, që do të thotë se buxheti përfundimtar është në vlerë prej 320,599.16 euro,
- Mallra dhe shërbime, buxheti ka qenë 535.000.00 euro, ndërsa sipas vendimit të datës 24.11.2025 me numër 01/276 të Qeverisë së Republikës së Kosovës është reduktuar buxheti në këtë kategori për 132,000.00 euro, buxheti përfundimtar në këtë kategori është 403,000.00 euro,
- Shpenzime komunal, buxheti ka qenë 16,500.00 euro, ndërsa sipas vendimit të datës 24.11.2025 me numër 01/276 të Qeverisë së Republikës së Kosovës është reduktuar buxheti në këtë kategori për 3,000.00 euro, buxheti përfundimtar në këtë kategori është 13,500.00 euro,

Kategoria	Buxheti	Shpenzimet	Shpenzimet në % në raport me buxhetin total	Mbetja	Përqindja	Shpërndarja e buxhetit në %
Pagat dhe Shtesa	320,599.16	320,599.16	44.91%	-	100.00	43.49
Mallrat dhe Shërbimet	403,000.00	381,510.98	53.44%	21,489.02	94.67	54.67
Shpenzimet Komunale	13,500.00	11,826.46	1.66%	1,673.54	87.60	1.83
Totali	737,099.16	713,936.60	100.00%	23,162.56	96.86	100.00

Tabela nr. 2. Ekzekutimi i Buxhetit për vitin 2025


7.2 Ekzekutimi i buxhetit

Gjatë vitit 2025, ekzekutimi i buxhetit ka arritur në **96.86%**, me një vlerë të shpenzuar prej **713,936.60 euro**, duke reflektuar një nivel të lartë të disiplinës financiare dhe një planifikim realist të aktiviteteve.



Grafikoni nr. 1 Ekzekutimi i Buxhetit për vitin 2025

Nga buxheti përfundimtar janë shpenzuar 713,936.60 euro apo 96.86 % e buxhetit.



Grafikoni nr. 3: Shpërndarja e buxhetit

Siç shihet në grafikon se 43% e buxhetit përfundimtar është ndarë për paga dhe shtesa, 55% për mallra dhe shërbime, dhe 2% për shpenzimet komunale.

Në raport me shumën totale të buxhetit të shpenzuar: pagat dhe shtesa janë 38.36%, mallrat dhe shërbimet janë 52.73%, shpenzimet komunale janë 1.58% dhe shpenzime kapitale janë 7.32%.


7.3 Analiza e shpenzimeve sipas kategorive dhe krahasimeve

Në analizën krahasuese të shpenzimeve sipas kategorive dhe nënkategorive ekonomike për vitet 2023–2025, vërehet një qëndrueshmëri relative në strukturën e shpenzimeve, me fokus të vazhdueshëm në mbështetjen e aktiviteteve trajnuese.

Një pjesë e konsiderueshme e buxhetit është dedikuar drejtpërdrejt për realizimin e aktiviteteve trajnuese.

Në kuadër të kategorisë ekonomike **shërbime të arsimit dhe trajnimit (13410)** janë shpenzuar gjithsej **175,153.90 euro**, nga të cilat:

- **140,992.80 euro** për angazhimin e trajnuesve dhe mentorëve,
- **34,161.10 euro** për mbështetjen logjistike të pjesëmarrësve.



Grafikoni nr. 3. Shpenzimi i buxhetit

Në raport me shumën totale të buxhetit të shpenzuar: pagat dhe shtesa janë 44.91%, mallrat dhe shërbimet janë 53.44% dhe shpenzimet komunale janë 1.66%.

Në tabelën në vazhdim përveç kategorive ekonomike shpenzimet prezantohen edhe për nënkategoritë ekonomike duke krahasuar me buxhetin e vitit për secilën kategori dhe nënkategori.

Buxheti dhe shpenzimet sipas kategorive dhe nënkategorive për vitin 2025					
Kategoria	Nënkategoria	Shpenzimet	Buxheti	Ndryshimi	Përqindja
Paga					
11110	Pagat neto përmes listës	272,774.43	272,774.43	-	100.00
11121	Tatimi i ndalur në të ardhura	17,291.09	17,291.09	-	100.00
11131	Kontributi i punëtorit	15,266.82	15,266.82	-	100.00
11311	Kontributi i punëdhënësit	15,266.82	15,266.82	-	100.00
Shuma		320,599.16	320,599.16	-	100.00
Mallra dhe Shërbime					
13132	Akomodimi udhëtime zyrtre brenda vendit	-	500.00	500.00	-
13140	Transporti per udhetime zyrtare jashte vendit	390.00	1,000.00	610.00	39.00
13141	Para xhepi/Meditjet e udhetimit zyrtare jashte vendit	5,107.24	5,500.00	392.76	92.86
13142	Akomodimi udhëtime zyrtre jashtë vendit	3,887.87	5,000.00	1,112.13	77.76
13143	Shpenzime tjera udhëtime zyrtre jashtë vendit	361.74	1,500.00	1,138.26	24.12
13320	Shpenzimet e telefonisë mobile	2,332.68	3,000.00	667.32	77.76
13410	Shërbimet e arsimit trajnimit	175,153.90	176,560.00	1,406.10	99.20
13430	Shërbime të ndryshme shëndetsore	-	200.00	200.00	-
13440	Shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshilldhënës	9,997.05	10,000.00	2.95	99.97
13460	Shërbime kontraktuese tjera	15,197.33	16,000.00	802.67	94.98
13501	Mobilje (me pak se 1000 euro)	-	-	-	-
13509	Pajisje tjera	2,190.18	3,000.00	809.82	73.01
13610	Furnizime për zyre	1,649.22	2,000.00	350.78	82.46
13620	Furnizim me ushqim, pije (jo dreka zyrtare)	3,143.25	3,500.00	356.75	89.81
13720	Naftë per ngrohje qendrore	16,494.28	19,000.00	2,505.72	86.81
13780	Derivatet per automjete, gjeneratore dhe makineri	1,072.57	1,500.00	427.43	71.50
13810	Avancë për parat e imta	-	500.00	500.00	-
13950	Regjistrim i automjeteve	316.50	720.00	403.50	43.96
13951	Sigurimi i automjeteve	1,384.61	2,000.00	615.39	69.23
13952	Taksat Komunale e Regjistrimi te automjeteve	-	50.00	50.00	-
13953	Sigurim i ndertesave dhe tjera	23,704.92	25,000.00	1,295.08	94.82
13954	Kontrollomi teknik i automjeteve	-	200.00	200.00	-
14010	Mirembajtje dhe riparim i automjeteve	270.60	1,000.00	729.40	27.06
14020	Mirembajtja e ndertesave administrative dhe afariste	6,632.88	7,200.00	567.12	92.12
14040	Mirembajtje e teknologjise informative	-	1,500.00	1,500.00	-
14050	Mirembajtje e mobiljeve dhe pajisjeve	-	1,000.00	1,000.00	-
14110	Qiraja e ndertesave	90,000.00	90,000.00	-	100.00
14130	Qiraja per pajisjet	2,946.05	3,000.00	53.95	98.20
14210	Reklamat dhe konkurset	-	570.00	570.00	-
14220	Botimet e publikimeve	18,008.11	20,000.00	1,991.89	90.04
14310	Dreka zyrtare	1,270.00	2,000.00	730.00	63.50
14410	Shpenzimet - Vendimet e gjykatave	-	-	-	-
Shuma		381,510.98	403,000.00	21,489.02	94.67
Komunali					
13210	Rryma	9,745.22	10,000.00	254.78	97.45
13220	Uji	241.98	500.00	258.02	48.40
13230	Mbeturinat	1,336.68	2,000.00	663.32	66.83
13250	Shpenzimet e telefonit	502.58	1,000.00	497.42	50.26
Shuma		11,826.46	13,500.00	1,673.54	87.60
Totali		713,936.60	737,099.16	23,162.56	96.86

Tabela nr. 3. Shpenzimet për kategori dhe nënkategori ekonomik

Krahasimi i buxhetit 2023 – 2025

Buxheti përfundimtar për vitet 2023 – 2025			
Kategoria	2023	2024	2025
Pagat dhe Shtesa	229,115.30	254,651.78	320,599.16
Mallrat dhe Shërbimet	435,000.00	419,948.00	403,000.00
Shpenzimet Komunale	16,500.00	11,000.00	13,500.00
Shpenzime Kpaitale	196,000.00	50,000.00	-
Totali	876,615.30	735,599.78	737,099.16

Tabela nr. 4. Krahasimi i buxhetit për vitet 2023 – 2025

Mbështetja financiare nga donatorët

Donacionet e menaxhuara nga vet donatorët

Tabela nr. 5. Donacionet e menaxhuara nga donatoret

	2025
Emri donatorit	Euro
Humanitarian Law Center Kosovo	6,226.10
GLPS	990.00
IRZ	2,321.25
Këshilli i Evropës - CYBERKOP	18,240.00
Këshilli i Evropës - CEPEJ	6,307.00
Këshilli i Evropës - Mbështetja e Gjykatës Kushtetuese në zbatimin dhe shpërndarjen e standardeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut	13,264.00
Këshilli i Evropës - Përafrimi i ligjeve dhe politikave me Konventën e Stambollit	21,131.00
Këshilli i Evropës - PRO-FREX-K (Protecting Freedom of Expression and of the Media)	7,000.00
Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve - KOMF	3,201.99
OJQ "Terres d'ers Home"	595.00
OSBE	4,500.00
Programi i Punëve të Brendshme i Bashkimit Evropian në Projektin e Kosovës (HAPE)	23,375.82
Western Balkans Rule of Law Initiative (WBROLI)	4,500.00
GIZ	38,000.00
UNDP	10,000.00
Totali i Granteve në euro	159,652.16

Në tabelën 5 shpalosen donacionet e menaxhuara nga vet donatoret që do të thotë se këto mjete nuk kanë rrjedhë përmes llogarisë së Thesarit.

Sipas informatave të ofruar nga përfaqësuesit e projekteve me donator në këtë tabelë bëhet shpalosja e mbështetjes financiare nga donatorët vetëm në totalin e shpenzimeve ashtu siç janë pranuar, pa pasur mundësi të shpalosen në detaje.

Prezantimi dhe shpalosja e donacioneve në këtë rast tregon qartë se AD edhe në këtë vit ka realizuar aktivitetet trajnuese në mbështetje të donatorëve të ndryshëm. Edhe pse nuk janë të specifikuar dhe të detajuara, shpenzimet e mbuluara kanë qenë kryesisht shpenzimet për shërbimet e trajnimit, shpenzimet e botimeve dhe publikimeve, shpenzimet për vizita studimore, vlera totale e këtyre shpenzimeve është 159,652.16 euro.

Auditimi nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm

Gjatë vitit 2025 ka përfunduar auditimi nga ZKA për vitin 2024 dhe është publikuar raporti i auditimit.

Raporti Final i Auditimit të pasqyrave financiare të AD-së për vitin 2024 është pozitiv dhe pasqyrat vjetore financiare në të gjitha aspektet prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë.

Me qëllim të zbatimit të rekomandimeve të dala nga ky raport është përgatitur dhe zbatuar plani për rekomandimin e dhënë në lidhje me çështjet e gjetura gjatë vitit 2024.

Rekomandimet dhe plani i zbatim për implementim të rekomandimeve

Nr	Gjetja	Veprimi i ndërmarrë	Afati i zbatimit	Statusi aktual i rekomandimit	Vleresimi i rrezikut
1	Mangësi në menaxhimin e pasurisë	Është bere regjistrimi i projektit kapital dhe do të largohen pasurit e asgjësuara nga regjistri i pasurive të AD-së		Në proces	
2	Mos realizimi i shërbimit të auditimit të brendshëm	Është bërë kërkesa dhe është realizuar auditimi i brendshëm për vitin 2024	Qershor - Dhjetor 2025	Realizuar	

Tabela nr. 6. Plani për zbatim të rekomandimeve

1. SFIDAT E VITIT PARAPRAK DHE REKOMANDIMET PËR VITIN 2025

1. Sfidat dhe rreziqet në fushën e financave dhe përmirësimit të infrastrukturës

- Mungesa e buxhetit të mjaftueshëm për realizimin e të gjitha aktiviteteve të planifikuara në kuadër të programeve trajnuese, veprimtarive hulumtuese dhe botimeve, si dhe kufizimet për zhvillim afatgjatë institucional;
- Mosndarja e buxhetit për funksionalizimin e ndërtesës së re të Akademisë së Drejtësisë, përfshirë pajisjen me inventar, mjete pune dhe infrastrukturë mbështetëse;
- Rritja e volumit të mallrave dhe shërbimeve për mirëmbajtjen e ndërtesës së re, me ndikim të drejtpërdrejtë në shpenzimet operative;
- Zhvendosja e aktiviteteve trajnuese, stafit, pajisjeve, inventarit dhe materialit arkivor në ndërtesën e re, e cila kërkon planifikim dhe koordinim të veçantë;
- Mungesa e mekanizmave për monitorimin e shpenzimeve sipas departamenteve dhe divizioneve.

2. Sfidat dhe rreziqet në fushën e burimeve njerëzore dhe administrimit

- Stafi i pamjaftueshëm për zbatimin e aktiviteteve trajnuese, hulumtuese dhe botuese, veçanërisht në kontekstin e rritjes së volumit të punës;
- Lëvizja e stafit në sektorë të ndjeshëm, si Divizioni i TI-së, për shkak të kufizimeve në kompensim dhe kushte pune;
- Vështirësitë në krijimin e komisioneve të pranimit për procedurat e rekrutimit, për shkak të numrit të kufizuar të stafit drejtues dhe profesional;
- Proceset e rekrutimit për pozitat e lira sipas legjislacionit të ri në fuqi, të cilat mund të ndikojnë në afatet e planifikuara të aktiviteteve.

3. Sfidat dhe rreziqet në çështjet e zbatimit të legjislacionit dhe avancimin institucional

- Nevoja për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Akademinë e Drejtësisë, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira;
- Ndryshimet e shpeshta në legjislacion, të cilat kërkojnë harmonizim të vazhdueshëm të procedurave të brendshme dhe proceseve operative;
- Vonesat e mundshme në bashkëpunimin ndërinstitucional, me ndikim në realizimin në kohë të aktiviteteve trajnuese dhe hulumtuese.
- Hartimi dhe miratimi i pakos së akteve nenligjore si të kërkuara nga Ligji për zyrtarët publik

4. Sfidat dhe rreziqet në fushën teknologjike dhe të sistemeve të informacionit

- Funksionalizimi jo i plotë i sistemeve për menaxhimin e aktiviteteve trajnuese (SMAT dhe databazës përkatëse);
- Pajisjet e vjetruara të teknologjisë informative dhe nevoja për kompjuterë dhe laptopë të rinjë;

- Mosfunksionimi i pajisjeve për evidencën e hyrje-daljeve të stafit, që ndikon në saktësinë e të dhënave administrative

5. Sfidat dhe rreziqet ne aktivitet trajnuese, hulumtuese dhe botuese

- Stafi i pamjaftueshëm dhe kapacitetet e kufizuara për zbatimin efektiv të Programit të Trajnimit të Vazhdueshëm (PTV);
- Zbatimi i trajnimeve për menaxhmentin e gjykatave dhe prokurorive në mungesë të ekspertizës së mjaftueshme;
- Anulimi ose vonesat në procesin e rekrutimit të prokurorëve të rinjë, me ndikim të drejtpërdrejtë në planifikimin dhe realizimin e PTF-së;
- Nevoja për koordinim të veçantë me KGJK-në dhe institucionet përkatëse për trajnime të grupeve specifike.
- Inpute të pamjaftueshme nga përfituesit e Akademisë për mekanizmat e vlerësimit të nevojave trajnuese dhe botimeve të reja;
- Vështirësi në matjen e ndikimit të trajnimeve dhe botimeve, për shkak se përgjigjja ndaj instrumenteve të vlerësimit nuk është obligative;
- Përfshirja e pamjaftueshme e kuadrit ligjor në zhvillimin e botimeve, për shkak të kushteve dhe nivelit të ultë të kompensimit;
- Funkcionalizimi jo i plotë i databazës për menaxhimin e aktiviteteve trajnuese dhe botuese.

Për tejkalimin e sfidave të lartpërmendura, Akademia e Drejtësisë jep këto rekomandime:

1. Rritja e buxhetit të Akademisë së Drejtësisë, në përputhje me zgjerimin e mandatit, rritjen e volumit të aktiviteteve dhe nevojat institucionale, duke përfshirë edhe sigurimin e mjeteve financiare për plotësimin e pozitave të reja të stafit, sipas Rregullores nr. 05/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në AD.
2. Përmirësimi i kushteve të punës dhe politikave të kompensimit, veçanërisht për pozitat teknike dhe specialistike, me qëllim ruajtjen dhe zhvillimin e kapaciteteve profesionale të stafit.
3. Lehtësimi dhe përshpejtimi i procedurave të rekrutimit, përmes mekanizmave alternativë dhe bashkëpunimit ndërinstytucional, me qëllim krijimin në kohë të komisioneve të pranimit.
4. Iniciimi i procesit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Akademinë e Drejtësisë, në harmoni me standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira.
5. Finalizimi dhe miratimi i projekt-rregulloreve për rregullimin e mardhenjes së punës për të punësuarit në AD si në nëpunës me status të veçantë
6. Funkcionalizimi dhe avancimi i plotë i Sistemit për Menaxhimin e Aktiviteteve Trajnuese (SMAT) dhe databazave përkatëse, përmes bashkëpunimit me partnerët e AD-së; deri në funksionalizim të plotë, të sigurohen mekanizma rezervë (backup), përfshirë përdorimin e formateve alternative si Excel.

7. Modernizimi dhe mirëmbajtja e vazhdueshme e sistemeve të teknologjisë informative, përfshirë pajisjet për evidencën e hyrje-daljeve të stafit dhe përdorimin e plotë të moduleve të SMAT-it.
8. Angazhimi i ekspertëve të jashtëm, në fusha specifike ku mungon ekspertiza e brendshme, veçanërisht për trajnimet e specializuara dhe menaxheriale.
9. Inkurajimi i përfituesve të Akademisë së Drejtësisë për pjesëmarrje aktive në proceset e vlerësimit të nevojave trajnuese dhe plotësimin e instrumenteve të vlerësimit.
10. Angazhimi proaktiv i stafit përgjegjës për zbatimin dhe monitorimin e pyetësorëve për matjen e ndikimit të trajnimeve dhe botimeve.
11. Forcimi i bashkëpunimit me KGJK-në dhe KPK-në, për koordinimin e aktiviteteve trajnuese, zbatimin e mekanizmave të vlerësimit dhe sigurimin e efektit të trajnimeve në praktikë.
12. Përfshirja aktive e trajnuesve dhe përfituesve të trajnimeve në përdorimin e platformës SMAT, përmes mbështetjes teknike dhe trajnimeve përkatëse.

2. Shtojcat

1. Tabela me indikatorët dhe performancën e AD-së për vitin 2025
2. Aneksi I – Trajnimet e realizuar në të gjitha programet e AD-së
3. Aneksi II-Trajnimet e realizuara në PTF gjatë vitit 2025
4. Aneksi III-Aktivitetet e realizuara në PTV
5. Aneksi IV-Trajnimet për bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor të gjykatave dhe prokurorive
6. Aneksi V-Trajnimet për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial
7. Aneksi VI–Trajnimet për profesionet e lira
8. Aneksi VII–Trajnimet per Trajnues
9. Aneksi VIII–Trajnimet e detyrueshme sipas performances
10. Aneksi IX-Platforma e mësimin në distancë/ HELP
11. Aneksi X- Aktivitetet e realizuara në PHP
12. Aneksi XI-Aktivitetet me donatorë

Shtojca 1. Tabela me indikatorët dhe performancën e AD-së për vitin 2025

Objektivi i përgjithshëm	Nën objektivi	Veprimi	Indikatori/Rezultati
1. Përgatitja profesionale e gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapo emëruar si dhe ngritja e shkathtësive trajnuese	Zbatimi i trajnimit fillestar për 15 gjyqtarët e sapo emëruar të gjeneratës së XI në trajnimin praktik në gjykata nën mbikëqyrjen e mentorit (gjyqtarë) dhe realizimi i testit përfundimtarë.	Organizimi i trajnimeve dhe monitorimi i përmbushjes së trajnimit praktik	15 gjyqtarë të kësaj gjenerate kanë përfunduar trajnimin praktik dhe rrjedhimisht edhe trajnimin fillestar në shkurt 2025. Është realizuar testi përfundimtar për 15 gjyqtarët e kësaj gjenerate. Është hartuar dhe dërguar Raporti në KGJK, përkatësisht Komisionin për vlerësimin e performancës
	Zbatimi i trajnimit fillestar për 31 gjyqtarët e sapo emëruar të gjeneratës së XII si dhe realizimi i testit përfundimtarë	Organizimi i trajnimeve dhe monitorimi i përmbushjes së trajnimit teorik dhe praktik	31 gjyqtarët e kësaj gjenerate kanë përfunduar trajnimin fillestar në tetor 2025. Është realizuar testi për 31 gjyqtarët e kësaj gjenerate. Është hartuar dhe dërguar Raporti në KGJK, përkatësisht Komisionin për vlerësimin e performancës
	Zbatimi i trajnimit fillestar për 21 gjyqtarët e sapo emëruar të gjeneratës së XIII	Organizimi i trajnimeve dhe monitorimi i përmbushjes së trajnimit teorik dhe praktik	21 gjyqtarët e kësaj gjenerate kanë përfunduar konform programit trajnues trajnimin fillestar teorik në AD dhe aktualisht janë në proces të vijimit të trajnimit praktik në gjykatat përkatëse të emërimit.
	Zbatimi i trajnimit fillestar për 24 prokurorët e sapo emëruar të gjeneratës së XI	Organizimi i trajnimeve dhe monitorimi i përmbushjes së trajnimit teorik dhe praktik	24 prokurorët e sapo emëruar të kësaj gjenerate kanë vijuar trajnimin fillestar paralelisht trajnimin teorik dhe praktik konform këtij programi nga muaji janar 2025 dhe do të vazhdoj deri më 20 shkurt 2026. Në periudhën raportuese janë realizuar 131 ditë trajnimi praktik dhe 90 ditë trajnim teorik, 180 sesione trajnuese apo 540 orë trajnimi
	Zbatimi i trajnimit fillestar për 19 gjyqtarët e sapo emëruar gjenerata e XIV	Organizimi i trajnimeve dhe monitorimi i përmbushjes së trajnimit teorik dhe praktik	19 gjyqtarët e kësaj gjenerate janë në process të realizimit të trajnimit teorik në AD pasi trajnimi fillestar për këtë gjeneratë ka filluar së zbatuari nga muaji nëntor 2025.
2. Avancimi i vazhdueshëm i njohurive profesionale dhe interdisciplinare të gjyqtarëve,	Zhvillimi dhe zbatimi trajnimeve dhe aktiviteteve tjera që janë rezultat i kërkesave nga dokumentet strategjike	Organizimi i trajnimeve dhe aktiviteteve tjera në përmbushje të masave	Janë realizuar në tërësi të gjitha aktivitetet që dalin si rezultat nga dokumentet strategjike me përjashtim të trajnime për menaxhmentin e gjykatave dhe prokurorive si dhe për komisionet e verifikimit dhe rekrutimit të KGJK ne mungese të ekspertizës.

Objektivi i përgjithshëm	Nën objektivi	Veprimi	Indikatori/Rezultati
prokurorëve, stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial si dhe profesionistëve tjerë ligjor	Zbatimi i 23 trajnimeve nga lëmia penale prej 575	Organizimi i trajnimeve për luftimin e krimeve të luftës, formave të korrupsionit dhe krimet të organizuar, krimet kibernetik si dhe dhunës në familje sipas metodave dhe standardeve më bashkëkohore	27 aktivitete trajnuese nga lëmia penale të realizuara me 577 pjesëmarrës
	Zbatimi i 9 trajnimeve në fushën civile me pjesëmarrje deri 210 pjesëmarrës	Organizimi dhe realizimi i tryezave	8 aktivitete trajnuese nga lëmia civile të realizuara me 221 pjesëmarrës
	Zbatimi i 5 trajnimeve në drejtësinë për fëmijë me rreth 125 pjesëmarrës	Organizimi dhe realizimi i trajnimeve nga drejtësia për fëmijë aspekti penal dhe civil	5 aktivitete trajnuese të realizuara me 103 pjesëmarrës
	Zbatimi i 4 trajnimeve për dhunën në familje dhe dhunën ndaj grave me rreth 100 pjesëmarrës	Organizimi dhe realizimi i trajnimeve për dhunën në familje dhe dhunën ndaj grave	5 aktivitete trajnuese me 103 pjesëmarrës
	Zbatimi i 12 trajnimeve nga lëmia komerciale me 130 pjesëmarrës	Organizimi dhe realizimi i trajnimeve	13 aktivitete trajnuese të realizuara me 306 pjesëmarrës
	Zbatimi i 9 trajnimeve nga drejtësia kushtetuese, administrative dhe kundërvajtëse me 120 pjesëmarrës	Organizimi dhe realizimi i trajnimeve	1 aktivitet trajnues nga drejtësia kushtetuese të realizuar me 30 pjesëmarrës, 7 aktivitete trajnuese nga drejtësia administrative me 101 pjesëmarrës si dhe 1 trajnim në kundërvajtje me 24 pjesëmarrës
	Zbatimi i 5 trajnimeve për KEDNJ me 115 pjesëmarrës	Organizimi dhe realizimi i trajnimeve	6 aktivitete trajnuese të realizuara me 81 pjesëmarrës
	Zbatimi i 2 trajnimeve nga e Drejta e BE-së me 50 pjesëmarrës	Organizimi dhe realizimi i trajnimeve	2 aktivitete trajnuese të realizuara me 14 pjesëmarrës
	Zbatimi i 5 trajnimeve nga kompetenca interdisciplinare me 125 pjesëmarrës	Organizimi dhe realizimi i trajnimeve	5 aktivitete trajnuese të realizuara me 81 pjesëmarrës
